

ANALIZË E KOMUNIKIMIT POLITIK TË GRUAS NË SHQIPËRI

(2005 - 2014)

Miranda Prifti (Çili)

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në

Shkenca Sociale, me profil Sociologji-Antropologji, për marrjen e gradës shkencore

“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Aleksandër Dhima

Numri i fjalëve: 52.300

Tiranë, Qershor 2017

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë e nënshkuara Miranda Prifti (Çili), bazuar në urdhrin nr. 105, datë 23.03.2012 të ministrit të Arsimit dhe Sportit për miratimin e rregullores “Për etikën në veprimtarinë kërkimore dhe botuese”, deklaroj në dijeninë time të plotë mbi origjinalitetin e këtij punimi. Kjo temë prezantohet për herë të parë si kërkim në kuadër të marrjes së gradës shkencore “Doktor” pranë Universitetit European të Tiranës. Çdo pjesë e këtij punimi respekton rregulloren mbi të drejtën e autorit. Përdorimi i pacituar i çdo pjese të këtij punimi është i ndaluar, bazuar në ligjin për të drejtat e autorit.

© Miranda PRIFTI

ABSTRAKT

Vendosja e kuotës 30 për qind për përfaqësimin e gruas në politikë solli përmirësim të dukshëm, gruaja sot është më e përfaqësuar se nga çka qenë më parë. Por në shoqërinë tonë ende patriarkale ky përfaqësim ndesh vështirësi në faktin se kjo shoqëri nuk ofron një model referues të përshtatshëm, por modeli i vetëm referues është gjuha dhe diskursi politik maskilist. Ndaj gratë sado të përfaqësuara të jenë, për të krijuar jetëgjatësinë e tyre në politikë u duhet të ndjekin këtë lloj modeli. Gjuha jonë politike sot nuk është vetëm e rëndomtë, por është kthyer në vandalizëm, në një vandalizëm politik, dhe gruaja shqiptare duhet të përballet me këtë sfidë për t'u bërë pjesë e grupit politik. Ky punim ka për synim studimin e ligjërimit femëror në politikë dhe nisur nga prania në rritje e femrave në poste drejtuese politike, si dhe “luftës” së tyre gjuhësore të vazhdueshme, përpiqet të gjejë një emërues të përbashkët në komunikimin politik që mund të jetë faktor suksesi për gratë në politikë. Qëllimi i punimit është që të identifikojë dhe analizojë zgjidhjet e mundshme për fenomenin e *maskilizimit* të diskursit politik të femrave në politikë, në kontekstin e rastit: Shqipëri. Ndërkohë qasja metodologjike ka për objektiv të masë dimensionin e problemit dhe përfshin gjithashtu një analizë cilësore të përmbajtjes së ligjërimit politik e publik në Shqipërinë e viteve 2005 – 2014. Kjo punë studimore përshkruan aktualitetin politik të kësaj periudhe dhe përpiqet të shpjegojë se *pse politikanët shqiptarë kanë pranuar modelin maskilist dhe “të dhunshëm” të komunikimit politik*, si dhe nga analiza e këtij rasti të vetëm, të japë mundësinë të zgjerohet më tej për të testuar përfundimet e arritura.

Fjalë kyçe: ligjërim politik, grua, lidërsip, komunikim politik, kuota.

ABSTRACT

The placement of the 30 per cent quota in woman participation in politics, has induced a significant improvement on this regard; today's woman is considerably more represented than she was before the quota determination. Considering our patriarchal society, this representation of woman participation in politics has faced many difficulties, based on the fact that community does not provide a suitable reference model; the only reference paragon is the masculine political discourse. Hence, despite the representativeness of women, aiming a longevity in politics, they are must follow this masculine model. Nowadays, our political language is not just ordinary, but has tuned into a political vandalism, whereas Albanian woman has to face this challenge in order to become part of the political group. This study aims to observe female political discourse, based on their growing participation in political leadership positions and their continues language "struggle"; it also aims to identify a common denominator in terms of political communication that can lead to a success formula for females in politics. The scope of this study is to identify and analyse the possible solutions for *masculine* phenomenon of female discourse in Albanian politics. Meanwhile, from a methodological approach this study aims to measure the dimension of this concern throughout a qualitative analysis of the political discourse content in Albania within a ten year timeframe, from 2005 until 2014. This research study describes political reality and tries to explain why Albanian politicians have acknowledged the masculine and "violent" model of political communication. By assessing woman political discourse in Albania, this study aims to draw inductive conclusions which open a new study path for young researchers.

Key words: *political discourse, woman, leadership, political communication, quota.*

FALËNDERIME

Ky punim ishte rezultat i një bashkëpunimi të gjerë njerëzish, për të cilët shpreh mirënjohje dhe falënderime. Kryesisht, falënderimin më të veçantë për gatishmërinë, ndihmën e pakursyer në këshillim dhe bashkëpunimin në këtë studim, e meriton profesori i nderuar dhe njëkohësisht udhëheqësi shkencor i këtij punimi, ***Prof. Dr. Aleksandër Dhima***.

Njëkohësisht falënderime patjetër që kam dhe për të gjithë miqtë dhe kolegët në UET, të cilët në një farë mënyre më kanë dhënë shtysë të mbyll me sukses këtë cikël studimi.

Dhe patjetër që së fundmi unë nuk mund të mos përmend rëndësinë dhe ndikimin që ka pasur familja ime në gjithë këtë punim: pa fund faleminderit për mbështetjen dhe besimin!

Mirënjohje të përzemërta!

PËRMBAJTJA E LËNDËS

HYRJE	1
METODOLOGJIA	8
Modeli i hulumtimit	9
Metodat e kërkimit, lloji i të dhënave dhe burimet	11
Limitet e objektit të studimit	16
Vështirësitë e ndeshura.....	17
Rëndësia e këtij studimi	18
KAPITULLI I: VËSHTRIM TEORIK	19
1.1. Komunikimi si proces dhe komunikimi politik.....	24
1.2. Teoritë e komunikimit politik.....	26
1.2.1. Tradita socio-kulturore	28
1.3. Teoritë feministe.....	32
1.4 Kuadri ligjor	37
Të drejtat e grave.....	37
KAPITULLI II: KUOTA GJINORE NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR	47
2.1. Kuotimi gjinor si koncept.....	47
2.1.1 Në legjislacionin shqiptar	48
2.1.2 A janë kuotat një ide e mirë?	51
2.1.3 Pse janë të rëndësishme kuotat?	54
2.2 Barazia gjinore	56
2.3 Gruaja në vendimmarrje.....	57
2.4 A e garanton realizimin e qëllimit, kuota gjinore në legjislacionin shqiptar?.....	60
KAPITULLI III: ROLI I GRUAS SHQIPTARE NË POLITIKË GJATË PERIUdhËS SË TRANZICIONIT	67
3.1.Transformimi demokratik dhe tranzicioni i shoqërisë	67
3.2. Përfaqësimi i pakët i grave	74
3.3.Çfarë na thotë historia	78
3.4 Pse është e rëndësishme të kemi përfaqësim të barabartë të dy gjinive në parlament?	80
KAPITULLI IV: REALITETI POLITIK I KRIJUAR NGA LIGJËRIMI.....	87

4.1. Ligjërimi.....	87
4.1.1. Ku qëndron rëndësia e teorisë së Vitgenstajnit për gjuhën dhe krijimin e realitetit politik?	92
4.2. Ligjërimi publik.....	94
4.3. Ligjërimi politik	97
4.3.1 Veçori të ligjërimit politik (rasti i Znj. Topalli)	102
KAPITULLI V: ANALIZA E DUKURISË SË MASKILIZIMIT	109
5.1. Ligjërimi femëror në politikë	109
5.1.1. Fjalimet e gatshme.....	118
5.2. Jozefina Topalli, gruaja politikane dhe mënyra e saj e komunikimit.....	119
5.3 Media dhe roli i saj në fuqizimin politik të gruas.....	125
5.3.1. Media, gjatë një fushate elektorale	125
5.3.2. Media dhe politikanët	129
5.3.3 Efekti media.....	130
5.3.4. Portretizime të medias për gratë në politikë	135
KAPITULLI VI: ANALIZË E THELLUAR E INTERVISTAVE	145
PËRFUNDIME	165
REKOMANDIME	177
BIBLIOGRAFIA	187

FIGURA

Fig. 1: Mënyra tradicionale e komunikimit politik.....	26
Fig. 2: Për qind e femrave në parlament ndaj numrit total të deputeteve në Republikën e Shqipërisë 1990-2014.....	71
Fig. 3: Për qind e femrave të zgjedhura deputete ndaj numrit total të deputetëve në Republikën e Shqipërisë 2005-2013	72

GRAFIKË

Grafiku nr.1: Faktorët që ndikojnë në pjesëmarrjen e ulët të grave në vendimmarrje.....	58
Grafiku nr.2: Rrugët më efektive për rritjen e pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrje.....	59
Grafiku nr.3: Për qind e femrave në parlament ndaj numrit total të deputeteve në Republikën e Shqipërisë 1990-2014.....	71
Grafiku nr.4: Zgjedhja e femrave deputete në kuvend.....	72
Grafiku nr.5: Numri i grave ministre 1991-2013.....	79

HYRJE

Pothuaj të gjithë ne jemi të vetëdijshëm për maskilizimin e shoqërisë shqiptare. Janë meshkujt ata të cilët kanë në dorë jo vetëm pushtetin ekonomik, por dhe politik, janë meshkujt ata të cilët në Shqipëri përfaqësojnë akoma modelin e suksesit dhe fuqisë. Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje, në politikë apo dhe përfaqësimi i tyre, nuk është çështje dëshire, nuk është aspak një “dhuratë” që ju bëhet, por është e drejta e tyre njerëzore, ashtu si edhe çdo e drejtë e secilit individ.

Barazia gjinore nuk imponon mohimin e identitetit, qoftë femëror apo mashkullor, por inkurajon vendosjen e marrëdhënieve të ndërsjella, të ndërvarura dhe jo diskriminuese në shoqëri. Rolet gjinore nuk janë të njëjta në të gjithë botën. Cilado shoqëri ka pritshmëri të caktuara si për burrat dhe gratë, si edhe zhvillon mënyra të formimit të njerëzve që iu afrohen këtyre pritshmërive.

Janë stereotipat gjinorë ata që krijojnë një gjykim të pranuar gjerësisht ose paragjykim rreth karakteristikave ose tipareve të caktuara që zbatohen për secilën gjini. Nëse një burrë apo një grua vepron ndryshe nga mënyra se si gjykohet apo supozohet të sillet, atëherë ky veprim i tyre nuk përputhet me normën. *Stereotipat gjinorë* mund të jenë deri diku “të rrezikshëm”, sepse mund të krijojnë trajtime të pabarabarta ose të padrejta për një person të caktuar, i cili zgjedh të sfidojë supozimet e njerëzve rreth gjinisë së tij/saj. Madje dhe në një vend pune, këta stereotipa mund të kenë efekte të dëmshme ndaj femrave, duke kufizuar kështu mundësitë e tyre për të përparuar në pozitat udhëheqëse. Por për femrat nuk

është vetëm shoqëria ajo që ka stereotipa, por, nga ana tjetër, edhe meshkujt kanë stereotipat e tyre për to (femrat).

Psikologjikisht si burrat ashtu edhe gratë ndryshojnë në mënyrën se si ato veprojnë, në stilin me të cilin ata komunikojnë dhe në mënyrën me të cilën ata përpiqen të ndikojnë te të tjerët. Këto dallime gjinore, si në taktikat e komunikimit ashtu edhe në taktikat e ndikimit, kanë implikime për dallimet gjinore në të gjitha stilet e udhëheqjes së burrave dhe grave.

Femrat gjithmonë janë hasur e vazhdojnë të hasen me pengesa të shumta për të qenë në pozita udhëheqëse, sepse standardet e imponuara nga shoqëria dhe modelet tradicionale janë të orientuara kryesisht nga meshkujt. Një femër për të qenë udhëheqëse duhet të punojë shumë më shumë se një mashkull, që të mund të ketë sukses në pozitën e saj drejtuese. Në mënyrë tradicionale, pozitat udhëheqëse janë parë gjithmonë duke pasur dhe marrë si standard normat mashkullore (Chliwniak, 1997). Janë burrat ata që shikohen si udhëheqësit më të mirë, si modele të udhëheqjes, e ndërsa femra duhet të punojë shumë, të tregojë dhe sjellje mashkullore për t'u marrë seriozisht si udhëheqëse. Pra stereotipat i bëjnë meshkujt më të përshtatshëm sesa gratë për pozicione të larta udhëheqëse dhe kjo krijon në një farë mënyre një barrierë që gratë përpiqen çdo ditë për ta kapërcyer duke krijuar përshtatje me karakteristikat e lidërshiptit mashkullor, sigurisht që dhe kjo përmes lenteve të vendosura nga meshkujt. Nga gratë pritet të sillen si udhëheqëse, dhe njëkohësisht t'i përshtaten stereotipit të rolit femëror, dhe sa më shpesh ato të shkelin standardet për gjininë e tyre, aq më shumë ndëshkohen nga reagimet paragjykuese. Kështu që shoqëria në një farë mënyre pret që gratë të sillen në një mënyrë të rreptë demokratike dhe mashkullore që të pranohen dhe respektohen si udhëheqëse e për pasojë të kësaj

sjelljeje atyre u duhet shpesh të ndeshen me reagime nga mentaliteti shoqëror. Shpesh gjykohet më ashpër sesa një udhëheqës mashkull që sillet në mënyrë të ngjashme thjesht dhe vetëm për faktin se janë femra. Pra suksesi për një lider femër është sjellja e saj dukshëm armiqësore dhe e ashpër.

Në librin e popullarizuar të John Gray *Burrat vijnë nga Marsi, ndërsa gratë nga Afërdita*, përshkruhen dallimet themelore në stilet e komunikimit ndërmjet burrave dhe grave. Libri i tij është me rëndësi në literaturën që ka lidhje me dallimet e komunikimit përgjatë gjinisë së shekullit XX. Gray sugjeron që burrat dhe gratë janë kaq të ndryshëm në qasjet e tyre për të komunikuar se ata janë nga planetë të ndryshëm: ata kanë nevoja, qëllime dhe vlera të ndryshme në mënyrën se si komunikojnë (Gray, 1992). Dhe kuptimi i këtyre dallimeve është çelësi për krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të suksesshme, duke qenë të vetëdijshëm se si komunikojnë gjinitë e tjera, përshtatin stilin e tyre në përputhje me rrethanat. Dallimet kryesore që Gray identifikon mes stileve të komunikimit të burrave dhe grave janë si më poshtë:

- Burrat janë të orientuar nga qëllimi, ata e perceptojnë veten e tyre nga aftësia për të arritur rezultate, kurse gratë, nga ana tjetër, e krijojnë perceptimin për veten nga ndjenjat dhe nga cilësia e marrëdhënieve të tyre.
- Përgjithësisht janë burrat ata të cilët duan që të ndihen të rëndësishëm, të ndihen të nevojshëm, të vlerësuar dhe të admiruar, ndërsa gratë përpiqen të ndihen të dashura, të respektuara dhe të përkushtuara. Ndryshimi më i dukshëm midis dy gjinive për sa i përket stilit të tyre të komunikimit ndodh kur ata flasin për zgjidhjen e një problemi, konflikti apo një krize. Kjo vjen, sepse burrat kanë prirjen që të japin një

zgjdhje, kërkojnë rezultat, ndërsa femrat janë ato të cilat janë të prirura të kërkojnë më shumë mirëkuptim e ndjeshmëri për të ofruar këshilla që mund të jenë dhe të padëshiruara.

- Prania e burrave dhe dominimi nga ana tyre e institucioneve politike është parë si një pengesë e madhe për të mundësuar barazinë e grave.

Situata politike e kohëve të fundit në Shqipëri ka nxjerrë në pah pikërisht kriteret e gjuhës politike, gjuhë e cila ka qenë përgjithësisht e lidhur me ideologjinë e kahut të majtë ose të djathtë (dhe pse në raste të caktuara ka pasur dhe dominime të interesave të ngushta politike), konflikti mes palëve ka qenë vazhdimisht prezent, dhe ajo që është vënë re më shumë është mungesa e qartësisë së gjuhës.

Në këtë drejtim është e pamundur që në kuadër të një studimi të analizohen të gjithë faktorët me imtësi, por mendoj se një nga faktorët e suksesit apo mosesuksesit në politikë është edhe komunikimi. Komunikimi publik i çdo politikani qoftë grua apo jo duhet bërë me përgjegjësi të plotë dhe duhet pa dyshim të jetë i denjë, pasi përfaqëson jo vetëm veten, por edhe atë pjesë të elektoratit që e ka mbështetur për të qenë në këto pozicione. Të studiosh marrëdhëniet midis komunikimit, gjinisë dhe kulturës na ndihmon në tri drejtime të rëndësishme:

Së pari: na ndihmon të vlerësojmë se si praktikat dhe vlerat kulturore na ndikojnë në pikëpamjet tona lidhur me burrat dhe gratë; feminitetin dhe maskulinitetin. Dallimet midis komunikimit femëror dhe atij mashkullor shpesh shfaqen kur ka orientime të ndryshme interpretimi mbi problemet; kur mësuesit-pedagogët bashkëveprojnë ndryshe me studentët

meshkuj e ndryshe me studentet femra; kur media i përfaqëson burrat dhe gratë në bazë të stereotipit të gjinisë; kur kandidatët politikë si femra dhe meshkuj thonë gjëra të ngjashme, por publiku i vlerëson në mënyra të ndryshme etj.

Së dyti: studimi gjinor, komunikimi dhe kultura ndikojnë në perceptimin e gjinisë sonë: si ne e shohim atë tani dhe se si mund të vendosim për ta riparë atë në të ardhmen. Gjinia është një koncept që në të vërtetë nuk ka lidhje me femrat dhe meshkujt, por me kuptimin që kultura jonë i jep çdo seksi.

Së treti: duke studiuar komunikimin, gjininë dhe kulturën forcojmë dhe rolin tonë si komunikues. Mësojmë në lidhje me dallimet e përgjithshme të komunikimit midis grave dhe burrave, vlerësojmë aftësitë e veçanta të stileve të ndryshme të komunikimit për të kuptuar dhe njëkohësisht përshtatur me mënyrat e komunikimit që janë të ndryshme nga komunikimi ynë.

Interesi im ...

Për shkak të pranisë së gjithmonë e më shumë femrave në poste drejtuese e politike dhe “luftës” së tyre gjuhësore të vazhdueshme, ndjeva interes për studimin e ligjërimit femëror në politikë. Në këtë temë diplome, unë synoj të përcjell mesazhin se si ndikon në komunikimin politik faktori gjinor dhe cilat janë ato karakteristika që e bëjnë më të pranuar gruan në sferën politike dhe që lidhen pikërisht me komunikimin. E thënë më thjesht, nëse mund të gjejmë një emërues të përbashkët në komunikimin politik, që mund të jetë faktor suksesi për gratë në politikë.

Përqasja ime studimore lidhet me hipotezën: *“Lehtësia e futjes së gruas në politikë është në përpjesëtim të drejtë me maskilizimin e saj, sidomos në komunikim.*

Objektivat e studimit

Rritja e njohurive dhe të kuptuarit e realitetit politik dhe shoqëror është objektiv i këtij kërkimi shkencor.

Arritja e këtij objektivit nisët me shtrimin e një *pyetjeje kërkimore* rreth problemit që do të studiohet. Kjo pyetje udhëhiqet nga një teori, që e sfidon atë përmes *hipotezës*, e cila duhet t'i nënshtrohet vlerësimit dhe matjes nëpërmjet testimit që në fund rezulton me konkluzione:

- mënyra e trajtimit të çështjes së pabarazisë gjinore në Shqipëri, si dhe këndvështrimi mbi situatën e gruas në politikë dhe vendimmarrje;
- japë një analizë të përfaqësimit dhe rolit të ulët të femrave në fushën politike, por jo vetëm, si dhe pse ndodh kjo;
- të na japë një krahasim në mënyrën e komunikimit midis femrave shqiptare në politikë, meshkujve, si dhe figurave të njohura femërore në fushën e politikës ndërkombëtare;
- të japë një tablo të disa prej arsyeve kryesore të përdorimit të këtij komunikimi të ashpër mashkullor;
- të na tregojë se përse kjo sjellje, ky komunikim është kaq i ndjeshëm dhe kaq i përqaftuar nga femrat shqiptare;
- si dhe të na tregojë nëse është ky lloj komunikimi karakteristika që e bën më të pranuar gruan në sferën politike.

Qëllimi lidhet me studimin e kësaj hipoteze, nëse mund të konsiderohet e vërtetueshme në mjedisin politik shqiptar ose në të kundërt nëse nuk e reflekton fare atë. Për ta bërë më të thjeshtë arritjen e këtij qëllimi studimor nxjerrim dy implikime thelbësore nga hipoteza jonë:

- a. sa më shumë maskilizohet një grua në komunikim aq më të lehtë e ka të jetë e pranuar në sferën politike dhe
- b. sa më femërore të jetë ajo në komunikim aq më të vështirë e ka që të jetë e pranuar si faktor i barabartë në sferën politike.

METODOLOGJIA

Fokusi kryesor i këtij studimi është *komunikimi politik i politikanëve shqiptarë* dhe si ka ndryshuar ai gjatë viteve të fundit. Metodologjia e zgjedhur për këtë kërkim është analiza e ligjërimit, sipas së cilës është ligjërimi ai që krijon realitet social dhe jo e kundërta, analizë të dhënash, literature, analizë artikujsh në revista shkencore e gazeta dhe analizë studimesh. Kërkimi shkencor dhe analiza e ligjërimit në terren është bazuar në komunikimin politik të elitës së grave të partive politike shqiptare: PD-ja dhe PS-ja dhe në karakteristikat e tij kryesore. Për shkak të rolit të tyre riprodhues dhe si nëna, gratë shpesh shihen nga shoqëria shqiptare si ruajtëse të traditës dhe që simbolizojnë dhe identitetin e grupit dhe të kombit, si dhe si ruajtëse të nderit të familjes. Ndoshta kjo është dhe pritshmëria që karakterizon dhe përfshirjen e grave shqiptare në politikë. Pritshmëria e përgjithshme është që politika do të bëhet më pak e ashpër me ardhjen e tyre në organet drejtuese politike.

Megjithatë, zgjedhjet elektorale të vitit 2009 bënë që në politikën shqiptare të hynin për herë të parë gra që kishin prejardhje të ndryshme arsimore, kulturore, fetare, moshore si dhe që vinin nga karriera të ndryshme profesionale. E me gjithë ndryshimet që i karakterizonin dhe pavarësisht krahëve politikë nga ku militonin ato dukeshin sikur imitonin modelet maskiliste brenda partive politike të tyre. Për këtë arsye, metoda kryesore në të cilën është mbështetur ky studim do të jenë deklaratat zyrtare apo debatet e tjera publike dhe që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me rolin e grave shqiptare si politikanë. Kjo strategji ndihmon që të identifikohet trendi kryesor i komunikimit të tyre politik dhe a shfaq ai ngjashmëri midis politikanëve të ndryshme gra. Sidoqoftë, analiza nuk është bazuar vetëm te ngjashmëritë. Ndërtimi i identitetit gjinor është një proces relational, në

kuptimin që feminiliteti si identitet ndërtohet në relacion me identitetin maskilist dhe të kundërtat që i karakterizojnë. Fakti që ato flasin të njëjtën gjuhë apo përdorin të njëjtin ligjërim nuk do të thotë që komunikimi i tyre politik është i njëjtë. Përkundrazi mund jetë i njëjtë në kuptimin që është esencialist por është dhe kundërshtues dhe përçarës. Kjo bie ndesh me formimin e identitetit femëror. Përderisa duket sikur identiteti partiak shpeshherë bëhet më i rëndësishëm dhe mbizotëron sesa identiteti i të qenit femër. Kështu që identiteti femëror, i nënshtrohet dhe bëhet subjekt i identitetit partiak. Kjo do të jetë dhe metoda kryesore e analizës në pjesët që vijojnë.

Modeli i hulumtimit

Për këtë punim, modeli i hulumtimit i përzgjedhur është ai i *rastit studimor*, të një vendi: Shqipëria. Përpara se të argumentoj këtë përzgjedhje, po vë në dukje se cilat janë karakteristikat e një rasti studimor si model hulumtimi. Ato janë si më poshtë:

- Përfshirja e një të vetmi ose një numri të vogël rastesh dhe cilido prej tyre studiohet në thellësi;
- Nga këto raste mund të mblidhen të dhëna të llojeve të ndryshme ku mund të ketë edhe të dhëna përfaqësimore;
- Si subjekt rasti studimi mund të përdoret një person, një organizatë, një situatë ose dhe një vend por gjithsesi studimi do të duhet që të lidhet me një aspekt të caktuar të rastit, të përcaktuar në pyetjen e kërkimit;
- Studimi i këtij rasti duhet të ketë kufij për të bërë të qartë se çfarë do duhet të studiohet dhe çfarë jo;

- Qasja e përdorur është holistike, sepse hulumtuesi është i interesuar si për marrëdhëniet që ekzistojnë midis pjesëve përbërëse të rastit, ashtu edhe për rastin si një i tërë (Matthews & Ross, 2010: 128).

Qëllimi i punimit është që të identifikojë, analizojë dhe rekomandojë zgjidhjet e mundshme për fenomenin e *maskilizimit* të diskursit politik të femrave në politikë, në kontekstin e rastit: Shqipëri.

Pyetja kërkimore bazë është: *Pse politikanet shqiptare, pjesë e elitës politike, kanë inkorporuar diskursin maskilist në aktivitetin e tyre politik?* (rasti shqiptar).

Hipoteza e punimit është: *Maskilizimi (në komunikim) është kusht i domosdoshëm për pjesëmarrjen e gruas në politikën shqiptare.*

Dhe në koherencë me karakteristikat e sipër përmendura e gjejmë të përshtatshëm këtë model për punim pasi:

- Kemi të bëjmë me studimin e një rasti të vetëm dhe ky rast është Shqipëria;
- Të dhënat e këtij studimi mund të jenë dhe sasiore dhe cilësore, dhe sikurse do e shohim gjatë punimit, kjo tezë mbështetet kryesisht tek të dhënat cilësore,
- Nga analiza e këtij rasti të vetëm, mund të zgjerohet më tej për të testuar përfundimet e arritura,

Përzgjedhja e këtij rasti studimor ka më shumë arsye *objektive*: politika e “dhunshme” dhe *maskilizimi* i dikursit politik përbëjnë kërcënim për figurën femërore e cila është apo kërkohet të bëhet pjesë e politikës shqiptare por njëkohësisht dhe për vetë politikën e

vendit. Realiteti si edhe analiza konkrete e aktualitetit që do të trajtohen detajisht gjatë punimit, e dëshmojnë këtë fakt. Periudha e regjimit komunist, periudha e tranzicionit, karakteristikat e vendit, mentaliteti patriarkal, mungesa e një tradite përfaqësimi, konkurrenca jo e drejtë, etj janë tregues që në një farë mënyre kanë kontribuar në krijimin e këtij konteksti dhe implikimet e këtyre fenomeneve në të.

Metodat e kërkimit, lloji i të dhënave dhe burimet

Përzgjedhja e metodave të kërkimit, fillon së pari nga pyetja kërkimore, hipoteza e punimit dhe aspektet e temës hulumtuese që janë fokusi kryesor (Matthews & Ross, *vep. cit.:* 141). Bazuar në këto elementë, qasja e përdorur do të jetë cilësore, sepse përshtatet me fokusin e punimit i cili përmban disa nga elementët e qasjes cilësore (po aty: 142), si:

- qasjet ontologjike dhe epistemologjike janë interpretuese,
- pyetjet e hulumtimit mund të hartohen përmes nën pyetjeve,
- pyetja e hulumtimit mund të marrë përgjigje përmes përshkrimit dhe shpjegimit,
- të dhënat janë cilësore.

Metodat e mbledhjes së të dhënave dhe analizës së tyre janë:

- Dokumentet si raportet, strategjitë, dokumente zyrtare qeveritare– përfshijnë të dhëna cilësore,
- Deklaratat, komunikata, intervista të aktorëve politik në aspektin politikëbërës,
- Analiza e ligjëritimit – e cila përdoret kryesisht në hulumtime cilësore.

Burimet e informacionit të përdorura për këtë studim janë si parësore ashtu edhe dytësore.

- *Burimet parësore përfshijnë:*
 - Dokumente strategjike (Strategji të ndryshme të botuara në këtë fushë)
 - Bazë ligjore (Kushtetuta, akte ligjore, ligje)
 - Deklarata të aktorëve politikë, komunikata për shtyp
 - Intervista,
 - Revista, gazeta,
- *Burimet dytësore përfshijnë:*
 - Literaturën teorike mbi komunikimin politik, teoritë feministe, problemet gjinore, diskursin politik etj.,
 - Studime të mëparshme mbi këto fenomene,
 - Shkrime / artikuj specifikë të cilët i trajtojnë këto aspekte në kontekstin shqiptar, si në teori ashtu dhe në praktikë.

Intervistat e përdorura janë intervista gjysme të strukturuar, ato i janë drejtuar një grupi/ numri të vogël të intervistuarish, por përtej kësaj personat pjesë të kësaj interviste nuk kanë qenë të përzgjedhur rastësisht por të përzgjedhur me kujdes ndaj dhe numri i tyre i përcaktuar si i vogël është 10, duke konsideruar dhe personat e intervistuar të cilët kërkuan të mbeten anonimë të kësaj teze studimi.

Kampionimi është i qëllimshëm, çfarë do të thotë se zgjedhja e personave është e qëllimshme në atë mënyrë që mua të më ndihmojë të zbuloj më shumë mbi tezën apo fushën e studimit. Dhe si kampion janë përdorur figura të rëndësishme përfaqësimi politik dhe publik të tillë si: deputete dhe ministre gjithashtu, të njohura politikisht, si edhe të

njohura për diskursin e tyre politik gjatë seancave plenare kryesisht, duke qenë se Kuvendi është më i përfoluri për një komunikim jo shumë të denjë dhe të hijshëm publik, por edhe gjatë komunikatave për shtyp, emisioneve televizive etj. Këto intervista janë zhvilluar brenda një periudhe 3- 4 mujore, kohë jo e përcaktuar që në fillim kaq e gjatë por e shtyrë për shkak të vështirësive gjatë mundësit të takimeve apo dhe dëshirës për t'u intervistuar. Intervistat janë zhvilluar të gjitha më dëshirën e plotë për të dhënë ndihmesë në këtë tezë studimore dhe mënyrat e zhvillimit janë kryesisht të regjistruara dhe përmes email-it.

Qasja metodologjike ka për objektiv të masë dimensionin e problemit dhe përfshin gjithashtu një analizë cilësore të përmbajtjes së ligjërimit politik e publik në Shqipërinë e viteve 2005-2014.

Duke detajuar metodën e përdorur si dhe instrumentet përkatëse në përmbushje të saj do të thoshim që kjo tezë ka një karakter **thellësisht empirik**.

Analizat e bërë në studimin e kësaj teze janë:

- *studimi i kuadrit teorik mbi komunikimin politik*
- *studimet të mëparshme më natyrë shkencore të specialistëve shqiptarë dhe të huaj të fushave të shkencave sociale*
- *analizë e legjislacionit*
- *analizë e mediave dhe shtypit të kohës*
- *intervista të drejtpërdrejta*

Shqyrtimi i dokumenteve

Për të kryer këtë studim është konsultuar literaturë që ka ndihmuar në qartësimin e koncepteve bazë teorikë dhe strategjitë e komunikimit politik.

Analiza bazohet në imazhin e femrave të përfshira në politikë të perceptuar nga fjalimet tyre, aksionet e tyre publike, si dhe intervistat e tyre. Gjithashtu janë shfrytëzuar analiza të ndryshme në shtypin e përditshëm. Si burime parësore në këtë analizë janë përdorur tekstet e gazetave, revistave, programeve televizive si dhe faqet zyrtare të internetit. Literatura e konsultuar është njëkohësisht literaturë e huaj dhe shqiptare.

Intervistimi me persona kyç

Intervistat janë vërtet një pjesë e rëndësishme e këtij studimi, dhe më kanë shërbyer për një analizë më të mirë. Realizimi i këtyre intervistave ka ndihmuar për një thellim në studim dhe japin argumente për të vërtetuar ose jo hipotezat. Intervistat janë zhvilluar me personazhe të njohur të fushës politike dhe që kanë lidhje drejtpërdrejtë me objektin e studimit. Personazhet janë politikanë, meshkuj dhe femra, të njohur politikisht dhe figura publike. Gjatë intervistave janë hasur vështirësi për shkak të mungesës së dëshirës për t'u përgjigjur.

Në këtë punim do t'i përmbahemi përkufizimit si më poshtë të *ligjërimit politik*. Autorët e ligjërimit që janë zgjedhur për analizën ligjërimore janë femra me profesion politikane, por për një studim sa më të saktë janë përdorur dhe disa politikanë meshkuj. Janë përzgjedhur komunikimet e tyre, disa prej tyre në situata formale, në institucione politike, si Kuvendi e Presidenca dhe të tjera në situata joformale, si debate politike televizive dhe intervista

televizive. Të gjitha këto ligjërime kanë qëllime të ndryshme politike. Pra, analiza e ligjërimit do të jetë një përjasje gjuhësore e ligjërimit në sferën politike.

Me ligjërim politik ne kemi parasysh plotësimin e kritereve të mëposhtme:

- ligjëruesi të jetë me profesion politikan,
- ligjërata të komunikohet në një institucion,
- ligjërimi të arrijë një qëllim politik.

Për analizën e ligjërimit në intervista janë shfrytëzuar burime me video të cilat edhe janë transkriptuar, në këtë mënyrë kam pasur mundësinë që të përfshij në shqyrtim edhe elementin fonetik të tyre.

Limitet e objektit të studimit

Nga pikëpamja e objektit të studimit, kjo tezë fokusohet dhe merr përsipër të analizojë vetëm aspektin e ligjërimit politik në tërësinë e komunikimit politik sidomos fokusuar gjatë fushatave elektorale, para dhe pas tyre, edhe pse komunikimi politik ka një tërësi elementësh dhe aq më tepër që fushata elektorale është pasojë e ndërveprimit të numri edhe më të madh faktorësh dhe kontekstesh.

Nga pikëpamja kohore, kjo tezë nga pikëpamja kohës studion elementin e komunikimit politik në zgjedhjet parlamentare në Shqipëri nga 2005 - 2013.

Nga pikëpamja e aktorëve politikë kjo tezë merret me komunikimin politik të përfaqësuesve femra të partive kryesore në vend, parti të cilat kanë pasur rolin kryesor në politikëbërjen e shoqërisë shqiptare.

Nga pikëpamja e aktorëve mediatikë të marra në analizë si kanale “të përçimit-transmetimit të këtij komunikimi politik”, janë analizuar televizionet kombëtare dhe shtypi i shkruar.

Lidhur me legjislacionin, janë shqyrtuar të gjithë ato parashikime dhe ndryshime ligjore që rregullojnë pozitën e femrës shqiptare në vendimmarrje dhe kryesisht të drejtën e saj për tu zgjedhur në politikë e për të përfaqësuar politikisht me të drejta të barabarta ashtu sikurse gjinia tjetër duke qenë se ato përfaqësojnë gati gjysmën e popullsisë dhe e kanë plotësisht këtë të drejtë përfaqësimi.

Vështirësitë e ndeshura

Shkencat e komunikimit janë ndër disiplinat e reja dhe komunikimi politik, brenda tyre, është një nën- disiplinë edhe më e re. Shkolla shqiptare e shkencave të komunikimit është formësuar se fundi, mbi të gjitha media e lirë dhe komunikimi masiv janë legjitimuar në shoqërinë shqiptare në të njëjtën periudhë me proceset e demokratizimit dhe hapjes së Shqipërisë.

Vështirësia e parë është pamundësia për t'u mbështetur mbi studime paraardhëse të cilat ose mungojnë ose janë të tërthorta lidhur me objektin e studimit.

Vështirësia e dytë qëndron tek intervistat e studimit. Këto intervista ishin të pakta në numër (10 të tilla) por që përfaqësonin pjesën kryesore nga ku mund të kisha informacionin bazë mbi objektin e studimit. Vështirësia qëndron në faktin se disa persona shprehën mos dëshirë për të qenë pjesë e këtij studimi me një mendim të tyrin si edhe pjesa tjetër të cilët pranuan në një farë mënyre kërkuan anonimatin. Kishte ndër to dhe persona të cilët me shumë dëshirë pranuan të shprehnin mendimin e tyre rreth tezës së studimit por këto ishin vetëm 3-4 veta. Pra jo të gjithë personat e dëshiruar për të qenë pjesë e këtij studimi pranuan të intervistoheshin si edhe kishte ndër të intervistuarit të cilët kërkuan të jepnin opinionin e tyre por në fund dëshironin të mbeteshin anonimë në studim.

Vështirësia e tretë është në aspektin arkivor, sidomos për periudhën e tranzicionit shqiptar 1990 - 2000, ku vështirësia për të gjetur të dhëna është e madhe (shkak për këtë është niveli i ulët i institucionalizimit të medias).

Rëndësia e këtij studimi

Rëndësia e një studimi shkencor në fakt është më shumë se njëdimensionale.

Për të treguar rëndësinë e këtij punimi në aspektin personal po i referohem shkrimtares franceze Carine Roitfeld e cila e shikon po ashtu në një këndvështrim personal rëndësinë e studimit shkencor kur shprehet se: *“Ju zbuloni vetveten përmes kërkimit shkencor në punën tuaj”*¹.

Rëndësia e punimit shikohet dhe tek sjellja e ideve të reja jo vetëm në aspektin akademik të një fushe të caktuar studimi por dhe shfrytëzimi i këtyre ideve në funksion të zhvillimit. Unë, por jo vetëm, besoj dhe cilido studiues ndihet i vlerësuar për punën e tij, ndihet i realizuar dhe i plotësuar kur këto të reja të sjella nga punimi i tij shkencor do të shërbejnë për diçka.

Ndaj shpresoj shumë që ky studim shkencor i të ofrojë një tablo dhe ndihmesë konkrete jo vetëm tek aktorët politikë, por dhe tek shoqëria civile, e cila ka mision të saj barazinë gjinore në vendimmarrje dhe garantimin e të drejtave të grave.

¹Fashion. (2011) A women of substance. Our exclusive Q&A with Carine Roitfeld.
<http://www.fashionmagazine.com/fashion/2011/09/29/a-woman-of-substanceour-exclusive-qa-with-carine-roitfeld/2/>

KAPITULLI I: VËSHTRIM TEORIK

Vështrim i përgjithshëm

Politika është një aktivitet i mbizotëruar nga një grup shoqëror sikurse është ai i burrave dhe për individët e grupimit tjetër gjinor (gratë) ka pengesa hyrëse.

Përgjegjës lidhur me mos barazinë midis gjinive të ndryshme për pjesëmarrjen në vendimmarrje, nuk është sistemi demokratik, i cili mbështet barazinë e qytetarëve para ligjit, krijimin dhe dhënien e shanseve të barabarta për gratë dhe për burrat, por pengues dhe përgjegjëse janë të tjerë faktorë.

Në nivel botëror, më pak gra se burra hyjnë në politikën zyrtare, dhe parlamentet vazhdojnë të mbeten institucione ku mbizotërojnë meshkujt. Në fakt, ekziston vetëm një vend në botë, Ruanda, që ka një parlament me mazhorancë femërore. (ACER & ASET, 2009).

Për shkak se bota politike është një botë mashkullore, politikanet femra përballen me një dilemë. Ato duhet të mbajnë parasysh mospërputhjen që ekziston midis identitetit të tyre kulturor si gra, dhe rolit të një politikani, të identifikuar si një rol mashkullor (Johnson, 2005).

Gratë janë të ardhura së fundmi në politikë. Në dhjetëvjeçarin e fundit shumë gra janë zgjedhur në poste të larta politike si për shembull në Zvicër, Gjermani, Mongoli, Liberi dhe Kili. Por shumica e ekspertëve thonë se gratë nuk janë të përfaqësuara sa duhet në krahasim me burrat dhe do të vazhdojnë të jenë prapa tyre në të ardhmen e afërt. Që nga viti 1998, Zvicra, Panamaja, Letonia, Kili, Bermuda, Gjermania dhe shumë vende të tjera kanë zgjedhur gra në postin e presidentit apo të kryeministrit. Dhe në mbarë botën gjithnjë e më

shumë gra po zgjidhen në parlament. Ruanda zë vendin e parë në botë për nga përfaqësimi i grave në parlament me 48 për qind e ndjekur nga Suedia e 47 për qind dhe Kuba me 43%. Megjithatë gratë përbëjnë vetëm 18 për qind të anëtarëve të parlamentit në botë sipas organizatës Unioni Ndërparlamentar (<http://www.zeriamerikes>).

Në vendet demokratike përfaqësimi i të gjitha kategorive shoqërore ka një rëndësi të dorës së parë. “Ndërtimi i një rendi demokratik pas vitit 1990 i ka vënë qytetarët shqiptarë përballë sfidës së ndërtimit të një demokracie liberale me institucione funksionale, që do të thotë që përveç ndërtimit formal të strukturave ligjore qytetarët duhet të jenë pjesëmarrës aktivë në proces.” (Danaj, 2008) Duke iu referuar realitetit shqiptar mund të flasim për grupe qytetarësh përfaqësimi i të cilëve në parlamentin shqiptar, si dhe në postet e tjera në nivel lokal është shumë i ulët.

Në traditën shqiptare vazhdimisht ka pasur kategori shoqërore të papërfaqësuara në jetën politiko-sociale. Ky grup i qytetarëve me pak ose aspak zë në procesin politik përbëhet nga gratë. Studiuesit e shkencave shoqërore pohojnë se qëndrimet dhe opinionet politike formohen nën ndikimin e disa faktorëve si: ndërveprimi shoqëror, diskutimi, reflektimi personal. Që të realizohet ky ndërveprim, diskutim dhe reflektim duhet të ketë hapësirë shoqërizimi.

Z. Nano zgjodhi Valentina Leskajn për partinë rozë. Por, edhe z. Berisha ka zgjedhur Majlinda Bregun, ndërsa z. Gjinushi shkrimtaren Diana Çuli. Sepse gratë e ardhura nga OJF-të, dinë të bëjnë reforma. (Hasani, 2005: 22-24)

Në demokracitë moderne shoqëria civile luan një rol të rëndësishëm dhe mund të kontribuojë në mënyra të ndryshme në përfaqësimin e grave në proceset politike. Shoqëritë

civile mund t'i ndihmojnë gratë duke lobuar për të siguruar që çështjet e tyre të bëhen pjesë e platformës së partive politike, po ashtu duke organizuar projekte të ndryshme për t'i edukuar qytetarët për rëndësinë dhe arsyet se pse duhet të kemi një përfaqësim të barabartë të grave në politikë.

Edhe pse nga ana e organizatave të grave janë bërë vazhdimisht përpjekje me synim rritjen e përfaqësimit të gruas jo vetëm në politikë por dhe në vendimmarrje, sërish shohim dhe mund të themi se kjo pjesëmarrje apo ky lloj përfaqësimi në politikë (parlament apo qeveri) ende mbetet i ulët. Por megjithatë, shoqatat jo fitimprurëse (OJF), dhe pse në mungesë të një procesi konsultativ ndërmjet shtetit dhe tyre, kanë dhënë ndihmesë duke influencuar madje dhe vendime politike. Pra, ndihmë në emancipimin e gruas në Shqipëri ka dhënë dhe apelimi për të drejtat e tyre edhe nga organizata të shumta e të ndryshme joqeveritare të cilat e kanë shtruar si një çështje të mprehtë rregullimin me ligj të disa të drejtave që duhet të gëzojnë gratë.

Analizimi i llojeve të familjeve si dhe njësive ekonomike familjare është shumë i rëndësishëm për perspektivën gjinore, dhe pse sot në Shqipëri bashkëjetojnë dhe përzihen me njëra-tjetrën qëndrimet e forta patriarkale me ato moderne. Pavarësisht arritjeve të grave: nivelet e larta të edukimit apo progreset në tregun e punës, situata e gruas në këndvështrimin e pabarazisë gjinore vazhdon e mbetet një shqetësim jo vetëm për shoqërinë.

Zgjedhjet elektorale të vitit 2009 dhe 2013 në Shqipëri u panë si një mundësi e mirë për të rritur numrin e përfaqësimit të grave politike në parlament. Vendosija e kuotave gjeti një miratim gati konsensual të publikut megjithëse shumë filluan të shihnin me dyshim

procesin e përzgjedhjes së politikaneve gra dhe a kishte vërtet të tilla në politikën shqiptare? Teorikisht, rregullime të tilla, të cilat krijojnë mundësi të barabarta ndërmjet grave dhe meshkujve kërkojnë gjithmonë që reformat të ndërmerren në nivelin makro duke përfshirë sistemet legjislative, mjedisin ligjor dhe sistemet elektorale, të cilat i japin tjetër formë sistemeve partiake dhe karakteristikave të partive politike. (Young, 2000: 13) Kryetarët e partive politike në mënyrë që të plotësonin detyrimet prej 30 për qind të kandidaturave filluan të kërkonin gra të reja politike dhe nga fusha e shoqërisë civile apo fusha të tjera pak të lidhura me politikën. Pavarësisht këtyre përpjekjeve të cilat promovoheshin sikur gratë po pushtonin arenën politike shqiptare, e cila deri në atë kohë konsiderohej si fusha e politikanëve burra ‘gladiatorë’ dhe patriarkalistë, menjëherë pas zgjedhjeve elektorale të 2009, u vu re një reduktim i dukshëm i grave fituese në lista. Gjithashtu u vu re një maskilizim i komunikimit politik të politikaneve të reja femra. Pikërisht këtë lloj fenomeni do të përpiqem që të analizoj në këtë studim dhe prandaj hipoteza kryesore do të jetë:

Maskilizimi (në komunikim) është kusht i domosdoshëm për pjesëmarrjen e gruas në politikën shqiptare.

Analiza e diskutit dhe e komunikimit politik të politikaneve gra do të jetë dhe fokusi kryesor i këtij studimi. Studimi do të përqendrohet tek politikanet në pozicion lidhshpi dhe duke pasur parasysh si ndërveprimin e tyre personal dhe sidomos atë në grup. Për të bërë këtë do të analizohen fjalime, deklarata zyrtare si dhe artikuj të tjerë në lidhje me komunikimin politik të tyre. Një rol të rëndësishëm do të luajë dhe analiza e diskutit mbizotërues apo dominant si dhe ideologjitë e ndryshme të së kaluarës dhe të tashmes në

Shqipëri. Të rëndësishme gjatë analizimit do të jenë edhe teoritë e ligjërimit (sidomos gjuhës), teoritë e komunikimit politik dhe teoritë post – moderniste të cilat e vënë theksin tek roli i rëndësishëm që luajnë diskurset. I gjithë studimi do të ketë një përqsje të përgjithshme dhe do të bazohet në teoritë feministe. Me rëndësi gjatë këtij studimi është që të vlerësojë apo të bëjë një lloj klasifikimi të komunikimit politik të politikaneve gra në Shqipëri dhe të shpjegojë arsyet e maskilizimit të komunikimit të tyre politik.

Duhet theksuar që deri tani, tendencat kryesore si nga PD-ja dhe PS-ja kanë qenë për një përfaqësim më të barabartë midis grave dhe burrave. Kjo do të thotë që nuk ekziston ndonjë pengesë ideologjike partiake që pengon përfshirjen e grave në politike. Por nga ana tjetër, siç do të analizoj më gjerë në pjesët e tjera të këtij studimi, kjo dëshmon për ekzistencën e pengesave patriarkaliste dhe tradicionaliste që ndikojnë në maskilizimin e politikaneve gra në Shqipëri. Theksoj këtu se dhe Shqipëria, në kërkim të arritjes së Objektivit të Mijëvjeçarit për Fuqizimin e Gruas dhe Barazinë Gjinore deri në 2015 qëndron lart në axhendën e zhvillimit. Për këtë është e rëndësishme të konsiderohet seriozisht dhe të investigohen barrierat për gruan në udhëheqje në Shqipëri dhe të analizohen faktorët të cilët pengojnë gruan të hyjë.

1.1. Komunikimi si proces dhe komunikimi politik

Komunikimi është një proces sistemik dhe dinamik, që do të thotë se vazhdimisht ndryshon dhe zhvillohet, dhe duke qenë i tillë (një proces), bashkëveprimet komunikuese nuk kanë një fillim apo fund të përcaktuar. Kur themi komunikimi është sistemik, e kemi parasysh atë si një sistem, të gjitha aspektet e komunikimit janë të ndërlidhura, në mënyrë që ata të ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Kush po flet ndikon në atë që është thënë dhe çfarë do të thotë. Sistemet brenda të cilave komunikimi ndodh bashkëveprojnë; çdo pjesë prek të gjithë të tjerët. Por sistemi më i madh që ndikon komunikimin është kultura jonë, konteksti brenda të cilit të gjitha bashkëveprimet tona zhvillohen.

Komunikimi ndikohet gjithashtu dhe nga mënyra se si ne mendojmë. Pikëpamjet e një shoqërie për trajtimin e burrave dhe grave ndryshojnë në kohë, psh: nëse kohë më parë do të ishte një sjellje e vrazhdë nga ana e një mashkulli mos hapja e derës së makinës për t'u futur një femër, sot pjesa më e madhe e njerëzve këtë gjest nuk e konsiderojnë as si të pasjellshëm. Nëse kohë më parë nuk kishte një përcaktim për ngacmimin seksual dhe nuk është konsideruar si shkak për ankesë apo për veprime ligjore, sot ligjet dhe politikat ndalojnë ngacmimin seksual, dhe punonjësit mund të ngrenë padi kundër ngacmuesve. Pra e njëjta sjellje tani do të thotë diçka të ndryshme nga ajo që do të thotë kohë më pas në vazhdimësi.

Qeveria është një lojtar legjitim në procesin politik dhe komunikimi me publikun është një element legjitim i këtij procesi. Shqipëria është demokraci përfaqësuese, dhe për të fituar pushtetin duhet që të fitosh zgjedhjet, e për t'i fituar zgjedhjet duhet, përpos të tjerave që, të kesh epërsi në imazh në raport me kundërshtarin politik. Nisur nga kjo logjikë aktorët

politikë konkurrues në zgjedhjet shqiptare i kanë kushtuar gjithnjë e më shumë rëndësi punës me median dhe komunikimit politik, si një instrument bazë për të “arritur” elektoratin por dhe për t’u bërë atë “për vete”, gjithashtu për të krijuar epërsi ndaj kundërshtarit, kjo kryesisht duke reklamuar veten dhe herë pas here edhe duke bërë anti-reklamë për tjetrin.

Thelbi i politikës është biseda ose ndërveprimi. Dhe në përcaktimin e përgjithshëm komunikimi politik është roli që komunikimi ka në procesin politik. Komunikimi politik zhvillohet në forma (formale ose joformale) dhe vende të ndryshme (publike e private) dhe përmes disa mediumesh. Ky komunikim përfshin prodhimin dhe gjenerimin e mesazheve nga aktorët politikë por edhe transmetimin e mesazheve politike nëpërmjet kanaleve direkte dhe indirekte dhe marrjen e mesazheve politike.

Pra komunikimi politik është një proces i cili përfshin institucionet politike dhe aktorët politikë, mediat e lajmeve dhe më e rëndësishmja qytetarët. Dhe në këtë kuptim, çdo veprim i këtij komunikimi politik prodhuar nga partitë, grupet e interesit apo dhe mediave, është drejt qytetarëve jo vetëm për t’i informuar por akoma më shumë për të ndikuar mbi to. Është ndërveprimi midis këtyre tre grupeve të sipërpërmendura (partive, grupeve të interesit dhe medias) ai që ka rëndësi në këtë komunikim. Drejtimet në të cilat lëviz komunikimi brenda politikës janë:

- *nga lart - poshtë (nga autoritetet qeverisëse tek qytetarët),*
- *horizontalisht (ndërmjet aktorëve politikë por duke përfshirë edhe mediat e lajmeve),*
- *dhe nga poshtë - lart (nga qytetarët dhe grupet tek institucionet politike).*

Komunikimi politik është i vjetër po aq sa vetë aktiviteti politik. Për sa i përket komunikimit politik të historisë njerëzore ai është si një proces linear, proces nga lart-poshtë, nga liderët për njerëzit. (Darren, 2006: 5)




Figura 1: Mënyra tradicionale e komunikimit politik

1.2. Teoritë e komunikimit politik

Demokracia është komunikim dhe kryesisht komunikim politik. Komunikimi është një proces marrëdhëniesh dhe të gjithë e dimë që të komunikosh nuk do të thotë thjesht të japësh një mesazh por të krijosh një marrëdhënie ku secili të ketë një rol apo edhe një imazh. Kjo do të thotë që nuk është kryesisht ose në thelb një proces për të kaluar informacion ose për të përhapur dhe qarkulluar shenja. Ai është një proces marrëdhëniesh jo vetëm ngaqë u ndodh dy apo më shumë personave, por edhe sepse ndikon në natyrën e lidhjeve ndërmjet këtyre njerëzve. Të gjithë ne jemi të vetëdijshëm për një rrëmujë në dukje të ligjëritit sot dhe heterogjenitetit të fakteve të gjuhës. Gjuha nuk është funksion vetëm i folësit por i të gjithë subjekteve që i përkasin komunitetit. Një përbërës i komunikimit ka të bëjë me efektin e mesazhit ndaj njerëzve që e marrin atë. Për çfarëdo arsyeje, nëse mesazhi nuk stimulon ndonjë reagim njohës, emocional, ose mënyrën e të sjellit, është e pakuptimtë t'a quajmë komunikim. Shpesh i quajmë këto situata si mesazhe

“që bien në vesh të shurdhër” ose personi tjetër “mbyll njërën sy”. Sipas një përkufizimi të kohëve të fundit, “komunikimi përbën ndarjen ose shkëmbimin e mendimeve, opinioneve ose informacionit nëpërmjet fjalës, shkrimit apo shenjave” (G. Schwartz et al., 2008: 129)

Mehrabian (1981) identifikoi tri pjesë të mëdha që përcjellin mendimin në komunikimin ballëpërballë: gjuhën e trupit (që përbën 55 për qind të impaktit), tonalitetin e zërit (38%) dhe fjalët (vetëm 7%, sipas përmbajtjes së tyre). Ajo që vihet re në analizimin e komunikimit politik të politikaneve gra është që ato përvec gjuhës së folur përdorin sidomos mimikën dhe gjeste të caktuara të cilat shpesh janë të huazuara nga liderët respektivë politikë. (Dhima, 2013)

Politika sot duket sikur është e përbërë nga njerëz të cilët dita ditës e kanë pothuajse të vështirë të prodhojnë ide politike, një politikë konstruktive, por dhe të komunikojë politikisht. Shumica e politikanëve ende nuk dinë të bëjnë dallim se çfarë është komunikimi politik: a është ai një dialog apo monolog? Një komunikim i tillë bëhet jo për imponim e përjashtim por për një pjesëmarrje dhe dëgjim të dyanshëm. Nënkupton më shumë qytetari e të vërteta në komunikim sesa vullgaritete, sharje e fyerje banale, shmangie nga e vërteta dhe përgjegjshmëria. Deri sot, komunikimi politik në vendin tonë ka krijuar një situatë tronditëse që ka zbehur dallimin primar mes të vërtetës dhe të pavërtetës, ligjit dhe antiligjit, të morales dhe të jomorales. Për të kuptuar komunikimin politik (gjuhën e pushtetit ose gjuhën e atyre që e synojnë atë), që është një komunikim veprimi dhe që lidhet drejtpërdrejt me atë që Edelman e quan politikë simbolike, duhet të shqyrtojmë realitetin politik, realitet i cili sipas tij, është një realitet i dyfishtë (dimensioni instrumental dhe ai ekspresiv-shprehës). (Edelman, 1985: 10-19)

Në fakt, kushdo që del në hapësirën publike për të thënë mendimin e tij, duhet të jetë i gatshëm për të duruar edhe adresime fjalësh që mund t'a lëndojnë. (Fuga, 2010) Në përgjithësi komunikimi në politikë është agresiv. Një grua që merr përsipër këtë rol ka një kurajo shumë të madhe. Duhet të marrësh parasysh që çfarëdo mund të ndodhë: mund të të fyejnë, mund të të thonë fjalë shumë të rënda sepse kultura politike verbale për fat të keq e politikanëve burra nuk është ajo e dëshiruara dhe ndonjëherë kjo tregon pafuqinë e tyre se ti mund t'a mundësh një njeri me argumenta dhe jo me fyerje. (Popoci, 2010)

Varianti “postmodernist”, i cili e shikon komunikimin politik si një shkëmbim të njëanshëm të mesazheve të pakuptimta në një peizazh mediatik të shkretëtë, mund të shpjegojë banalitetin e politikës dhe përjashtimin e debatit racional nga procesi. Një pionier i hershëm i kësaj pikëpamjeje ishte Daniel Boorstin, i cili sajoi termin “pseudongjarje”, si reagim ndaj asaj që ai e shikonte një prirje në rritje të medias masive për t'u shqetësuar me ndodhitë ose “të rejtat sintetike” jo reale, të pavërteta e të fabrikuara. (McNair, 2009)

1.2.1. Tradita socio-kulturore

Që një shoqëri të ekzistojë është i nevojshëm të zhvillohet procesi i komunikimit. (Dominick, 2010) Historia njerëzore dhe shoqërore na ka lënë trashëgim një shumësi mënyrash komunikimi: gjetet, të folurit, imazhin, shkrimin, etj., të cilat mund të funksionojnë ndaras por dhe në shumicën e rasteve mund të kombinohen dhe të ndërveprojnë në aktet e veçanta të komunikimit. (Meunier, 2009) Roli i komunikimit si dhe opinionit publik është parë si bazë e funksionit të demokracisë dhe ligjmërisë së saj politike.

Nëse ne do të fokusoheshin tek tradita socio-kulturore do t'a shikonim komunikimi si krijim dhe përdorim praktik të realitetit shoqëror. Tradita shoqërore kulturore bazohet në premisën që, ndërkohë që njerëzit flasin, ata prodhojnë dhe riprodhojnë kulturë. Shumë prej nesh e marrin si të mirëqenë që fjalët pasqyrojnë atë që ekziston realisht. Megjithatë, teoricienët në këtë traditë shprehen se ky proces shpesh funksionon anasjelltas. Teoricienët social-kulturore pohojnë se pikërisht përmes procesit të komunikimit, “*realiteti prodhohet, ruhet, riparohet dhe transformohet*” (Griffin, 2008). Dhe, bazuar në realitetin tonë politik, një teori e tillë gjen zbatim mjaftueshëm. Hipoteza e *Sapir-Whorf* e relativizmit gjuhësor: pretendimi se struktura e gjuhës i jep formë asaj që mendojnë dhe bëjnë njerëzit, mbi të cilën bëhet ndërtimi shoqëror i realitetit është mëse e vërtetë për realitetin politik në Shqipëri.

Një ndër nevojat prioritare të njeriut për sjellje normale sigurisht që është nevoja për komunikim. Procesi i komunikimit është pjesë e çdo aktiviteti dhe pjesë e jetës sonë të përditshme. Duke u bazuar në të se komunikimi është shumë i rëndësishëm në jetën tonë është e patjetërsueshme që të mendojmë se komunikimi është i pashmangshëm si në jetën organizative ashtu dhe në procesin e udhëheqjes. Komunikimi është me rëndësi për realizimin e suksesshëm të të gjithë funksioneve udhëheqëse, por është më kryesorja për realizimin e funksionit të udhëheqjes.

Komunikimi është në qendër të procesit politik. Shkrimtarja amerikane Doris Graber shkon më tej, me një përkufizim gjithëpërfshirës të asaj që ajo e quan “gjuhë politike”, duke sugjeruar se ajo përmbledh jo vetëm shenjat retorike, por edhe ato paralingustike si gjuha e trupit, dhe aktet politike, si bojkotet dhe protestat (McNair, 2009). Një komunikim i mirë

politik nuk është i rëndësishëm vetëm për liderë e funksionarë të lartë partiakë, për mbajtës mandatesh të larta dhe seli partiake, por edhe për organizata vendore, për menaxherë fushatash zgjedhore dhe liderë të mandatur nga rrafshi lokal apo dhe kandidatë.

Një komunikim i mirë politik është i rëndësishëm dhe domethënës si themel për punën në një parti, për komunikimin me qytetarin dhe për zgjedhjet e ardhshme në Shqipëri.

Synimi i tërë këtij komunikimi është të bindë audiencën. Dhe objektivi i kësaj bindjeje – audience- është elementi i dytë kyç në procesin e komunikimit politik, pa të cilin asnjë mesazh politik nuk mund të ketë asnjë kuptim. Prandaj, me komunikimin politik, do nënkuptojmë jo vetëm deklaratat verbale apo të shkruara, por edhe mjetet vizuale domethënëse, siç janë veshja, make-up-i, hartimi i logos, domethënë të gjithë ato elementë të komunikimit, të cilat mund të thuhet se krijojnë një imazh ose një identitet politik (McNair, *vep. cit.*).

Realitetin politik (kemi parasysh këtu rastin e Shqipërisë) mund t'a shohim si përfshirje të tri kategorive:

- realiteti politik objektiv, duke përfshirë ngjarjet politike që ndodhin në të vërtetë.
- realiteti subjektiv-realiteti i ngjarjeve politike siç perceptohen nga aktorët dhe qytetarët
- realiteti i ndërtuar, që nënkupton ngjarjet të raportuara sipas medias.

Kultura politike demokratike që duhet të arrihet përmes debatit publik të llojllojshëm e kundërthënës mbështetet gjithashtu në argumentet e aftësisë për të bindur. Gjen zbatim këtu gjithashtu edhe tradita retorike, ku *retorika* nuk është mjeshtëri formale e elokuencës, por më shumë aftësi për të ndërtuar argumente në mbrojtje të një çështje. Aristoteli në fakt e

përkufizon si një fuqi vlera e së cilës varet nga mënyra se si një orator e përdor: si formë për të zhvilluar gjykimin politik dhe kultivuar vlerat etike por dhe si vegël e “korrupsionit të gjykimit” nga demagogët. (Kullashi, 2005: 38)

Demagogu është ai që di të nxisë pasione te masat, ti mashtrojë ato, t'i bëjë lajka paragjytimeve dhe dobësive të tyre apo edhe të ushqejë dëshirat e tyre duke bërë të dëgjojnë atë që ato dëshirojnë apo dhe t'a shohin veten ashtu si kanë qejf ta shohin.

Teorikisht të paktën, në një shoqëri pluraliste, të gjitha grupet duhet të komunikojnë me njëri-tjetrin, duhet të komunikojnë midis tyre si edhe të konkurrojnë me njëri-tjetrin. Sa më i madh numri i zërave konkurrues, aq më intensive do të jetë konkurrenca dhe si dhe aq më shumë do kërkojnë grupet të komunikojnë më mirë me publikun që të jenë të dëgjuar.

Shumica bien dakord se procesi me të cilin komunikimi politik zhvillohet ka evoluar, sot ky komunikim bëhet teknikisht dhe teknologjikisht më i sofistikuar, dhe pse duhet pranuar që evoluimi teknologjisë në shek. XX-të nuk ka dhënë ndikim vetëm në procesin e komunikimit politik. Megjithatë, një nga format më të hershme, ndoshta më efektive, është komunikimi politik i drejtëpërdrejtë ose i ndërmjetësuar përmes takimeve publike, ku aktivistët politikë zhvillojnë jashtë zyrave takime duke mbajtur fjalime dhe duke mbledhur sa më shumë njerëz rreth vetes.

Në thelb, kultura, është një grup vlerash të përbashkëta që një grup njerëzish mban. Të tilla vlera ndikojnë në mënyrën se si ne mendojmë dhe veprojmë dhe ajo që është më e rëndësishmja ndikojnë në llojin e kritereve me të cilat ne gjykojmë të tjerët. Dhe janë kuptimet kulturore ato që i bëjnë disa sjellje si normale e të drejta dhe disa të tjera të

çuditshme apo të gabuara. Çdo aspekt i komunikimit global ndikohet nga dallimet kulturore. Madje edhe zgjedhja e mediumit që përdoret për të komunikuar mund të ketë dallime kulturore.

Për shembull, vendet e industrializuara mbështeten shumë në teknologjinë elektronike dhe i japin rëndësi më shumë mesazheve me shkrim krahasuar me komunikimin oral ose ballë për ballë. (SHBA, Gjermani, Britania e Madhe etj.). Ndërsa, nëse do t'i referohemi Japonisë, e cila ka avancim në teknologji, ka qasje në teknologjinë më të fundit, ky shtet i referohet dhe i jep më shumë rëndësi komunikimit “ballë për ballë” se sa mënyrës së shkruar. Sigurisht që nuk është faktor përcaktues shkalla e industrializimit. Pra ka kultura që kërkojnë mesazhe të qarta dhe specifike ashtu sikurse ka kultura që e kërkojnë kuptimin dhe mirëkuptim në atë që nuk thuhet - në gjuhën e trupit.

1.3. Teoritë feministe

Për shumë teoricienë feministë bashkëkohorë, koncepti i gruas është një “problem”. Është një problem me rëndësi sepse ky koncept është koncepti bazë, koncepti qendror për teoritë feministe e megjithatë ai është vështirësisht i përcaktuar nga feministët, sepse koncepti “grua” është i tejmbushur me mbingarkesat e epërsisë mashkullore. Në përpjekjen për të folur për gratë, “feminizmi” shpesh duket se supozon që di se çfarë janë gratë në të vërtetë, por një supozim i tillë është i pavërtetë, duke pasur parasysh se çdo burim njohurish për gratë ka qenë “i ndotur” me seksizëm.

Nëse do të referohemi tek idetë feministe të shkrimtares Simone de Beauvoir, vepra e së cilës “Seksi i dytë” ka qenë frymëzuese dhe referencë e lëvizjes feministe botërore, them se

përkufizimi i bërë nga ana saj e tregon më së miri qëllimin e kësaj teze: “*Burri përkufizohet si qenie njerëzore ndërsa gruaja si femër – e sa herë që ajo sillet si njeri, thuhet se imiton burrin.*” (de Beauvoir, 2002)

Individi, sipas de Bovuarit, formohet nga ligjet shoqërore dhe në veçanti nga ato të gjinisë, sipas saj *grua nuk lind, grua bëhesh.* (de Beauvoir, vep. cit.) Pra, nuk është natyra ajo që të bën të jesh grua e nënshtruar, që të bën të jesh seks i dytë, por janë rrethanat shoqërore, dhe asnjë ligj biologjik ose ekonomik nuk e cakton formën që qenia femërore merr nga shoqëria.

Për çështje terminologjie, ndjej të nevojshme që paraprakisht të bëj dallimin midis konceptit *seks* dhe *gjini*: “I pari ka të bëjë me dallimin biologjik, ndërsa i dyti është termi i përdorur për të përshkruar kategori shoqërore të ndërtuara në bazë të një seksi të caktuar.” (Coates, 1993: 3)

Me pak fjalë, lindja është e një gjinie të caktuar, por ato të cilat përcaktojnë mënyrën se si ne flasim janë ndikimet shoqërore dhe kulturore që na rrethojnë.

Batleri beson se maskiliniteti dhe feminiteti nuk janë tipare tona të lindura, por janë rezultati i performancës sonë në aktivitetet në të cilat marrim pjesë, ku gjinia negociohet sipas ngjarjes apo situatës, pra meshkujt dhe femrat negociojnë një vazhdimësi feminiteti dhe maskiliniteti, çka përcaktohet nga shenjimi gjuhësor dhe roli që ata kanë në një veprimtari të caktuar (Butler, 1990). Identiteti gjinor shihet më tepër si një formësim shoqëror sesa si një kategori e caktuar shoqërore, pra, folësit mendohet se ‘e ndërtojnë gjininë’ jo thjesht se i përkasin një gjinie të caktuar. Gjithashtu, Eckert dhe McConnell-

Ginet argumentojnë se përkufizimi ‘mashkullor’ dhe ‘femëror’ si dhe perceptimi mashkull/femër që kanë njerëzit për veten dhe për të tjerët, në fund të fundit, është shoqëror. (McConnell-Ginet, 2003). Ndërsa Coates thotë se “*në çdo kohë, do të ketë një sërë manifestimesh femërore dhe mashkullore që ekzistojnë në një kulturë të caktuar, të cilat dallojnë në varësi të klasës, orientimit seksual, përkatësisë etnike dhe moshës, të cilat bashkëveprojnë në mënyra komplekse.*” (Coates, 2007: 67)

Feminizmi është një nga ideologjitë që ka lindur më vonë dhe përpiket që të analizojë pozicionin social të grave, të shpjegojë rolin e tyre të rëndësishëm në histori dhe të ofrojë bazat për reformimin dhe progresin e grave në të gjitha fushat e shoqërisë. (Harrison & Boyd, 2003: 295) Pavarësisht kësaj, kjo nuk të thotë që ‘feminizmi’ është shfaqur dhe ekziston si një ideologji apo si praktikë në çdo parti politike dhe aq më pak në partitë politike shqiptare. Ashtu siç shkruan dhe Lisa Young në librin e saj mbi “*Feministët dhe Politikën Partiake*” ‘jo të gjitha gratë janë feministe, dhe shumë gra të përfshira në politikën partiake nuk e pranojnë idenë që përfshirjen e tyre në politikë e kanë bërë në bazë të përfaqësive feministe apo për të reformuar partitë politike’. (Young, 2000: 11) Kështu që ndoshta fjala ‘feminizëm’ do ishte më pak e përshtatshme për të karakterizuar ‘problemet e gruas’ në Shqipëri. Por edhe në qoftë se do të përdornim këtë përcaktim të fundit, ai duket se është më shumë i huazuar nga fjalori i Partisë Socialiste sesa ai i Partisë Demokratike, dhe të paktën zyrtarët publikë shqiptarë që merren me këtë problem i referohen si ‘çështjet gjinore’. Megjithatë duke ju referuar teorive feministe ‘gjinia’ është diçka e ndërtuar dhe ne nuk lindim ‘vajzë’ apo ‘djalë’ por ndërtohem me anë të praktikave diskursive dhe në qoftë se do të përdornim kategorinë ‘gjinia’ thjesht do të rigjeneronim apo ripërsërisnim edhe një

herë ndarje që sipas disa teorive feministe nuk duhet të ekzistojnë sepse të gjithë lindim të barabartë. Kështu që problemi është shumë i ndërlikuar dhe në përgjithësi në botën akademike nuk ka një konsensus midis teorive të ndryshme feministe.

Deri tani, tendencat kryesore si nga PD-ja dhe PS-ja kanë qenë për një përfaqësim më të barabartë midis grave dhe burrave, materializuar dhe me vendosjen e kuotave në Kodin e Ri Elektorale, për shkak të përfaqësimit të ulët që gratë kanë pasur gjatë viteve të tranzicionit në Kuvendin e Shqipërisë. Por ashtu siç edhe e ka treguar shpesh dhe realiteti, problemi nuk qëndron tek përfaqësimi i grave në politikë, problem është mentaliteti i cili është i rrënjësor jo vetëm tek burrat por edhe tek gratë. Shoqëria shqiptare vazhdon të mbetet një shoqëri akoma shumë patriarkale dhe mentaliteti mbizotërues është që ndërmjet një femre dhe një mashkulli, ky i fundit është i avantazhuar madje dhe nga vetë gratë. Ashtu siç e përshkruan dhe Lisa Young, një nga problemet me partitë politike është shqyrtimi apo analizimi i tyre për të parë nëse janë thjesht parti politike të mbizotëruara nga meshkujt dhe në këtë mënyrë ka mundësi që të transformohen nga gratë apo patriarkalizmi tek ato është i trashëgueshëm (Young, 2000: 4) dhe, siç do të tregoj në pjesët e tjera të këtij studimi, në PD dhe PS, patriarkalizmi është me sa duket i trashëgueshëm. Rrjedhojë e kësaj dukurie në partitë politike shqiptare nuk është dhe aq korniza ligjore ekzistuese, megjithëse dhe ajo nuk është e plotësuar, por është një dukuri që nis që në sferën private ku preferenca ndaj një fëmije mashkull është e dukshme dhe që shfaqet më pas edhe në sferën publike.

Përsa i përket statistikave ndërkombëtare, Indeksi i Institucioneve Sociale dhe Gjinore (SIGI) për vitin 2009 e rendit Shqipërinë në vendin 51 nga 114 gjithsej. Ky indeks ndërkombëtar bën një analizim të institucioneve sociale dhe gjinore duke u bazuar në disa

variabla si kodi i familjes (martesat e hershme, poligamia, autoriteti prindëror, trashëgimia); integriteti fizik (dëmtimi i organeve gjenitale femërore, dhuna kundër grave), preferenca ndaj djemve (zhdukja e grave), liritë civile (liria e lëvizjes, liria e veshjes) dhe të drejtat e pronësisë (e drejta e pronësisë ndaj tokës, e drejta për të marrë kredi në bankë dhe të drejtën për të trashëguar). Sipas këtij indeksi, Shqipëria ka problem integritetin fizik të grave, të cilat janë pak të mbrojtura. Kushtetuta shqiptare nuk përmban ndonjë parashikim të veçantë në lidhje me dhunën familjare, përdhunimin bashkëshortor, ngacmimin seksual ose dhunimin e organeve gjenitale femërore, megjithëse ligji shqiptar i dënon këto praktika (SIGI, 2009; <http://genderindex.org>), por si pjesë e Kodit penal dhe jo e Kodit të familjes. Gjithashtu sipas këtij indeksi, gratë në Shqipëri nuk kanë të drejta të plota për pronësi, në qoftë se ato martohen është e rrallë që të trashëgojnë tokën si dhe nuk kanë të drejta civile të plota, lëvizja e lirë e tyre është e kufizuar nga tradita e cila kërkon që gratë të lëvizin në familjen e burrit pasi të martohen (SIGI, po aty). Tradita lokale duket se përcakton dhe karakteristikat që një grua e përfshirë në politikë duhet të ketë.

Edhe pse qëllimi i *feminizmit* është përmbysja e patriarkatit dhe fundi i mbizotërimit të seksit, feministët kanë qenë të paqartë se çfarë nënkupton kjo në praktikë dhe se çfarë mund të sjellë. Disa feministë mbrojnë më shumë “dallimin” sesa “barazinë”. Feministët e dallimit vështrojnë nocionin e vërtetë të barazisë së konceptuar keq ose thjesht të padëshirueshëm. Të duash të jesh i barabartë me një burrë bën që gratë të jenë “mashkull i identifikuar”, në atë që ata përcaktojnë qëllimet e tyre në terma se çfarë janë burrat ose çfarë kanë burrat. Kërkesa për barazi simbolizon kështu një dëshirë për të qenë si “burrat” (Filo; Cici; Grillo, 2008: 301)

1.4 Kuadri ligjor

Të drejtat e grave

Si pjesë e pandarë e të drejtave dhe lirive të njeriut janë dhe të drejtat e gruas. Këto të drejta ne i gjejmë të vendosura në Kushtetutën tonë por dhe në aktet e ratifikuara ndërkombëtare. Dhe këto akte të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të grave janë si më poshtë të përmendura: (Anastasi, 2010)

1. “Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (CEDAW), ratifikuar në vitin 1994, si dhe protokoli shtesë i kësaj Konvente.

Në nenin 11 theksohet se shtetet, të cilat e kanë ratifikuar këtë konventë, duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar të drejta të barabarta mes grave dhe burrave.

Neni 7: Shtetet palë marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin e gruas në jetën politike dhe publike të vendit. Në mënyrë të veçantë i siguron, në kushtet e barazisë me burrat të drejtën që ajo:

- Të votojë në të gjitha zgjedhjet dhe në të gjitha referendumet publike, si dhe të zgjidhet në të gjitha organizmat publikisht të zgjedhura.
- Të marrë pjesë në përpunimin e politikës qeveritare dhe në zbatimin e saj; të punojë në poste publike dhe të kryejë të gjitha funksionet publike në të gjitha hallkat e qeverisjes;
- Të marrë pjesë në organizatat dhe shoqatat joqeveritare që merren me jetën publike dhe politike të vendit.

2. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998 e cila ka sanksionuar parimin e barazisë dhe atë *barazisë gjinore si parime kushtetuese*, të cilat përshkojnë dhe lidhen me të gjitha të drejtat e parimet e tjera themelore të sanksionuara në Kushtetutë. “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të

tilla si gjinia”. (Neni 13, pika 1 dhe 2) Zbatimi i këtij parimi, mbetet një kusht i domosdoshëm për mbarëvajtjen e të gjithë veprimtarisë së organeve shtetërore, përfshirë edhe ligjvënësin gjatë hartimit e miratimit të ligjeve.

Në mënyrë të veçantë, **Kushtetuta** kërkon nga legjislacioni shqiptar që të garantojë *të drejtën për t’u martuar dhe pasur një familje, të drejtën për kujdes shëndetësor, të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri dhe në rastin e paaftësisë për punë, etj.*

Përveç garantimit të tyre në kuadrin e të drejtave për të gjithë individët, Kushtetuta ka sanksionuar të drejtën për një mbrojtje të veçantë nga Shteti, për *gratë shtatzëna dhe nënat e reja, si dhe për fëmijët e të rinjtë*. Kjo do të thotë se është detyrë e ligjvënësit dhe e qeverisë shqiptare që, të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar një mbrojtje të veçantë për këto kategori, duke respektuar parimin e barazisë gjinore. Për garantimin e të drejtave të gruas, një rol të veçantë luajnë ligjet, të cilat rregullojnë në mënyrë të hollësishme të drejtat e sanksionuara në Kushtetutë, ose shpallin të drejta të tjera me karakter ligjor. Në 20-vjeçarin e fundit legjislacioni shqiptar ka pasqyruar standardet dhe detyrimet e përcaktuara nga aktet ndërkombëtare për të drejtat e grave (Anastasi, 2010).

3. Kodi i Familjes, i cili rregullon lidhjen dhe zgjidhjen e martesës, marrëdhëniet midis bashkëshortëve, si dhe marrëdhëniet midis tyre e fëmijëve. Ky ligj bazohet në parimin e barazisë gjinore në jetën private e familjare.

4. Kodi Zgjedhor, përmban dispozita të rëndësishme që garantojnë jo vetëm të drejtën e votes për gratë, por edhe të drejtën për t’u zgjedhur në organet e larta përfaqësuese, qendrore e vendore.

Kodi i ri elektoral i miratuar më 19 Nëntor 2008, sanksionoi përfundimisht zbatimin e kuotave të përfaqësimit gjinor në listat shumëmemërore të partive politike për zgjedhjet e

përgjithshme. Gjithashtu në Kod tentohet të vendoset edhe renditja e gjinive si vijon në nenin 65 të tij: *Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumëmemërore dhe/ose një në tre emrat e parë të listës shumëmemërore duhet t'i përkasë secilës gjini.*

5. Kodi Civil u njeh grave të drejta të barabarta në të gjitha proceset ligjore, siç është e drejta për të ngritur padi ndaj dikujt apo për t'u gjykuar.

6. Kodi Penal siguron barazinë mes burrit dhe gruas në të gjitha fushat e jetës, shëndetit, pronës dhe dinjitetit. Gratë marrin të njëjtat dënime si burrat për krime të njëjta.

7. Kodi i Punës njeh të drejta të barabarta për punë midis burrit e gruas, për mbrojtjen e gruas në vendin e punës, për pushime të paguara dhe pagesë të barabartë. Formulimet e neneve në Kodin e Punës bazohen në standardet ndërkombëtare të punës

8. Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri”, rregullon marrëdhëniet shoqërore në jetën publike, veçanërisht në fushën e arsimit, të punës dhe të shërbimeve në bazë të parimit për barazi gjinore në shoqëri. Njohja dhe zbatimi i dispozitave të ligjit, janë mjaft të rëndësishëm për mbrojtjen e këtij parimi. Për mbrojtjen e të drejtave të gruas, ky përfaqëson një ligj themelor, prandaj të gjitha çështjet e këtij punimi trajtohen në lidhje me ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”. Ky ligj plotëson në mënyrë të dukshme kuadrin ligjor mbi barazinë gjinore në Shqipëri dhe për herë të parë përfshin zbatimin e kuotave minimale të përfaqësimit të çdo gjinie (30%) në listat shumëmemërore të kandidatëve për deputetë në zgjedhjet e përgjithshme.

9. Edhe ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, është mjaft i rëndësishëm, pasi rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe të mosdiskriminimit, jo vetëm në lidhje me gjininë, por edhe për çdo shkak tjetër.

10. Gjithashtu, **Urdhëri Nr. 183, datë 23.06.2014** i Kryeministrit “Për përgatitjen dhe hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2014-2020”, ka si parime kryesore udhëheqëse:

- ***Barazia gjinore, kusht për një shoqëri të drejtë e socio-ekonomikisht të zhvilluar*** - njohja dhe respektimi i barazisë gjinore; përmirësimi i statusit social, ekonomik dhe shëndetësor i grave dhe sidomos i grave që pësojnë diskriminim të shumëfishtë²; edukimi, përparimi dhe angazhimi politik i tyre duke iu ofruar mundësi të barabarta njëjloj si dhe djemve e burrave, janë parakushte për zhvillimin e gjithanshëm të vendit.
- ***Ndjeshmëri dhe trajtim i barabartë ndaj nevojave të veçanta të të dyja gjinive*** – vajzat/gratë dhe djemtë/burrat kanë nevoja të ndryshme dhe përballen me forma të ndryshme të dhunës e diskriminimit. Prandaj dhe veprimet e parashikuara duhet të ofrojnë mundësi për trajtimin në përshtatje me këto nevoja dhe përvoja – barazia nuk duhet ngatërruar me njëtrajtshmërinë: jemi të ndryshëm, por duhet të jemi të barabartë, jo të ngjashëm.
- ***Njohja, vlerësimi dhe respektimi i diversitetit*** - ndërmjet vajzave dhe grave, djemve dhe burrave, për sa i përket moshës, aftësisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, origjinës etnike dhe shoqërore, praktikave fetare dhe zgjedhjeve jetësore.
- ***Tolerancë zero kundrejt dhunës ndaj grave e dhunës në familje*** - mbrojtja e jetës, dinjitetit dhe integritetit njerëzor, është parakusht për zhvillimin e një vendi: çdo formë dhune është sulm mbi dinjitetin njerëzor dhe shkelje e të drejtave të njeriut, ndaj nuk duhet të tolerohet.

² Të kuptohen gra dhe vajza me aftësi të kufizuara, rome, egjiptjane, të moshuara, emigrante, vajzat-nëna, LBT, etj

- ***Koordinimi dhe bashkëpunimi ndër-institucional*** – nisur nga karakteristikat dhe natyra ndërsektoriale e çështjeve që përbëjnë shtyllat e kësaj strategjie, institucionet shtetërore, organizatat e shoqërisë civile, media, sektori privat, institucionet fetare, organizatat ndërkombëtare si dhe të gjithë aktorët dhe partnerët e interesuar, duhet të punojnë së bashku duke koordinuar veprimet për të adresuar sa më efektivisht pabarazitë dhe padrejtësitë me bazë gjinore për gratë/vajzat dhe burrat/djemtë.

11. Ligji Për Masat Kundër Dhunës në Familje përbën një nga nismat më të suksesshme për përafrimin e legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare në fushën e legjislacionit kundër dhunës në familje. Ky ligj është pjesë thelbësore e kuadrit antidiskriminues të legjislacionit shqiptar, hartuar në vazhden e zbatimit të akteve të detyrueshme ndërkombëtare, si CEDAW, apo akteve të tjera të miratuara nga Bashkimi Evropian. Ky ligj u paraqit në Parlament me kërkesë-firmën e 20.000 qytetarëve shqiptarë.

12. “Konventa ndërkombëtare për të drejtat civile e politike” (KNDCP), ratifikuar në vitin 1991.

13. “Konventa ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale e kulturore” KNDESK, ratifikuar në vitin 1991.

14. “Konventa Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, KEDNJ, ratifikuar më 1995.

Kushtetuta nënvizon se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Kjo është e përcaktuar në pjesën e dytë e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ndërsa specifikisht në kontekstin e të drejtave të grave, një vend të veçantë zëneni 18 i

Kushtetutës, i njohur ndryshe edhe si neni antidiskriminim. Liritë dhe të drejtat vetjake gjenden të trajtuara në kreun e dytë, dhe ndër këto liri dhe të drejta përmendim si më poshtë:

- E drejta e jetës
- E drejta e informimit
- Liria e shprehjes, e ndërgjegjes dhe e fesë
- Ndalimi i torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues
- Ndalimi i punës së detyruar
- Mbrojtja e të dhënave personale
- Liria dhe fshehtësia e korrespondencës
- Paprekshmëria e banesës
- E drejta e lëvizjes së lirë dhe e zgjedhjes së vendbanimit
- E drejta e pronës private
- E drejta e ankimit

Por sa respektohen këto të drejta?

Ne ndeshemi çdo ditë me lajme si në shtypin e shkruar dhe atë mediatik për gra dhe vajza thuajse dhe nga e gjithë bota, të cilat bien “viktima të dhunës” duke vënë veten e tyre në rrezik duke luftuar çdo ditë me varfërinë, diskriminimin dhe dhunën në mënyrë që familjet e tyre të mund të jetojnë një jetë më të mirë. Por kur gratë janë të përjashtuara dhe të viktimizuara, edhe shoqëritë nuk “ndihen” mirë.

Institucionalizimi i të drejtave të grave është një aspekt kyç i zhvillimeve dhe një aspekt i rëndësishëm i politikës bashkëkohore në Shqipëri. Por se si burrat shqiptarë i kanë kuptuar

këto zhvillime dhe se si ato janë të implikuar në këto ndryshime, lë shumë për të dëshiruar. Maskuliniteti konsiderohet një objektiv për të shqyrtuar lidhjet ndërmjet marrëdhënieve gjinore dhe të drejtave të njeriut, pasi njëkohësisht shikohet dhe si shkaku kryesor që riprodhon hierarkitë gjinore dhe pabarazitë gjinore. Ky maskulinitet nuk mund të pretendohet që është unik për çdo vend dhe njëkohësisht statik, sepse ai ndryshon jo vetëm në kohë por dhe në hapësirë (nivel lokal, rajonal dhe global).

Ndërsa në kreun e tretë të Kushtetutës trajtohen të drejtat dhe liritë politike, ku përfshihen:

- E drejta aktive dhe pasive e votimit (e drejta të zgjedhë dhe të zgjidhet)
- E drejta e organizimit kolektivisht
- E drejta për të drejtuar kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike

E drejta për t'u zgjedhur rregullohet në mënyrë të barabartë për të gjithë, si për gratë edhe për burrat, por dhe kjo nuk mjafton për të eliminuar barrierat e krijuara nga shoqëria dhe klasa politike shqiptare për pjesëmarrjen e gruas në qeverisje. Pavarësisht dhe apeleve të ripërsëritura ndërkombëtare për pjesëmarrje prej 30 për qind të femrave në politikë, skena e realitetit shqiptar mbizotërohet ende nga meshkujt. Në Shqipëri, pas ndryshimit të sistemit në fillimin e viteve 1990, ashtu sikurse cdo gjë tjetër edhe pozita e femrës në shoqëri ka kaluar periudhën e saj të tranzicionit. Për të bërë të mundur apo synuar dhënien e mundësive të barabarta të grave në cdo fushë të jetës, shteti shqiptar nga ana e tij ka miratuar ligjet e barazisë gjinore. Por faktor moszbatimi i ligjit për barazinë gjinore, është edhe pjesëmarrja e ulët në vendimmarrje e grave. Sado që ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” i miratuar në 2008 si kriter për këtë, vendosi një kuotë përfaqësimi në masën mbi 30 për qind për secilën gjini, sërish kjo kuotë nuk gjeti mbështetjen e duhur nga ana e

partive politike për t'u zbatuar plotësisht. Ndaj edhe pse këto të gjitha vërtetë janë sanksionuar me ligj, gjithsesi në praktikë për të mos thënë shumicën e rasteve, disa herë janë problematike.

Përmbledhje kapitulli

Në këtë kapitull të parë kemi bërë një vështrim dhe një përshkrim të përgjithshëm të situatës në aspektin teorik, duke u fokusuar kryesisht tek teoritë e komunikimit, teoritë feministe dhe të drejtat e gruas sipas legjislacionit në fuqi në Shqipëri.

Duke qenë se rolet gjinore nuk janë njësoj në çdo vend, por secila shoqëri ka pritshmëri të caktuara mbi burrat dhe gratë, nuk është barazia gjinore ajo e cila imponon mohimin e identitetit qoftë femëror apo mashkullor, por është ajo që inkurajon vendosjen e marrëdhënieve të ndërsjellta, të ndërvarura dhe jo diskriminuese në shoqëri.

Ambjenti politik historikisht ka qenë domen i burrave, jo vetëm në Shqipëri, por në gjithë botën. Për rrjedhojë, gratë e kanë të vështirë të zhvillojnë vetëbesimin që nevojitet për të kandiduar për poste publike. Historia e pushtetit është gjithashtu histori mashkullore, edhe pse gjatë shekullit të fundit në të gjithë botën ka një lëvizje tepër të madhe të grave për të qenë edhe ato pjesë e pushtetit dhe kjo është gjëja më e natyrshme për çdo shoqëri. Por, edhe në Shqipëri qëndrimet po ndryshojnë dhe po bëhen më pranuese ndaj grave politike. Arritje të lëvizjes së gruas konsiderohen edhe format e organizimit të saj, që nga organizatat jo-fitimprurëse, deri në koalicione dhe rrjete.

Përsa i përket komunikimit, është ai i cili po bëhet gjithnjë e më shumë një armë shumë e fortë e projektimit të imazhit të partive politike, qeverisë, organizatave, korporatave etj. Madje, komunikimi po bëhet sfida që diferencon institucionet e gjithë spektrit, por edhe partitë politike nga njëra-tjetra, veçanërisht gjatë fushatave elektorale, duke promovuar në mënyrën më efektive të mundshme programet, vizionin, idetë, politikat, resurset e tyre. Situata politike, përsa i përket komunikimit, në vend është pothuajse në një lloj tensioni,

gjatë gjithë kohës dhe për më tepër në kohë zgjedhjesh qofshin këto parlamentare apo lokale. Mendoj se deri diku përdorimi i një fjalori të ashpër është forma e duhur për të vendosur autoritetin në rrethin me të cilin punon dhe ndërvepron çdo ditë. Gratë e politikës e dinë se vështirë të kesh të ardhme nëse do të sillesh në politikë ndryshe: si një “shtëpiake” kokëulur, si një grua e mirë, e urtë e zemërbutë, por ato duhet të krijojnë një shëmbëlltyrë të meshkujve femër në parti / politikë. Por konfliktet ashtu si dhe gjuha politike, janë të dyja pjesë e politikë-bërjes, pa të cilat nuk mund të ekzistojë një shtet demokratik.

Pjesëmarrja e gruas sjell një realitet ndryshe në politikën shqiptare. Feminizmi si ideologji ka lindur vonë dhe synimi i kësaj lëvizje ka qenë analizimi i pozicionit shoqëror të grave, dhënia shpjegim mbi rëndësinë e rolit të tyre në histori, pra edhe pse qëllimi i feminizmit është përmbysja e patriarkatit dhe fundi i mbizotërimit të seksit, feministët kanë qenë të paqartë se çfarë nënkupton kjo në praktikë dhe se çfarë mund të sjellë. Kështu që ndoshta fjala ‘feminizëm’ do ishte më pak e përshtatshme për të karakterizuar ‘problemet e gruas’ në Shqipëri. Kushtetuta nënvizon se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Kjo është e përcaktuar në pjesën e dytë e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Por krahas Kushtetutës së Shqipërisë, vendi ynë ka edhe shumë akte të tjera të ratifikuara të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të grave, të tillë si: Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave; Konventa ndërkombëtare për të drejtat civile e politike; Konventa Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut etj.

KAPITULLI II: KUOTA GJINORE NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR

2.1. Kuotimi gjinor si koncept

Ndërkohë që beteja për barazinë gjinore daton në shekullin e XVIII-të, për kuotat gjinore ajo është shumë më e vonëshme, ashtu sikurse koncepti i kuotave gjinore.

Në fillimet e viteve '90 koncepti i Kuotimit gjinor, ishte akoma i paqartë për shumë vende të rajonit, përfshi këtu edhe Shqipërinë. Ka pasur mendësi (jo vetëm nga meshkuj, por edhe femra qoftë politikanë, apo jo), se kuota “dëmton” dinjitetin njerëzor, është një lloj diskriminimi, etj. Një nga qëllimet kryesore të kuotës ishte që të garantohej një përfaqësim i detyrueshëm i të dyja gjinive në organet e zgjedhura. Këto kuota synojnë përmirësimin e barazisë gjinore jo vetëm në politikë por edhe në organet vendimmarrëse të ekzekutivit, administratës publike, si dhe në sektorin privat. Pavarësisht përcaktimit të përgjithshëm apo mendimit mbizotërues: “kuota gjinore”, këto kuota janë “kuota për gratë”, në përgjithësi sepse gratë janë ai grupi i nënpërfaqësuar i shoqërisë, pavarësisht se përbëjnë 50 për qind të popullsisë në çdo vend.

Por në vendin tonë qysh në fillim, u ndeshëm me mendimin se ajo që kërkohet ishte rezultat i një paragjykimi. Partitë e para në rajon që pranuan sistemin e kuotimit, ishin partitë Social Demokrate dhe Demokrate liberale, që filluan ta trajtojnë kuotën si çështje të dinjitetit politik të familjes së tyre politike, pavarësisht nga vështirësitë nëpërmjet të cilave ka kaluar ky proces. Realiteti ka treguar që gratë e përzgjedhura sipas sistemit të kuotimit në nivelin bazë, janë hequr nga lista nga niveli qendror i partisë. Prandaj është bërë një domosdoshmëri tashmë, që këto ndryshime të reflektohen në ligjin elektoral. Sidoqoftë

eksperiencat apo edhe statistikat nga ato vende ku janë vendosur dhe aplikuar këto kuota vërtetojnë që janë pikërisht këto kuota, ato që mundësojnë ndryshimin në politikën e barazisë publike, nga “mundësi të barabarta” në “barazinë e rezultateve”.

Përfaqësimi i gruas në çdo instancë në institucionet në vend apo në politikë është tejet i rëndësishëm. *“Plotësimi i kuotave në masën 30 për qind të grave në partitë politike është një hap drejt avancimit të përfaqësimit të gruas. Partitë politike kanë vendosur brenda organizimit të tyre partiak, të rrisin këtë përfaqësim edhe më shumë, duke arritur në masë 50%. Madje, sipas Kodit Zgjedhor, në nenin 174 të tij, parashikohet që në qarqet ku partitë nuk kanë respektuar ligjin për 30 për qind gra në lista, edhe nëse ikën një burrë nga Parlamenti, ai duhet zëvendësuar nga një grua që mund të jetë edhe e fundit në listë.”*- shprehet Znj. Klajda Gjoshja, Ministre e Integritimit European (Gjoshja, 2017).

2.1.1 Në legjislacionin shqiptar

Njerëzit lindin të barabartë, ndaj si gratë dhe meshkujt, pavarësisht se nuk kanë jetuar dhe nuk e kanë zhvilluar statusin e tyre socio-politik si të tillë përgjatë kohës, janë të barabartë. Ne të gjithë jemi të ndërgjegjshëm dhe koshient që diskriminimi kundrejt femrave është prezent, por a mund dhe si mund të ndreqet ky gabim? Sigurisht që po. E drejta për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur është e garantuar nga Kushtetuta e Shqipërisë. Kjo e drejtë rregullohet në mënyrë të barabartë për të gjithë, si për gratë edhe për burrat, por kjo nuk mjafton për të eliminuar barrierat e krijuara nga shoqëria dhe klasa politike shqiptare për pjesëmarrjen e gruas në qeverisje. Është e nevojshme të adoptohen disa masa të veçanta, jo vetëm në politikën e ndjekura nga shteti, por edhe në legjislacion. Dhe si metodë për të rritur këtë balancë gjinore në institucionet politike shërbejnë kuotat, *kuota legislative*

gjinore. Si pasojë e përpjekjeve shumë të mëdha mbi 20 vjeçare të lëvizjes së gruas shqiptare, e cila bashkëpunoi edhe me faktorë ndërkombëtare, sot prania gruas në politikë është mbi 17%, në krahasim me 5 apo 10 për qind që ishte rreth 18 vjet, pas ndryshimeve social politike në vend. Kuotat janë masa që duhen marrë për të bërë të mundur që femrat të kenë një përqindje ose numër të caktuar përfaqësimi në çdo institucion, qoftë qeveri, asamble parlamentare, komision apo edhe listë kandidatësh. Shumë vende këto kuota i aplikojnë për një periudhë të caktuar kohore, sa janë të nevojshme për të kapërcyer barrierat e futjes së femrave në politikë. Dhe këto rregullime bëhen me synim shtimin e tyre (femrave) në numër pasi përgjithësisht mendohet se janë të nënpërfaqësuar. Asnjë nga gjinitë nuk duhet të ketë më shumë se 60 për qind dhe as më pak se 40 për qind të vendeve në institucione të ndryshme.

“Nëse ne do ti referohemi kuotave gruaja është më e përfaqësuar se nga çka qenë më parë, para 12 vitesh kur unë mora mandatin e parë në parlament. Pra nëse ne do ti referohemi atyre ato sollën përfaqësim të lartë përfshi këtu dhe qeverinë e cila pati nivelin më të lartë të përfaqësimit. Dhe në organet e tjera vendimmarrëse gratë janë të përfaqësuar, por kur vjen puna për lidërsipin primar, pozicionin kyç pra për të marrë ato vendimet kryesore situata vjen dhe bëhet më e vështirë. Dhe këtu ka një diferencë të madhe pastaj që unë pavarësisht se kam qenë dhe vazhdoj të mbështes sistemin e kuotave nga ana tjetër nuk është zgjidhja më e mirë për të sjellë në politikë gra që kanë dëshirë të zhvillojnë një karrierë politike. Sepse vetë fakti që zgjidhen kryesisht nga kryetarët e partive sic kanë treguar dhe rastet e fundit, duan dhe gra që i binden tërësisht dhe të ndjekin modelin mashkullor besoj që nuk i bën mirë sepse rritet numri i përfaqësimit të grave në politikë por

nuk kemi ngulur këmbë dhe nuk kemi ngritur modelin femëror të lidërshiptit në politikë gjë që për mua sot është një minus i madh në politikën shqiptare por dhe në shoqërinë shqiptare.”- shprehet Znj. Majlinda Bregu, politikane, deputete dhe Ministre e Integritimit European ne kabinetin e z. Sali Berisha (Bregu, 2017).

Sistemet e kuotave zgjedhore në thelbin e tyre janë masa të përkohshme. Edhe pse në legjislacionin kombëtar nuk parashikohet një kohë e përcaktuar gjatë së cilës duhet të zbatohen këto kuota, ato duhet të konsiderohen si masa të përkohshme derisa të eliminohen barrierat që i pengojnë gratë të marrin pjesë në vendimmarrje. Një gjë e tillë shprehet qartë edhe në rekomandimet që Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave i ka bërë shtetit shqiptar.

Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri”, paraqet si një nga kërkesat kryesore të parimit të barazisë gjinore, përfaqësimin e barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe në institucionet e tjera publike të vendit. Ky përfaqësim duhet të shtrihet jo vetëm në përbërjen e anëtarëve ose punonjësve të këtyre organeve, por edhe në organet drejtuese të tyre. Si kriter për këtë, ligji vendos një kuotë përfaqësimi në masën mbi 30 për qind për secilën gjini. Gjithashtu, ai vendos disa garanci për të siguruar këtë përfaqësim të barabartë. Psh. detyrimin që të gjitha institucionet të respektojnë procedura e kritere të njëjta për secilën gjini gjatë konkurrimit ose emërimit të punonjësve. Gjithashtu, ligji ka përcaktuar edhe kuotën gjinore për kandidimin në organet e zgjedhura qendrore e vendore, duke kërkuar një përfshirje prej mbi 30 për qind të secilës gjini në listat e kandidatëve për organet vendore dhe jo më pak se 30 për qind për listat e kandidatëve për deputetë. Për zbatimin e kuotës gjinore në zgjedhje një rol mjaft të rëndësishëm paraqet **Kodi Zgjedhor**, i cili parashikon rregulla për përmbushjen e saj, si në

organet e zgjedhura, qendrore (Kuvendi), ashtu dhe në organet e zgjedhura vendore (këshillat e njësive të qeverisjes vendore).

Edhe me vendosjen e këtyre kuotave për herë të parë në ndryshimet e Kodit Zgjedhor të 2008, partitë politike arritën ta shmangin këtë detyrim ligjor. Pasi pavarësisht kërkesës së Kodit Zgjedhor për një kuotë 30 për qind për gratë në listat e kandidatëve, partitë politike i vendosën gratë në fund të listave duke bërë që shanset e tyre për zgjedhje të ishin minimale. Në zgjedhjet e vitit 2013 disa parti politike i shmangën hapur kuotat gjinore, të cilat tashmë ishin të imponuara nga ligji, duke marrë dënimin përkatës nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rezultati për legjislaturën 2009-2013 ishte 16 për qind e grave deputete ndërsa legjislatura 2013-2017 me ndryshimet e ndodhura (dorëheqja e një pjesë të madhe të kabinetit qeveritar nga posti i deputetit) solli një rritje të numrit të përfaqësimit të grave në 21%. Dhe zgjedhjet e fundit vendore të vitit 2015 ndikuan pozitivisht në pjesëmarrjen e grave në politikë, bazuar në aplikimin e kuotave gjinore sipas Kodit Zgjedhor për kandidatët për këshillat bashkiakë. Madje për këto zgjedhje mund të themi se fituese janë femrat, ato rezultuan më të forta ndaj rivalëve meshkuj, duke thyer kështu epërsinë mashkullore të zgjedhjeve tipike shqiptare. Nga 15 gra gjithsej që garuan për mandatin e kryebashkiakes, 9 prej tyre janë shpallur fituese, dhe kjo është një risi.

2.1.2 A janë kuotat një ide e mirë?

Koncepti i kuotave lidhet drejtpërdrejt me diskutimin se pse përfaqësimi i grave është i rëndësishëm. Studiueset Dahlerup dhe Phillips japin tre argumente thelbësore si dhe një të katërt motivues lidhur me domosdoshmërinë e balancës gjinore në vendimmarrje, për të cilën mekanizmi i kuotës është i domosdoshëm (Dahlerup, 1978: 139-172; Phillips, 1995).

Sipas tyre:

- a.** gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë dhe kanë të drejtë të kenë gjysmën e vendeve të përfaqësimit në vendimmarrje (argumenti i drejtësisë);
- b.** gratë kanë interesa dhe përvoja të ndryshme (të ndërtuara ndryshe biologjikisht apo shoqërisht), dhe duhet të jenë të përfaqësuara në mënyrë të barabartë, për të prezantuar dhe mbrojtur ato, (argumenti i përvojës);
- c.** gratë dhe burrat kanë pjesërisht konflikt interesi, kështu burrat nuk mund të përfaqësojnë gratë (argumenti grup interesi).
- d.** Një argument i katërt merret me rëndësinë e grave politikane, si role modele që mund të hapin rrugën për gratë e tjera.

Në kuptimin e barazisë, njerëzit, janë edhe politikisht të barabartë. Ndaj nisur nga ky kuptim, në këtë kontekst edhe gratë e kanë të drejtën e tyre që të jenë pjesë e barabartë e vendimmarrjes politike dhe ekzekutive etj.

Mona Lena Krook pohon se miratimi i ligjeve të kuotës gjinore shpesh zbulon natyrën e rrënjësor thellë të diskriminimit gjinor në proceset ekzistuese të rekrutimit të kandidatit. (Politics & Gender 2006) Mendoj se ligji i kuotave gjinore është një ide e mirë ose jo pjesërisht në varësi nga çfarë ndikimi presim ne që ai të ketë. Nëse duam të rritet numri i grave të zgjedhura në detyrë, atëherë ligji i kuotave gjinore është një ide e mirë. Pasi është vërtetuar se nëse një ligj i tillë është miratuar në kushte të drejta ai mund të gjenerojë rritje të shpejtë dhe të rëndësishme në zgjedhjen e kandidateve gra. Por nëse duam që të demokratizojmë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve sa më shumë të jetë e mundur, duke e bërë atë më transparent, atëherë mendoj se ligji i kuotave nuk është një ide e mirë.

Efekti që ai ka në sistemin politik dhe në atë zgjedhor akoma nuk është kuptuar mirë.

Ndërsa Ligji “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” bënte thirrje për pjesëmarrjen e grave në politikë për të arritur nivelin 30%, Kodi Elektoral nuk vuri në vend mekanizmat që do t’a garantonin atë. Kodi elektoral i dha partive politike hapësirë për të vendosur nëse do të përfshiheshin emrat e grave si një nga tre emrat në krye të listës, apo nëse thjesht gratë do të përfshiheshin si 30 për qind të listës së përgjithshme të kandidatëve. Në fakt, duke mos specifikuar nëse partitë mund të plotësonin kuotat gjinore duke renditur një grua në një nga tre emrat e parë dhe / ose si 30 për qind të listës, u krijuan kushtet për mospërbushje të objektivit të përgjithshëm në arritjen e 30 për qind të kuotës. *Kodi Elektoral* është ligj organik dhe, si i tillë, prevalon mbi Ligjin “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”. Kemi një dështim gradual të përpjekjeve për të ndryshuar kulturën mashkullore të politikës.

Rast i zgjedhjeve parlamentare të 28 qershorit 2009 tregoi se zbatimi në praktikë i ligjit “Për barazi gjinore në shoqëri” dhe konkretisht i kuotës gjinore është i vështirë, kërkon vullnet politik edhe angazhim të të gjitha forcave politike. Përmes zbatimit të pjesshëm të kuotave gjinore u arrit që të rritet numri i grave në parlament nga 10 gra në legjislaturën e kaluar, në 23 në zgjedhjet e 28 qershorit 2009, duke e rritur përqindjen e tyre nga 7 për qind në 16%.

Gjithashtu ideologjia e partisë luan një rol të rëndësishëm në perspektivat e grave për t’u emëruar dhe për t’u zgjedhur. Situata e përfaqësimit të grave në zgjedhjet lokale ishte e turpshme, vetëm 16 ishin gra nga 872 kandidatë lokalë dhe nga këto vetëm 6 kandidate fituan garën elektorale. Po ashtu sipas raportit çështjet e barazisë gjinore nuk janë trajtuar në fushatë dhe në programet elektorale që paraqisnin partitë politike. Në media politikanet

gra zunë vetëm 4,4 për qind të kohës televizive të kushtuar fushatës elektorale. (Zhupa, 2011)

Të gjitha këto tregojnë që jemi larg arritjes së një përfaqësimi dinjitoz të grave në politikë. Vendosja e kuotave në ligj mesa duket ka qenë fiktive, thjesht për sy e faqe dhe asnjëra nga palët nuk e ka në mentalitetin e saj politik zbatimin e një norme të tillë. Pra, duket qartë se një shifër në letër nuk ndryshon asgjë në realitetin tonë të përditshëm.

Në mungesë të një debati të gjerë rreth kuotave, edhe dy vjet pas miratimit të ligjit në fjalë nuk ka ndonjë konsensus publik apo politik mbi çfarë duhet pritur prej grave që bëhen deputete sajë këtij akti favorizues. Ca hedhin idenë se gratë do ta “zbusin” e do ta pastrojnë politikën e egër e të korrumpuar shqiptare, ca të tjerë thonë se gratë thjesht do feminizojnë korrupsionin. Ndërkohë ka pyetje kyç që ende mbeten pa përgjigje. Cili është objektivi i këtyre kuotave, apo thjesht prania e një sasive grash në parlament? A munden gratë e zgjedhura sajë këtij ligji të sjellin ndonjë ndryshim në ambientin e në kulturën politike shqiptare, apo do të përfundojnë duke u bërë si gjithë politikanët e tjerë e duke brendësuar vlerat ekzistente të politikës? (Zaimi, 2010)

2.1.3 Pse janë të rëndësishme kuotat?

Në fillimet e viteve '90 koncepti i kuotimit gjinor ishte akoma i paqartë për shumë vende të rajonit përfshirë këtu edhe Shqipërinë. Është dashur kohë, madje kalimi nëpërmjet eksperiencave të hidhura, përpara se të kuptohej se ekziston një ndryshim rrënjësor midis kuotës për barazinë gjinore dhe kuotës së aplikuar në rrethanat e një demokracie parlamentare. (Rrjeti i Grave “Barazi në Vendimmarrje“, 2010)

Kuotat gjinore janë masa të përkohshme, që ndërmerren për të përmirësuar balancën gjinore në vendimmarrje, në të gjitha fushat edhe në të gjitha nivelet. Konsiderohen të përkohshme, duke synuar që (brenda një periudhë kohe) të eliminohen barrierat me të cilat përballet gjinia më pak e përfaqësuar (në këtë rast gratë), si edhe të arrihet angazhimi i tyre real në vendimmarrje. Përmes këtyre masave të përkohshme synohet si korrigjimi i pabarazive gjinore ekzistuese, ashtu dhe minimizimi i qëndrimeve diskriminuese ndaj grave. Karakteristika kryesore e kuotave gjinore ligjore është se ato vendosen me ligj, ndaj dhe quhen shpesh “kuota themelore ose të detyrueshme”, pasi janë të detyrueshme për të gjitha partitë që paraqesin kandidatë në parlament.

Në korrik të vitit 2008 u miratua ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri”, i cili vendosi për herë të parë kuotën gjinore, si një detyrim ligjor për të garantuar pjesëmarrjen mbi 30 për qind të secilës gjini në organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike (Neni 15). *Ky ligj synon të rregullojë çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore.* (Metropol, 2010)

Kuota gjinore, e shprehur në 30%, konsiderohet si masë kritike që siguron dëgjimin dhe marrjen parasysh të mendimit të një grupi me interesa të përbashkëta. Ajo synon realizimin e së drejtës themelore të të dyja gjinive për të zgjedhur edhe për t’u zgjedhur, si edhe krijon mundësinë që edhe gjysma e popullsisë, gjinia më pak e përfaqësuar, të kontribuojë në politikëbërje. Rritja e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në nivel të vendimmarrjes

qendrore dhe lokale thyen stereotipat gjinorë dhe nxit e inkurajon pjesëmarrjen dhe kontributin e grave dhe vajzave në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fushat.

Kuotat e Grave në politikë, edhe pse i shoh si të nevojshme, madje të domosdoshme i shoh si të keqmenaxhuara. Në rast se këto kuota synojnë vërtet të ndihmojnë gratë që të jenë më të përfaqësuara (siç e meritojnë padyshim) në nivelet e larta të politikës, prej nga do të kenë mundësi që të korrigojnë një kulturë të tërë maskiliste që zbret në çdo nivel e në çdo detaj të organizimit shoqëror, atëherë përse nuk ua lënë vetë grave që t'i menaxhojnë këto kuota? (Zaimi, 2009)

Për aq kohë sa partia është e fortë dhe është emri i saj ai i cili fiton pavarësisht emrave në listën e kandidatëve, qofshin burra apo gra, gratë gjithmonë, mund të përfitojnë nga kandidimi nën etiketën e këtyre partive të forta dhe të institucionalizuara. Një parti e tillë ka më shumë mundësi për të marrë shumë vende fituesish dhe në këtë kontekst edhe fituesesh gra. Por statistikat tregojnë se partitë e mëdha pothuajse në të gjitha vendet europiane udhëhiqen kryesisht nga burrat, njëkohësisht mund të themi të njëjtën gjë edhe për rastin e Shqipërisë, ku ne ende nuk kemi një parti të udhëhequr nga një femër apo më saktë një femër në krye të një partie.

2.2 Barazia gjinore

Çështja e barazisë gjinore është çështje që prek të gjitha gratë si gjini, pavarësisht nga përkatësia e tyre politike apo nga përkatësi të tjera. Sfidat e shoqërisë moderne është e hapur, ajo ka të bëjë me ndërtimin e saj në përmasat e një shoqërie të drejtë, të barabartë nga pikëpamja gjinore. Sfidat gjithashtu ka të bëjë me luftën që shoqëria shqiptare duhet të bëjë me veten e saj, së pari duke ndryshuar atë mentalitet të fuqishëm maskilist, i cili është

një dukuri jo vetëm me rrënjë të forta. Barazia gjinore është një e drejtë themelore qytetare, një vlerë e përbashkët e vendeve të Bashkimit Europian, e për këtë arsye një kusht i domosdoshëm për integrim dhe realizim të objektivave për punësimin dhe kohezionin social të MSA, të cilën Shqipëria ka nënshkruar në qershor të vitit 2006. (MPCSSHB, 2008: 3)

Gruaja shqiptare në luftën për barazi gjinore, ka përballë një traditë shekullore të kultivuar, në të cilën roli i saj ka qenë shumë i reduktuar. Shoqëria shqiptare është e ndërgjegjshme dhe e pranon se ky problem është në disfavor social të gruas. Natyrisht është i njohur fakti që e kaluara historike dhe politike e shoqërisë tonë, ka qenë e tillë që në shekuj gruan e ka parë si qenie jo të denjë për ambientet publike të jetës shoqërore dhe të politikës, por të “denjë” vetëm për ambientin e shtëpisë. Politika dhe jeta sociale sipas mentalitetit, ka qenë e huaj për gruan.


2.3 Gruaja në vendimmarrje

Nga gjithë këto vite që gratë janë të angazhuara në politikë, secila është munduar fort të lerë gjurmë dhe të krijojë një model të saj in ose të ketë një profil të saj in.


Mbi bazën e këtij mentaliteti të vjetër, i cili megjithë ndryshimet për mirë që kanë ndodhur kohët e fundit, është ende sundues, vazhdojnë të jenë të ulët treguesit e pjesëmarrjes së gruas në politikë dhe vendimmarrje. Ndikim jo të ulët, në këtë nivel pjesëmarrje të gruas në politikë, natyrisht që ka dhe lufta politike në Shqipëri në këto vitet e fundit, e cila ka qenë dhe vazhdon të shfaqet si një luftë e ashpër burrash, në të cilën ka pak hapësirë që të jetë pjesëmarrëse gruaja, e cila nga natyra është më e brishtë në krahasim me qëndrimin “luftarak” të burrave. Vetë mënyra si zhvillohet dhe realizohet politika në shoqërinë tonë,

mungesa e cilësive qytetëruese të saj, vrazhdësia, brutaliteti, sharjet, ofendimet, bëhen pengesë serioze, për ta konsideruar politikën dhe vendimmarrjen si një “ambient” të përshtatshëm, edhe për gratë. Mungesa e kohës, ngarkesa e tepërt në familje dhe mungesa e ndarjes së barabartë të detyrave dhe përgjegjësive brenda familjes, e kanë bërë gjithashtu të kufizuar mundësinë dhe pjesëmarrjen e barabartë të gruas në politikë dhe në jetën shoqërore. Produkt i këtij realiteti është gjithashtu fakti që tek gratë kjo situatë krijon një ndjenjë mosbesimi tek energjitë e veta, për të qenë të denja dhe të barabarta me meshkujt edhe në sfera të tilla të konsideruara “monopol” i tyre siç është politika dhe vendimmarrja. Pra nëse do të duhet të rendisim apo përmendim të shfaqura grafikisht faktorët kryesorë që ndikojnë në këtë pabarazi: në pjesëmarrjen e ulët të gruas në vendimmarrje, gjendet si më poshtë: (MPCSDHB & DPSHB, 2005: 18)

Grafiku nr.1:



Grafiku nr.2:



Në perceptimin e rrugëve të mundshme të rritjes së pjesëmarrjes së gruas në politikë dhe vendimmarrje ka dallime për rëndësinë e shkaqeve dhe përcaktimit të prioritetit të rrugëve të mundshme të realizimit të tyre. Ndërsa gratë vendosin si rrugë të parë për të ndikuar në barazinë gjinore hartimin dhe zbatimin e programeve qeveritare për mbështetjen e gruas, meshkujt janë të mendimit se prioritarë në këtë aspekt, është rritja e pjesëmarrjes së grave në forumet drejtuese të partive politike, futja e politikave të kuotimit dhe përmirësimi i Kodit Zgjedhor. Shoqëria shqiptare tashmë mendon se vendosja e disa “kuotave detyruese”, zbatimi i të cilave është kusht “*sine qua non*”, për të ndryshuar situatën e përfaqësimit më të merituar të gruas në organet e larta të politikës, ka ndikim më të drejtpërdrejtë në përmirësimin e angazhimit të grave në politikë, madje edhe më shumë se forca ndikuese e trajnimeve teorike apo faktorëve të tjerë kryesorë ndikues

2.4 A e garanton realizimin e qëllimit, kuota gjinore në legjislacionin shqiptar?

“Gratë shqiptare, të angazhuara në lëvizjen e gruas për pjesëmarrje në politikë, gratë e politikës, po edhe burra që mbështesnin këtë kauzë luftuan në disa fronte: media, ndërgjegjësim të shoqërisë dhe vetë grave për rolin e tyre në politikë, dhe, si përfundim, në vitin 2008 u aprovua në parlament ligji për Barazinë Gjinore, që është shumë kompleks, por që përmban dhe detyrimin ligjor që në listat e partive të përfshihen 30 për qind gra dhe vajza” (Çuli, 2017). Padyshim, që ky 30 për qind nuk pasqyrohet në rezultatin konkret, sepse partitë politike i vendosin gratë në pjesën e dytë të listës. Përpyekja e tanishme po bëhet – sipas modeleve perëndimore – që në çdo tre emra, të jenë të dy gjinitë. Nuk përjashtoj rastet e mbështetjes apo jo mbështetjes se grave për njëra tjetrën në politikë por duket që ky është faktor dominant, përsa kohë në parlament por dhe në organet e tjera vendimmarrëse kryesisht janë gra të cilat kanë lobuar dhe kanë përgatitur iniciativa ligjore dhe nuk kanë ardhur si propozime nga burrat.

“Por ajo që i pengon apo që unë e shoh akoma të vështirë për gratë sot është fakti që politika funksionin gati me radhë, dhe për të kaluar nga njëri rresht tek tjetri, për t’iu afruar qendrës dhe majës për këto gra behet gjithnjë e më e vështirë. Duke filluar nga stereotipi që shoqëria shqiptare mban por jo vetëm shoqëria shqiptare, i cili ndërtohet menjëherë për gratë duke i konsideruar që shkojnë pas burrave në politikë. Për të kaluar më pas tek mënyra se si janë zhvilluar partitë politike në Shqipëri dhe mënyrës se sa mungesë të madhe të demokracisë ka brenda tyre. Dhe për të mbërritur aty në nivele më të larta kërkohet sigurisht përpjekje dhe një network më i madh, gratë e kanë më të vështirë për të ndërtuar network-un në një ambient ku janë më të pakta në numër dhe shtoj pastaj

dhe faktin tjetër që janë më larg tryezave të network-ut që ndërtojnë burrat zakonisht. E treta pastaj sepse media është një faktor që në vend që ta ndihmojë dhe t'i japë peshën reale grave, të përpjekjeve të tyre për t'u bërë pjesë të shoqërisë, përpjekjen e tyre për ta bërë shoqërinë më të mirë dhe më të barabartë, ka dëmtuar më së shumti gratë në bazë të stereotipeve sidomos në këto vitet e fundit me mediat online. Dhe rastet e kritereve të vlerësimit bëhen të ndryshme, ndryshe për një burrë dhe ndryshe për një grua. Dhe të gjitha këto së bashku e largojnë nga ajo qendra apo maja siç thashë për të qenë gruaja në qendër të rrethit dhe në majë të vendimmarrjes. Dhe pastaj duke llogaritur një pushtet patriarkal, dhe një karrierë mashkullore gratë pengesën kryesore kanë atë që cilit model duhet t'i referohen, sepse në rastin që ne kemi 1,2 apo 3 modele lidërsipi, nuk zgjatin në kohe sa zgjat një model burri në pushtet apo në lidërsip i cili mund të ketë një mijë minuse nëse nuk ka një grua, por se arrin ta mbaje pushtetin më mirë. Të gjitha këto unë i shoh si elementët që vështirësojnë pjesëmarrjen e grave në politikë” (Bregu, 2017).

Pra ashtu sikurse dhe më lart Znj. Bregu tregon disa nga vështirësitë me të cilat duhet të përballet një femër sot e cila është pjesë e politikës apo pretendon të bëhet pjesë e saj, krahas tyre mund të them se janë dhe disa pengesa të cilat gratë duhet që të kalojnë për të qenë të zgjedhura në parlament:

- duhet të kenë të drejtën për t'u zgjedhur;
- duhet të jenë të gatshme për të kandiduar në zgjedhje;
- duhet të zgjidhen si kandidate nga partitë;

- duhet të zgjidhen nga votuesit, përballë një shoqërie ku mbizotërues akoma është mentaliteti dhe ambienti përjashtues për gratë, situatë e cila përforcohet edhe nga shumë faktorë të tjerë të tillë si: politikë, socialë, ekonomikë, kulturorë etj.

Në pikën 5 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, theksohet se: “...për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumemërore dhe/ose një në tre emrat e parë të listës shumemërore duhet t’i përkasë secilës gjini”. Kjo nënkupton se lista nuk duhet të ketë më pak se kuota 30 për qind kandidatë për secilën gjini, dhe një kandidat për gjini duhet të jetë i përfshirë në 3 emrat e parë të listës për secilën zonë zgjedhore.

Sanksioni. Sipas Kodit Zgjedhor, mospërbushja e njërit prej kushteve të parashikuara në lidhje me përbërjen e listës shumemërore për këto zgjedhje, sjell si rrjedhojë refuzimin e listës nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. (Anastasi, 2010)

Kuota Vendore. Detyrimi për të arritur një përfaqësim të çdonjërës prej gjinive me jo më pak se 30 për qind parashikohet edhe në nivelin vendor. Kjo realizohet përmes përfshirjes në listën e kandidatëve të mbi 30 për qind nga secila gjini. Gjithashtu, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, një në çdo tre emra në listë duhet t’i përkasë secilës gjini. Ky rregull duket më i qartë dhe më i sigurt për arritjen e balancës gjinore në rezultatet zgjedhore. Në rast se partitë politike nuk e përmbushin rregullin e mësipërm, atëherë Kodi Zgjedhor ka parashikuar një gjobë me një shumë prej 30 000 lekë për çdo zonë zgjedhore, si për partitë e mëdha edhe ato të vogla. (Anastasi, po aty)

Pra politika mund të jetë sakrificë për çdo burrë, por për gratë është sakrificë e trefishtë, sepse do duhet të marrin “OK” e rrethit familjar, duhet të kenë dikë që ta mbështesi për

fëmijët, për kohët e gjata jashtë shtëpisë, etj. me radhë, plus pastaj edhe modeli në karriere i cili është një model tërësisht mashkullor.

Përmbledhje kapitulli

Kapitulli i dytë është teorik dhe i fokusuar tek kuota 30 për qind e përfaqësimit të gruas në politikë dhe vendimmarrje. Duke qenë se aplikimi i kësaj mase dhe bërja ligjore respektimi i saj nga ana e partive politike, solli në shoqërinë shqiptare një përmirësim të dukshëm të situatës së gruas përse i përket përfaqësimit të saj në politikë dhe në institucionet vendimmarrëse në vend, mendova ti kushtoja një rëndësi të dukshme duke e trajtuar në një kapitull të gjithë për të parë vështirësitë në të cilat ndeshi vendosja e kësaj mase kritike, cilat ishin të mirat që solli, a e përmirësoi ajo për qind e grave në politikë, a ishte e rëndësishme dhe një ide e mirë aplikimi i saj në shoqërinë tonë, sa ndikoi kuota në arritjen e barazisë gjinore dhe në pozitën e gruas në vendimmarrje e të tjera çështje që patën ndikim nga vendosja e kësaj kuote me miratimin në 2008 të ligjit “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”.

Përfaqësimi i femrës në çdo instancë në institucionet në vend apo në politikë është tejet i rëndësishëm. Ishte miratimi i ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”, në korrik të 2008 ai i cili vendosi kuotën gjinore, si detyrim ligjor për garantimin e pjesëmarrjes mbi 30 për qind të secilës gjini në organet e tre pushteteve kryesore në vend, atij legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor si edhe në institucionet e tjera publike (*Neni 15*). Pra plotësimi i nivelit të këtyre kuotave në masën 30 për qind të grave në partitë politike konsiderohet një hap drejt avancimit të përfaqësimit të gruas. Synimi i këtij ligji ishte rregullimi i barazisë gjinore dhe trajtimi i barabartë në mundësi dhe shanse për burrat dhe gratë në ushtrimin e të drejtave të tyre.

Pra kuotat legislative gjinore shërbejnë si metodë për të rritur balancën gjinore në institucionet politike. Si pasojë e përpjekjeve shumë të mëdha mbi 20 vjeçare të lëvizjes së gruas shqiptare, e cila bashkëpunoi edhe me faktorë ndërkombëtare, sot prania gruas në politikë është mbi 17%, në krahasim me 5 apo 10 për qind që ishte rreth 18 vjet, pas ndryshimeve social politike në vend. Kuotat janë masa që duhen marrë për të bërë të mundur që femrat të kenë një përqindje ose numër të caktuar përfaqësimi në çdo institucion, qoftë qeveri, asamble parlamentare, komision apo edhe listë kandidatësh. Shumë vende këto kuota i aplikojnë për një periudhë të caktuar kohore, sa janë të nevojshme për të kapërcyer barrierat e futjes së femrave në politikë. Dhe këto rregullime bëhen me synim shtimin e tyre (femrave) në numër pasi përgjithësisht mendohet se janë të nënpërfaqësuar. Asnjë nga gjinitë nuk duhet të ketë më shumë se 60 për qind dhe as më pak se 40 për qind të vendeve në institucione të ndryshme. Këto kuota janë konsideruar si masa të përkohshme të cilat shërbejnë për të rregulluar barazinë gjinore jo vetëm në vendimmarrje por në të gjitha fushat. Këto kuota vendosen me ligj ndaj dhe konsiderohen të detyrueshme për të gjitha partitë të cilat paraqesin kandidatë në parlament. Sot, në Shqipëri, krahasuar me kohë më parë gratë janë të përfaqësuar shumë më mirë, janë të përfaqësuar në parlament mbi 20 për qind të këtij përfaqësimi. Dhe Kuvendi ka një rritje të numrit të grave parlamentare aq sa aktualisht ka mbi tridhjetë e ca parlamentare nga 9 që ishin në legjislaturën e parë (1991-1992).

Pikërisht për këtë mund të themi se aplikimi i kuotës gjinore ka hedhur hapa pozitivë, pasi sot kemi nivelin më të lartë të përfaqësimit të grave në parlament, numrin më të lartë të grave ministre, gratë gjithashtu janë drejtuese nivelesh shumë të larta në: drejtori, institucione shtetërore; është në nivele më të larta dhe kjo mund të shihet lehtësisht në

kabinetin qeveritar ku nga 19 ministra 10 prej tyre janë gra, ka një numër të madh zv. ministresh dhe drejtuese të tjera të rëndësishme në strukturën e administratës qendrore.

Gratë po ashtu sot janë të përfaqësuara më mirë edhe në pushtetin vendor ku ne tani kemi disa kryetare bashkie, n/kryetare, shumë anëtare të këshillave bashkiake, si dhe në pozicione të tjera të rëndësishme të administratës vendore. Në zgjedhjet e fundit lokale konkurruan 16 gra për kryetare bashkie në gjithsej 61 bashki që ka vendi. Nëntë prej tyre arritën të fitojnë dhe janë sot kryetare bashkie. Por përpos gjithë sa nënkuptojnë dhe aplikohen këto masa, treguesit e pjesëmarrjes së gruas në politikë dhe vendimmarrje vazhdojnë të jenë të ulët, sepse produkt i këtij realiteti është fakti që tek gratë kjo situatë krijon një ndjenjë mosbesimi tek energjitë e veta, për të qenë të denja dhe të barabarta me meshkujt edhe në sfera të tilla të konsideruara “monopol” i tyre siç është politika dhe vendimmarrja. Dhe sado mundohen të arrijnë pozita drejtuese, “lufta” kundër mentalitetit të shoqërisë sërish vazhdon të jetë e vështirë edhe pse ashpërsia e kësaj lufte ka ardhur duke u zbutur.

KAPITULLI III: ROLI I GRUAS SHQIPTARE NË POLITIKË GJATË PERIUDHËS SË TRANZICIONIT

3.1. Transformimi demokratik dhe tranzicioni i shoqërisë

“Iu thuhet femrave si kompliment: “Ti je e zgjuar si një burrë” Mendoj se është një gabim i madh ndaj kreativitetit të femrave të mendosh se je e suksesshme nëse mendoni si një burrë. Ne jemi duke rizbuluar se si është të mendosh si një grua. Gerda Lerner

Nëse gratë në politikë gjenden përballë dilemës “Të ndjesh si femër apo të mendosh si burrë”, për meshkujt është më e thjeshtë të kapërcejnë herë pas here ylberin. (Buzi, 2009)

Transformimi demokratik shqiptar, ose siç ka hyrë në terminologjinë lokale, “proceset demokratike” ndodhën brenda një kohë të shkurtër, kryesisht gjatë vitit 1990, si pasojë e degradimit total të situatës ekonomike dhe nën ndikimin e fortë të ndryshimeve në Europën Lindore. Shqipëria që vendi i fundit në Evropën Lindore, i cili në dhjetor të viti 1990, lejoi pluralizmin politik, pra krijimin e partive të tjera politike dhe braktisi rrugën socialiste të ndërtimit të rendit shoqëror dhe ekonomik. Pra si në shumë vende të Europës Lindore edhe në Shqipëri, pas viteve ‘90 u shemb diktatura komuniste dhe u vendos sistemi liberal (ose demokracia, e njohur ndryshe). Ky sistem i vendosur në fillim të viteve ’90 në Shqipëri është njohur dhe propaganduar kryesisht si një demokraci liberale, e cili vazhdon të cilësohet e tillë edhe sot. Është e vërtetë se institucionet e reja të formës demokratike që u vendosën në fillim të viteve ’90 ishin jo të përsosura, por, gjithashtu, është po e vërtetë se ato nuk u përmirësuan në masa të mëdha në kohë. (Daci, 2011) Ngjarjet e viteve të fundit na dëshmojnë se nuk kemi pasur dhe nuk kemi një doktrinë liberale të zbatuar në vend.

Këtë e vërteton fakti, se klasa politike në vend nuk është as përshtatur, modifikuar dhe nuk karakterizohet aspak me karakterin e marrëdhënieve dialoguese. Kjo bazuar në të dhënat se që nga fillimi '90 deri në ditët e sotme, kemi të njëjtët personazhë politikë, si në krahun e majtë, ashtu edhe në atë të djathtë. Shoqëria njerëzore që nga krijimi i saj, ka kaluar shumë stadi zhvillimi, të cilat kanë qenë në përputhje dhe vartësi të ndërsjellta me zhvillimet historike, politike, apo dhe ato ekonomike. Raportet e marrëdhënieve që ekzistojnë mes saj (shoqërisë) dhe këtyre fenomeneve, lidhjet reciproke të njerëzimit me ndryshimet historike që sjellin luftërat apo revolucionet, kanë sjellë evolucion shoqëror. Çdo kohë kërkon njerëzit e vet, njerëz të rinj, që t'u përgjigjen ritmeve të saj. Ndryshimet sasiore dhe cilësore gjatë revolucioneve historike edhe evolucionet social- kulturore, i bënë gjithë shoqëria dhe jo vetëm burrat. Natyrisht, jetës publike në vendin tonë nuk i kanë munguar gratë, të cilat nëse i kthehemi historisë, në revolucionin e famshëm komunist të viteve '70 u quajtën forcë e madhe e jetës sociale. Raporti numerik nga viti në vit nuk ka ndryshuar shumë, por sidoqoftë prezenca e tyre ka qenë ekzistente dhe e dobishme. Për t'u vënë në pikëpyetje ka qenë zëri i tyre, postet që kanë mbajtur si dhe prania në jetën publike dhe media.

Politika shqiptare ende nuk e ka kuptuar konceptin e të drejtave të njeriut. Në përgjithësi politika, ky mekanizëm pragmatist dhe cinik, nuk ka qenë ndonjëherë në mënyrë të shpejtë pranë konceptit të të drejtave të njeriut. Duke qenë se problemet me të drejtat e njeriut prodhohen si rezultat i gabimeve të politikës, kjo e fundit kërkon të mbrohet duke përjashtuar, nënvlerësuar, apo luftuar ato aksione që i kundërvihen, dhe të drejtat e njeriut janë të lidhura drejtpërdrejt me këto aksione. (Zholi, 2008)

Tradicionalisht gratë kanë qenë kategoria shoqërore më e shtypur. Sipas Carol Ramazanoglu “faktorët që femrën e bëjnë të shtypur janë strukturimi shoqëror i seksualitetit, dhuna e ushtruar prej mashkullit dhe përkujdesja për fëmijët”. (Zekije, 2006) Gruaja duhet të ushtrojë “funksionet” e veta brenda mureve të shtëpisë, kështu mendohej dhe mendohet ende. Qëllimi i saj është rritja e fëmijëve dhe mbarëvajtja e vendit ku jeton. Ndërsa gjinia tjetër e ka mjaft të qartë se çfarë dëshirojnë dhe i atribuon vetes lejen që të vendosë edhe për pjesën tjetër të popullsisë. Të gjitha këto që përmendëm më lart kanë krijuar krizën e përfaqësimit të grave.

Këto janë disa nga arsyet që bëjnë që gratë në përgjithësi por sidomos ato shqiptare t’i qëndrojnë larg politikës edhe pse nuk i mungon përgatitja, aftësia apo meritat. Akoma nuk po perceptohet ashtu siç duhet vendi i gruas në karrierën politike.

Në realitetin shqiptar për shkak të mungesës së traditës pjesëmarrëse të gruas në politikë, trashëgimisë komuniste, zhgënjimet me të gjitha politikat, mungesës së hapësirës për shoqërizim që ofron punësimi me pagesë jashtë shtëpisë dhe jeta e aktivitetit personal shoqëror, për shkak të varfërisë, strukturës tradicionale të familjes shqiptare që e sheh gruan si të përrulur ndaj vullnetit të burrit të shtëpisë, gratë janë të padukshme dhe të papërfaqësuara.” (Danaj, 2008; 28)

Të gjithë këta faktorë apo shkaqe kanë bërë të mundur krijimin e kulturës së sotme politike. Një kulturë që nuk është aspak në favor të tyre. Kanë krijuar një disbalancë midis dy gjinive: mashkullit e femrës për të patur mundësi dhe shanse të barabarta në vendimmarrje si dhe në dëgjimin e zërit të tyre nga të gjithë.

Edhe pse gratë sot gëzojnë të drejtën e votës, shkollimit, punësimit dhe shumë të tjera, gruaja edhe sot vazhdon të jetë e papërfaqësuar në proçeset politike. Përfaqësimi jo i barabartë i grave në proçeset e zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe politikë ka qenë dhe vazhdon të jetë temë kryesore e kritikëve feministë dhe deri tani qindra lëvizje janë organizuar në mbarë botën në mënyrë që t'a ndryshojnë pozitën e gruas në politikë. Edhe në Shqipërinë e kësaj kohe zë fill lëvizja e parë e femrës shqiptare sidomos pas hapjes së shkollës së parë shqipe për vajza në Korçë më 1891 nga Sevasti Qiriazi. Ndërsa periudha e dytë e lëvizjes feministe u angazhua për mbrojtjen sociale të femrës (këtu hyn edhe kujdesi shëndetësor) dhe vazhdon nga 1918 deri më 1968. Regjimi komunist në këtë kohë si kudo, edhe në Shqipëri, nëpërmjet zhdukjes së klasave predikonte edhe zhdukjen e pabarazisë gjinore.

Ndërtimi i një rendi demokratik pas 1990 i vuri qytetarët përballë ndërtimit të një demokracie liberale me institucione funksionale, ku qytetarët duhet të jenë pjesëmarrës aktivë në proçes. (Danaj, 2008: 28) Logjikisht duhet të mendojmë se teoria e cila do të gjente zbatim në këtë rend do të ishte feminizmi liberal, sipas së cilës të gjithë njerëzit janë njëllor dhe askujt nuk i duhet mohuar barazia bazuar në gjininë. Ndërkohë që në botë lëvizjet feministe kanë nisur shumë herët, në Shqipëri akoma sot nuk ka pasur asnjë lëvizje të mirëfilltë feministe. Të gjitha reformat që janë marrë në lidhje me statusin dhe gjendjen e gruas në shoqërinë shqiptare janë ndërmarrë në nivelin makro dhe elitar. Por realiteti ndryshon, pengesa për këtë barazi vazhdon të mbetet akoma seksizmi. Nuk është normale për shoqërinë shqiptare të udhëhiqet nga një paragjykim i vjetër antifeminist, që vjen që nga "koha e Frojdit", sipas së cilës "anatomia është fati i femrës" (Tushi, 2008).

Edhe pas dy dekadave të postdiktaturës, gruaja shqiptare është prezente në Shqipëri vetëm në shifra. 51 për qind e popullsisë shqiptare janë gra. Por kjo shifër nuk reflektohet në asnjë pore të jetës. Kuadri ligjor në lidhje me të drejtat politike dhe ato të vendimmarrjes është shumë i qartë. Sa i përket të drejtave civile, si burrat ashtu edhe gratë gëzojnë *de juro* të drejta të barabarta civile e politike. Edhe përsa i përket të drejtave politike është e njëjta situatë. Legjislacioni shqiptar iu njeh të drejta të barabarta si burrave ashtu edhe grave, që me mbushjen e moshës madhore 18 vjeç, të zgjedhin dhe të zgjidhen bazuar në Nenin 45 të Kushtetutës. E drejta e votës është e garantuar. Historikisht gruaja e ka fituar të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur për herë të parë në vitin 1928. Për këtë arsye ato janë aty (Kushtetuta dhe çdo ligj apo konventë), që ëndrra e 51 për qind grave shqiptare të bëhet realitet. Nuk ka dyshim se arritjet e kohëve të fundit në Shqipëri, sikurse vendosja e kuotave gjinore në zgjedhje dhe emërimet në bazë të ligjit “Mbi Barazimin Gjinor në Shoqëri”, i korrikut 2008, si dhe Kodi i ri Zgjedhor (Dhjetor 2008), kanë kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes në politikë të grave në nivel kombëtar. Zgjedhjet parlamentare të vitit 2009 sollën një dyfishim të numrit të grave në kuvend: nga 7 për qind në 2005 në 16.4 për qind në 2009. Por kjo vijon të mbetet shumë poshtë kuotës 30 për qind (ACER dhe ASET, 2010- shih në tabelat dhe grafikët më poshtë)

Në shoqërinë shqiptare, në të gjitha dimensionet e saj ka gra të spikatura e të forta, ka gra që do t'i bënin nder edhe politikës shqiptare. Sot ndoshta gjenden jashtë saj, ashtu siç gjenden edhe shumë burra të mirë. Por në një këndvështrim historik, gratë në këtë vend kanë ditur të ecin në rrugën e emancipimit, kështu që edhe në kohët tona besoj se do të ketë guximtare që do të shkojnë asaj rruge. (Zaimi, 2010)

Figura 2

% e femrave ne parlament ndaj numrit total te deputeteve ne Republikën e Shqipërisë

Viti	1990	1997	2001	2005	2009	2014
Vlera ne %	28.8	12.1	5.2	6.4	16.4	18.6

Burimi: Kombet e Bashkuara (unstat.un.org)

Komentet dhe analiza: ODA

Grafiku nr. 3:





Figura 3:

Kuvendi viti 2005	Gjithsej	Femra		Meshkuj	
		Nr	%	Nr	%
Deputete te zgjedhur	140	9	6.43	131	93.57

Kuvendi viti 2009	Gjithsej	Femra		Meshkuj	
		Nr	%	Nr	%
Deputete te zgjedhur	140	23	16.43	117	83.57

Kuvendi viti 2013	Gjithsej	Femra		Meshkuj	
		Nr	%	Nr	%
Deputete te zgjedhur	140	25	17.86	115	82.14

Grafiku nr. 4:



Për të shpjeguar numrat dhe për qind e tabelës saktësojmë se:

- në zgjedhjet e Kuvendit të vitit 2005 nuk ka detyrim ligjor mbi kuotën gjinore,
- për vitin 2009 Kodi Zgjedhor, në nenin 67 të tij përcaktonte se: "Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumemërore dhe/ose një në tre emrat e parë të listës shumemërore duhet t'i përkasë secilës gjini". Mospërmbushja e kriterit gjinor sillte refuzimin e listës nga KQZ.
- për vitin 2013, neni 67 i Kodit Zgjedhor ndryshoi si vijon: "Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumemërore duhet t'i përkasë secilës gjini". Në rast mospërmbushjeje të kriterit gjinor në përbërjen e listës shumemërore, KQZ-ja zbaton sanksione administrative.

Shkaqet e pabarazisë gjinore gjenden në familje, komunitet, tregun e punës dhe, përgjithësisht, në shoqëri (*Chafetz 1990*). Ndarja e punës sipas gjinisë krijon barra të ndryshme (të matura në kohë dhe energji), shkallë të ndryshme të njohjes (prestigjit), dhe të drejta të ndryshme në vendimmarrje për gratë dhe burrat. Pabarazia gjinore ndikon negativisht mbi ekuilibrin midis mundësive, të kushteve të jetesës dhe të statusit shoqëror të grave dhe burrave. Përveç kësaj, gjinia është gjithmonë e ndërthurur me parimet e tjera shtesore të shoqërisë, prandaj mund të mos ketë të njëjtat pasoja për burrat dhe gratë që jetojnë në një shtresë shoqërore që përcaktohet nga një tipar tjetër.

3.2. Përfaqësimi i pakët i grave

Sistemi socialist në Shqipëri kërkonte që gruaja të ishte amvisë dhe nënë e mirë që të sakrifikoje për familjen e saj. Në këtë mënyrë identiteti i gruas ishte i lidhur më së shumti me rolet e saj gjinore. Por theksojmë gjithashtu se ky sistem dhe pse nuk e ndalonte

feminilitetin nuk i inkurajonte vlerat femërore, por për më tepër theksonte se gruaja duhet të ndiqte modelin mashkullor. Asnjëherë, shteti socialist, nuk i inkurajoi gratë, dhe nuk bëri që të ndërjegjësoheshin për lirinë e tyre të brendshme apo për më tepër të vinin në dyshim apo pikëpyetje pushtetin e burrave në shtëpi. Rënia e sistemit socialist bëri që shoqëria shqiptare të kishte nevojë për të gjetur mënyrën “e duhur” të funksionimit si politikisht ashtu dhe ekonomikisht.

Pas rënies së komunizmit filloi një erë e re e cila kishte emrin e ndërtimit të një shoqërie demokratike në Shqipëri. Si një proces transformimi rezultoi të ishte i vështirë për të gjithë popullsinë dhe u shoqërua me të dhëna që tregonin uljen e nivelit të pjesëmarrjes së gruas në jetën publike dhe politike.

Shkaqet e kësaj uljeje niveli pjesëmarrje dhe më gjerë të pabarazisë gjinore nuk gjenden vetëm tek ndryshimi i regjimit politik por ato gjenden rëndom dhe në familje, komunitet, tregun e punës dhe, përgjithësisht, në shoqëri (Chafetz, 1990). Kjo ndarje pune sipas gjinisë sjell krijimin e barrave të ndryshme, shkallë të ndryshme të njohjes (prestigjit), dhe njëkohësisht të drejta të ndryshme në vendimmarrje për gratë dhe burrat. Ndaj pabarazia gjinore ndikon negativisht në ekuilibrin midis mundësive, kushteve të jetesës dhe statusit shoqëror të të dy gjinive. Përveç kësaj, gjinia gjithmonë është e ndërthurur me parimet e tjera shtresore të shoqërisë, prandaj mund të mos ketë të njëjta pasoja për burrat dhe gratë që jetojnë në një shtresë shoqërore e që përcaktohet nga një tipar tjetër.

Në Shqipërinë e sotme mund të themi se bashkëjetojnë dhe shpesh herë dhe përzihen me njëra-tjetrën qëndrimet e forta patriarkale me qëndrimet moderne. Në më të shumtën e

rasteve është e vështirë të përcaktojmë se cila është logjika kur përpiqemi të kuptojmë arsyet se përse vajzat edhe inkurajohen edhe dekurajohen për një proces të caktuar.

Kur gruaja futet në politikë, gjërat ndryshojnë dhe ndodh që ajo që ne shohim është e kundërta e asaj që është predikuar, e kundërta e asaj që ka nisur të jetë, dhe të jetë thjesht fasadë femërore e pushtetit mashkullor, apo thënë më ndryshe të qenit apo të konsideruarit si një instrument i sundimit autoritar të një burri lider. Pra ndodh që me këtë rrugë-mënyre futje në politikë apo vendimmarrje, gruaja rrezikohet të bëhet pre e të kundërtës së asaj se çfarë emancipimi si proces do të sillte për të.

Dhe ajo thjesht luan rolin e saj të të qenit “manekin”, “lodër”, “instrument”, zëvendësuese e burrave të ikur apo “zëri” i asaj që mendon lideri partiak, lideri sundues.

(Përnaska, 2017)

Kjo ndodh sepse vetë shoqëria e cila është në mentalitet akoma pak patriarkale, mjedisi gjithashtu mashkullor, konkurrenca po ashtu mashkullore, bën të ndjehet e kërkohet nga ato (femrat) një mbrojtje e një natyre ndryshe e mashkullit lider që është mbizotërues në politikë. Kjo sjell më pas një besnikëri paksa të tepruar të femrave ndaj tij, ndaj këtij lideri, pasi të paturit e një mundësie që nuk e kanë femrat e tjera, i bën ato të jenë më të kujdesshme e më të përkushtuara për të qenë në krye të detyrave e të punëve, të cilat “imponohen” nga figura mashkull e liderit. Kjo sjellje e tyre të bën të mendosh se këto femra e konsiderojnë fat këtë mundësi, duke u prirur madje të konsiderojnë si shtëpi të përbashkët dhe partinë, të bëjnë të mendosh se ato janë më të prirura për të “luajtur teatër” në skenën politike duke nënkuptuar njëkohësisht se e kanë lehtësisht të pranuar faktin e të konsideruarit apo të qenit *një fasadë jo vetëm simbolike por dhe paksa “erotike”*.

(Përnaska, po aty)

Ndoshta të gjitha këto mund të jenë imponime të mjedisit mashkullor që sundon Shqipërinë akoma dhe në ditët e sotme.

Numri i pakët e grave në Kuvend i bën ato që të jenë lehtësisht të komandueshme që në zgjedhjen e kandidaturave. Partitë shkelin ligjin zgjedhor, që pa nisur zgjedhjet dhe askush nuk thotë asnjë fjalë. Kuota e grave në asnjë rast në Kuvendin e Shqipërisë nuk është zbatuar. Edhe pse është sanksionuar që të jetë 30 për qind, gratë mbeten në minorancë. Partitë kanë vendosur standarde, të cilët as vetë nuk i zbatojnë.

Gjithashtu dhe fakti se nuk ka kryetar partie një femër, është një tjetër tregues sepse seksi femër ndihet inferior në politikë, dhe për të kompensuar “handikapet” e mentalitetit shqiptar, detyrohet të përdor gjuhën e meshkujve për të gjetur vendin e duhur në ambientin politik.

Politika është një investim për të gjithë individët, dhe përfaqësimi i grave në çdo instancë është një tregues i mosdiskriminimit dhe përmbushja e standardeve demokratike të një vendi.

Gratë janë qenia të brishta dhe si të tilla nuk meritojnë të përdoren për të baltosur apo shpifur për interesa të ngushta politike. Të tillë leksion në teori e kanë artikuluar të gjithë liderët meshkuj, por praktika ofron një panoramë tjetër.

Nuk është thjesht se kemi të bëjmë me një rikthim të fjalorit banal në politikën tonë. Nuk është pra se kemi të bëjmë me një fenomen që diku na paska shkuar dhe na qenka kthyer befas në jetën tonë të përditshme. Fyerjet, sharjet banale si prej "të fortësh", ofendimet, të cilat e bëjnë të skuqet atë që i dëgjon, por aspak atë që i thotë, kanë qenë prezent edhe nëse

nuk janë shprehur publikisht. Ato kanë qenë prezent në shikimet e hakërryera, në mendjet inatçore, në qëndrimet armiqësore, në kokëfortësinë jo vetëm për të mos respektuar tjetrin dhe mendimin ndryshe, por edhe për të mos e marrë atë fare në konsideratë. Nga këto, politika jonë në përgjithësi ka vuajtur e po vuan dita me ditë. **(Baxhaku, 2009)** Roli i gruas në shoqëri ka qenë pothuajse vendimtar, por edhe romantik, sa turbullues, aq edhe zemërplagosës, nga magjepës te çudibërës, nga shkaktar luftërash te dashuritë klasike. Sot mesa duket, prirjet janë drejt profilizimit të gruas edhe si shtëpiake, romantike, gjellëbërëse, edhe si politikane, qeveritare, administruese. Ky dualizëm Hegelian duket sikur po skalit një tipizim të ri në hierarkinë e tij të grave moderne, atë të një femre të maskilizuar, që është fizikisht femër dhe ideologjikisht mashkull. (Konomi, 2010)

3.3.Çfarë na thotë historia

Në vitin 1921 Shqipëria nënshkroi konventën ndërkombëtare për të drejtat politike të grave dhe në vitin 1945 aplikoi të drejtën e votimit dhe kandidimit të tyre (të grave). Femrat shqiptare janë bërë për herë të parë pjesë e Parlamentit në Legjislaturën e parë, atë të viteve 1945-1950. Në një total prej 82 deputetësh, ku 6 prej tyre ishin femra. (<http://top-channel.tv>)

Në rang ministror në vitet 1912-1948 nuk kishim asnjë grua. Në vitin 1948, vetëm për një kohë të shkurtër disa mujore, u emërua ministria e pare grua Naxhije Dume. E njëjta situatë, asnjë grua ministre, edhe gjatë periudhës kohore 1949 – 1977. Ndërsa gjatë viteve 1978-1990 kishim promovimin nga regjimit të vetëm tri ministreve (Tefta Cami: 1976-1987, Themie Thomai: 1976-1989 dhe Vito Kapo: 1982-1990). Ministrja femër më

jetëgjatë në Parlamentin e para '90-ës ka qenë Themie Thomai, Ministre e Bujqësisë në vitet 1976- 1989. (<http://top-channel.tv>)


Numri më i ulët i femrave në Parlament ka qenë në legjislaturën 91-92, në zgjedhjet e parakohshme. Tranzicioni post 1990, solli një numër në rritje të grave ministre, përmendim këtu me afërsi diku 20-22 të tilla (u emëruan Panariti, Ymeraj, Pati, Pronjari, Dade, Meksi, Çeço, Shuli, Leskaj, Trashani, Bregu, Godo, Kodheli, Kumbaro, Harito, Gjermani, Gjoshë, Nikolla, Ikonimi, Felaj, Xhaçka dhe Manastirliu). Tipar tjetër i viteve 97'-05' për përbërjen e kabineteve qeveritare është me rëndësi të përmendet fakti se kemi një numër diku rreth 2-3 politikane gra të cilat qarkullojnë në kabinete, por pa zgjerim të numrit të grave konkurruese për poste të larta drejtuese. Në këtë periudhë vlen të përmenden tentativat dhe pse pa sukses në zgjedhjen e një gruaje Kryeministre, ku dy politikane femra, Meksi e Çeço, konkuruan për këtë post por humbën votimin përballë politikanëve meshkuj, Majko e Meta. (<http://isp.com.al>)

Edhe pse përsëritet e ripërsëritet ndërkombëtarisht për pjesëmarrje 30 për qind të femrave në politikë, mjedisi mbizotërohet ende nga meshkujt.

Gjatë 2005-2013 ka pasur një grua në krye të parlamentit, institucioni më i rëndësishëm kushtetues në sistemin politik. Jozefina Topalli është vetmja femër kryetare e Kuvendit jo vetëm në këto 25 vjet, por në gjithë historinë e parlamentarizmit shqiptar. Por ende nuk kemi ndonjë parti kryesore politike që të drejtohet nga një grua politikane, ende asnjë kabinet qeveritar nuk drejtohet nga një grua.

KUVENDI SHQIPERISE	VITI	1991-1992	1992-1996	1996-1997	1997-2001	2001-2005	2005-2009	2009-2013	2013- vazhdim
DEPUTETE	FEMRA	9	9	21	11	9	9	22	24

Grafiku nr.5:



3.4 Pse është e rëndësishme të kemi përfaqësim të barabartë të dy gjinive në parlament?

Të gjithë jemi të vetëdijshëm se demokracia në Shqipëri filloi në kushte të vështira, filloi në një kohë kur njerëzit gati për 50 vjet ishin përballur me kuptimin e asaj që njihet si “demokracia popullore”, dhe kur në tekste propagandohej intensivisht lufta ndaj demokracisë pluraliste. Ku as tek njerëzit e thjeshtë e as tek inteligjenca, përfshirë edhe atë universitare, nuk kishte një vizion të plotë dhe kulturë të gjerë të demokracisë perëndimore.

Filloi një erë e re e cila tani më kishte emrin e ndërtimit të një shoqërie demokratike në Shqipëri. Si një proces transformimi rezultoi të ishte i vështirë për të gjithë popullsinë dhe u shoqërua me të dhëna që tregonin uljen e nivelit të pjesëmarrjes së gruas në jetën publike dhe politike.

Në Shqipëri demokracia akoma është në evolucion, njëkohësisht cilësohet dhe si e brishtë. Pra, demokracia është një teknikë politike që kërkon një tërësi kushtesh. Konvertimi i statusit të pushtetit, ose formula: *gjithë pushteti i askujt*, minon mundësinë për të abuzuar me pushtet, dhe është thembra e Akilit në një shoqëri politike parademokratike. (**Sartori, 1998**) Ka një optimizëm nga të gjithë për konsolidimin e saj në të ardhmen. Demokracia nga vetë natyra e brendshme e saj, sic pohon Dahli, është proces, dhe si e tillë ajo përmban si mundësinë e përsosjes, ecjes përpara, konsolidimit, ashtu dhe stanjacionit, krizës, deformimit, kthimit prapa. Thelbi i sistemit demokratik nuk është pushteti, as monologu, por qytetari dhe dialogu i qytetarit me të ngjashmit e tij. Në vendin tonë vërtet janë kryer reforma si dhe ka përafrim të legjislacionit tonë me atë të vendeve të BE-së.

Përfaqësimi i barabartë i gruas në politikë është konsideruar të jetë shumë i rëndësishëm. Njëra ndër argumentet kryesore është se përderisa gratë përbëjnë 51 për qind të popullsisë është e drejtë juridike elementare që gratë të përfaqësohen në institucionet politike në mënyrë të barabartë me burrat. Demokracia e kërkon një gjë të tillë sepse mos përfaqësimi i barabartë i grave në politikë bie në kundërshtim me konceptin e demokracisë. Argument tjetër duke u bazuar dhe në argumentin e shkencëtares politikane Angleze Ann Philips është se gratë kanë interesa, nevoja dhe eksperiencë të ndryshme nga burrat dhe se këto interesa mund të përfaqësohen vetëm nga gratë e jo nga burrat dhe për këtë arsye duhet të

ketë përfaqësim të barabartë të dy gjinive në parlament. Shumë mendojnë se mungesa e gruas në proceset politike është si rezultat i kualifikimit të ulët të gratë, mungesës së talentit, mungesës së ambicieve politike dhe të vetëbesimit për të marrë vendime politike. Është e vërtetë se në shumë raste niveli i edukimit të gratë është më i ulët sesa të burrat por kjo nuk do të thotë se gratë janë më të paaftha se burrat por se gratë gjithmonë kanë qenë të diskriminuara dhe vazhdojnë të diskriminohen në aspektet edukimit dhe të punësimit. Mungesa e mundësive materiale për t'u promovuar, kushtet e rënda ekonomike dhe sociale për shumë gra janë disa nga pengesat të cilat nuk i lejojnë ato të inkuadrohen në politikë. Por përveç këtyre, ndër pengesat kryesore janë barrierat institucionale si për shembull sistemi i rekrutimit në partitë politike.

Lidhur me përfaqësimin e gruas në politikë s'ka pse të hezitohet, pasi shembujt janë nga më të arrirët në botë por dhe në vendin tonë. Mendo Indira Gandin, Golda Mejerin apo Margaret Thacerin. Që të trija ishin kryeministre të fuqishme në vendet e tyre. Që të tria i tejkaluan burrat në fushat e tyre dhe nuk patën shumë kohë për atë që më vonë u njoh si feminizëm.

Historia ka treguar se kur vjen puna tek formimi i qeverive, gratë kanë arritur të dalin jashtë "burgut" të zotërimeve të tyre tradicionale si edukimi dhe çështjet sociale. Politika e jashtme në veçanti është bërë një aspiratë femërore. Sa më shumë të rritet pjesëmarrja e gruas në politikë dhe në qeverisjen e vendit, aq më i emancipuar është ai vend dhe ajo shoqëri.

Partitë politike duhet t'i sigurojnë përkrahje grave dhe financim në mënyrë që t'i ndihmojnë në kandidimin dhe fitoren e tyre. Ato duhet t'i përfaqësojnë gratë në mënyrë të

barabartë me burrat duke i përfaqësuar ato edhe në nivele më të larta të partisë jo vetëm në nivele të ulëta. Ndërsa Ligji ‘Për Barazinë Gjinore në Shoqëri’ bënte thirrje për pjesëmarrjen e grave në politikë për të arritur nivelin 30%, Kodi Elektorale nuk vuri në vend mekanizmat që do ta garantonin atë. Kodi Elektorale i dha partive politike hapësirë për të vendosur nëse do të përfshiheshin emrat e grave si një nga tre emrat në krye të listës, apo nëse thjesht gratë do të përfshiheshin si 30 për qind të listës së përgjithshme të kandidatëve. (ACER dhe ASET, 2010)

Kuotat - Në fillimet e viteve '90 koncepti i kuotimit gjinor, ishte akoma i paqartë për shumë vende të rajonit, përfshi këtu edhe Shqipërinë. Një nga qëllimet kryesore të kuotës ishte që të garantohej një përfaqësimi detyrueshëm i të dyja gjinive në organet e zgjedhura. Në vendet në zhvillim ku edhe Shqipëria bën pjesë, kuotat janë një hap shumë i rëndësishëm drejt përfaqësimit politik të grave. (Rrjeti i Grave “Barazi në Vendimmarrje”, 2010) Por cili është vendi i cili ka përqindjen më të lartë të grave në parlament? Përgjigja është Ruanda, ku gratë përbëjnë gati gjysmën e anëtarëve të Dhomës së Deputetëve, gati 48.8%. Mjerisht priremi që t'a lidhim këtë me gjenocidin e 1994 dhe jo me barazinë gjinore. Por, çfarë treguesi të rëndësishëm ka vendosur Ruanda për barazinë e grave në listat e saj zgjedhore? Sërish përgjigja është kuotat gjinore, Kushtetuta e saj përcakton se gratë duhet të kenë së paku 30 për qind të pozitave politike. (Politics & Gender, 2006)

Edhe në Shqipëri zgjedhjet e qershorit 2009 ishin një provë e këtij kuotimi gjinor. Por 30 për qind i përfaqësimit nuk u arrit. Kjo pohon edhe një herë faktin se zbatimi i kuotës të ne zbuloi natyrën e rrënjësuar thellë të diskriminimit gjinor në proceset e rekrutimit të kandidatit.

Në demokracitë moderne *shoqëria civile* luan një rol të rëndësishëm dhe mund të kontribuojë në mënyra të ndryshme në avancimin dhe përfaqësimin e grave në proçeset politike. Ato mund t'i ndihmojnë gratë duke lobuar për të siguruar që çështjet e grave të adresohen në platformën e partisë dhe për ndryshime në legjislativ. Po ashtu duke organizuar projekte të ndryshme për t'i edukuar qytetarët për rëndësinë dhe arsyet se pse duhet të kemi një përfaqësim të barabartë të grave në politikë. Por a është kjo demokraci? Një situatë e tillë është tregues i faktit se proçesi i demokratizimit në Shqipëri është i papërfunduar dhe ne nuk mund të flasim për një rend demokratik për aq kohë sa grupe të caktuar qytetarësh do të mbeten të papërfaqësuar e të paangazhuar politikisht. Mund ta quajmë demokraci, por natyrisht jo dhe aq përfaqësuese. Pra, një lloj demokracie minimale. (Hasimja, 2010)

Përmbledhje kapitulli

Në këtë kapitull, fillojmë të futemi në analizën e çështjeve dhe pikërisht fokusi ka qenë i vendosur në rolin që ka pasur gruaja shqiptare në politikë gjatë periudhës së tranzicionit, sa ka ndikuar ndryshimi i regjimit dhe tranzicioni shoqëror në përmirësimin e rolit të gruas në funksione drejtuese, vendimarrëse dhe politikëbërje. A kanë qenë femrat të mirëpërfaqësuar apo përfaqësimi i tyre (parë dhe në aspektin historik) ka lënë për të dëshiruar, si kanë qenë ritmet e përfshirjes së tyre (femrave) pas viteve 90' dhe përse për ne si shoqëri dhe si vend është e rëndësishme të kemi një përfaqësim të barabartë të dy gjinive në parlamentin tonë.

Shembja e diktaturës komuniste pas viteve '90 dhe vendosja e një sistemi liberal, lejoi pluralizmin politik, pra krijimin e partive të tjera politike dhe braktisi rrugën socialiste të ndërtimit të rendit shoqëror dhe ekonomik. Shoqëria shqiptare, ka kaluar shumë stadi zhvillimi, të cilat kanë qenë në përputhje dhe varësi të ndërsjellta me zhvillimet historike, politike, apo dhe ato ekonomike, dhe kjo por dhe shumë faktorë të tjerë bënë të mundur krijimin e kulturës së sotme politike, një kulturë e cila nuk është aspak në favor të shoqërisë njerëzore, nuk është në favor të gruas shqiptare. Natyrisht që jetës publike në vendin tonë nuk i kanë munguar gratë, raport numerik i cili nuk ka ndryshuar shumë nga viti në vit, kanë qenë me një prezencë të dobishme por në pikëpyetje ka qenë zëri i tyre, postet që kanë mbajtur si dhe prania në jetën publike dhe media. Përfaqësimi i gruas është në një krizë sepse akoma nuk po perceptohet ashtu siç duhet vendi i saj në karrierën politike. Është për të ardhur keq që edhe pas dy dekadave të postdiktaturës, gruaja shqiptare është prezente në Shqipëri vetëm në shifra, ajo përfaqëson gati 51 për qind të popullsisë shqiptare, por nga

ana tjetër kjo shifër nuk reflektohet në asnjë aspekt të jetës. Ndoshta kjo vjen ngaqë sistemi socialist në Shqipëri kërkonte në një farë kuptimi që gruaja të ishte amvisë dhe nënë e mirë që sakrifikonte për familjen e saj, sepse shteti socialist, nuk i inkurajonte gratë, nuk bëri që ato të ndërgjegjësoheshin për lirinë e tyre të brendshme, dhe kjo mënyrë ishte ajo e cila nguliti në shoqërinë shqiptare idenë se identiteti i gruas ishte i lidhur më së shumti me rolet e saj gjinore. Demokracia nga vetë natyra e brendshme e saj, siç pohon Dahli, është proces, dhe si e tillë ajo përmban si mundësinë e përsosjes, ecjes përpara, konsolidimit, ashtu dhe stanjacionit, krizës, deformimit, kthimit prapa. Dhe në Shqipëri demokracia akoma është në evolucion, dhe njëkohësisht cilësohet si e brishtë akoma. Demokracia e kërkon një përfaqësimin të barabartë gjinor sepse mos përfaqësimi i barabartë i grave në politikë bie në kundërshtim me vetë konceptin e demokracisë. Mos përfaqësimi i gruas shqiptare nuk është domosdoshmërisht problem i gruas por është një problem shoqëror, pasojat e të cilit reflektohen në të gjithë shoqërinë shqiptare. Nevoja për përshtatje me rrjedhën e ndryshimeve të përgjithshme shoqërore e politike në një farë mënyre përcakton dhe ndryshimin e raporteve gjinore në shoqëri, përcaktim i cili ndikon nga ana tjetër në përfaqësimin dhe integrimin e barabartë të gruas në sferën publike vendimmarrëse. Kjo sepse përfaqësimi i barabartë i gruas në politikë është konsideruar të jetë shumë i rëndësishëm për një shoqëri europiane dhe për vetë procesin demokratik. Por sot mesa duket, prirjet janë drejt profilizimit të gruas edhe si shtëpiake, romantike, gjellëbërëse e njëkohësisht edhe si politikane, qeveritare dhe administruese. Rruga është akoma e gjatë dhe për femrën ka akoma shumë për të bërë, që të mund të japë dhe të marrë në shoqërinë shqiptare, në pozita vendimmarrëse. Sepse sa më shumë të rritet pjesëmarrja e gruas në politikë dhe në qeverisjen e vendit, aq më i emancipuar është ai vend dhe ajo shoqëri.

KAPITULLI IV: REALITETI POLITIK I KRIJUAR NGA LIGJËRIMI

4.1. Ligjërimi

Në teoritë e komunikimit njihet që diskursi prodhon realitet. Shpesh herë është realiteti ai që prodhon ligjërime të caktuara por ndërkohë edhe një ligjërimit i caktuar mund të prodhojë një realitet. Në këtë punim, me termin ligjërimit, do të kuptojmë atë mënyrë tonën të të qenit, që përfshin jo vetëm gjuhën dhe fjalët tona, por dhe mënyrat tona të të vepruarit, ndërvepruarit, të të ndjerit, të besuarit, të vlerësuarit apo përdorimit të objekteve, simboleve, mjeteve dhe teknologjive; të njohjes së vetes dhe të tjerëve si vetja si kuptime në disa mënyra të caktuara. Ky ligjërimit përfshin trupin, rrobat, gjestet, vlerat, zakonet, emocionet, kohën dhe vendin. Kështu jeta jonë dhe, e secilit prej nesh, është një mozaik mendimesh, fjalësh, objektesh, ngjarjesh, veprimesh dhe ndërveprimesh, ku ne prodhojmë, riprodhojmë, mbështesim apo transformojmë një “formë të caktuar jete”, të cilës i përkasim. (Paul, 2005)

Komunikimi politik është një ligjërimit me natyrë, objektiva dhe parametra formalë politike dhe së dyti, ai është televiziv. Në kuadrin e një komunikimi politik me publikun, kur flasim për ligjërimit nënkuptohet që forma e këtij ligjërimit, lloji apo dhe përmbajtja janë specifike, sepse nuk mund të mendojmë se do të jetë njësoj ashtu sikurse bëhet një leksion universitar, apo ndërtohet një tekst/shkrim në shtypin e shkruar. Në një demokraci, komunikimi politik është parë si vendimtar për ndërtimin e një shoqërie ku shteti dhe njerëzit e saj të ndjehen të lidhur. Nëse i referohemi komunikimit politik të bërë nga aktorët e shoqërisë civile duhet të kuptojmë që një lloj i tillë komunikimi në një farë mënyre është i detyruar që të privohet nga elementë të tillë si: gjatësia e arsyetimit, përmasat historike të paraqitjes së problemit,

futja e një informacioni shumë të zgjeruar teknik në brendësi të tij. Komunikimi politik duhet, pra, për të kryer rolin e një aktivizuesi; të mos jetë thjesht një seri “dekretesh” të shoqërisë të bëra nga një elitë në pushtet por të lejojë reagime nga shoqëria për të inkurajuar pjesëmarrjen. Gjithashtu duhet të themi se nga ky lloj komunikimi politik nuk mund të presim që njerëzve t’u komunikohen gjëra të cilat ato i dinë mbase dhe më mirë se ai që i shpreh në televizion, por duhet që ky komunikim publik të ketë një qëllim të qartë ndaj vetes, të zbulojë çështjen në një këndvështrim të ri që të mund ta bëjë interesante për qasjen përpara publikut.

Probleme – argumente për të vepruar – objektiva konkrete për të realizuar

Është struktura më e gjetur për komunikimin politik me publikun. (<http://www.infocip.org>)

Ka rëndësi që komunikimi politik të jetë i qartë dhe me argumenta konkrete.

Debatet e sotme politike dhe ato të filozofisë politike ndërlidhen ngushtë jo vetëm me komunikimin, por edhe me gjuhën dhe ligjërimin. Të gjithë ne jemi të vetëdijshëm për një rrëmujë në dukje të ligjërimin sot dhe hetereogjenitetit të fakteve të gjuhës.

Analiza e ligjërimin është një fushë e re studimi që i përket gjysmës së dytë të shekullit XX-të. Ajo përbëhet nga qasje që studiojnë mënyrat se si gjuha përdoret në tekste (të folura ose të shkruara) dhe në kontekste konkrete. Ajo nuk merret me gjuhën në përgjithësi, si sistem por me akte të veçanta ligjërimi. Kjo analizë mbështetet në elementë gjuhësorë por në çdo rast e sheh gjuhën si ndërveprim social. Materiali gjuhësor që përdoret në ligjërim është tregues i rëndësishëm i identitetit të folësit.

Gjatë studimit të gjuhës hasim në dy qasje: ***qasja formale*** dhe ***qasja funksionaliste***. Qasja formale është studimi i gjuhës nga pikëpamja e formave, strukturave dhe përdoret sidomos

nga gramatikanët, pra gjuhëtarët që synojnë studimin e gramatikës. Ndërkohë që qasja funksionaliste është studimi i gjuhës nga pikëpamja e funksioneve që ajo kryen gjatë përdorimit, është studim i ligjërit.

Gjuha që ne përdorim ndryshon. Ajo ndryshon në varësi të aktivitetit, mediumit, marrësit etj. Por gjithashtu gjuha e folur ndryshon edhe më shumë nga një folës te tjetri, nga një grup shoqëror te tjetri, dhe në këtë rast kemi të bëjmë me gjuhë sociale. Gjuha nuk është funksion vetëm i folësit por i të gjithë subjekteve që i përkasin komunitetit. Gjuha politike është mjeti kryesor i politikë-bërjes. Ajo përdoret në varësi të interesave të caktuara politike dhe mund të jetë e qartë ose e paqartë sipas vërtetësisë së këtyre politikave. Diapazoni i të folurit politik është i larmishëm. Të flasësh pak e të thuash shumë, të flasësh shumë e të mos thuash asgjë, të komplikosh frazën për të fshehur mendimin, të ndërtosh gjysmë të vërteta, të buzëqeshësh duke kamufluar urrejtjen, të gjitha këto janë mjete të diapazonit të mjeteve shprehëse të politikës.

Sipas profesorit të njohur Artan Fuga terminologjia e tranzicionit politik në Shqipëri ka qenë idealiste dhe esencialiste, në kuptimin që politikanët përdorin fjalë, emra ose mbiemra që e shkëpusin të folurit nga bota reale – politike, për ta çuar drejt realitetesh të tjera zëvendësuese dhe në të njëjtën kohë ka dhe në themel dhe intolerancën kuptimore. Kuptohet që në rastin e politikanëve shqiptarë pjesa më e madhe e emrave, mbiemrave që ata përdorin janë të huazuara nga fjalimet e liderëve politikë, mbështeten në zhargonin popullor, kërkojnë të tërheqin mediat me anë të batutave të reja dhe bombastike për kundërshtarët politikë, krijojnë fushata publicitare të bazuara në slogane të thjeshta dhe që memorizohen lehtë nga shtresat e ndryshme shoqërore si dhe nxisin një gjuhë përjashtuese

ndaj kundërshtarëve politikë. Të gjitha këto krijojnë një atmosferë të vazhdueshme rivaliteti politik, e cila shpeshherë e humbet kufirin midis sferës publike dhe sferës private. Shumë nga konflikti gjuhësor është shumë më shpesh i imagjinuar dhe i përfytyruar sesa real dhe i gjithë debati ngrihet mbi baza të konstruktura, të cilat pa prezencën e një gjuhe esencialiste, vështirë se do të ekzistonte ndonjë konflikt midis dy krahëve të ndryshëm politikë. Gjuha si pjesë e kulturës së përgjithshme, qoftë kjo gjuhë etnike, shtetërore, partiake etj., është në një proces të vazhdueshëm ndryshimi dhe evoluimi, regresiv apo progresiv.

“Gjuha është ai produkt shoqëror që i lejon individit të ushtrojë aftësinë e tij të të folurit: ajo është ‘ligjërimi pa të folurin’. **Saussure** (Meunier & Peraya, 2009: 38)

Por, gjuha që përdorin liderët kryesorë të partive politike është një gjuhë e ngurtësuar që lë pak shteg për dialog dhe për arritjen e një konsensi politik. Gjithashtu është një gjuhë që njihet vetëm nga anëtarët/anëtarët e secilës parti politike dhe shpesh për publikun e gjerë dhe që nuk janë anëtarë të asnjërës nga partitë politike duket absurd një debat i tillë dhe shpesh shkakton skandal duke tërhequr në këtë mënyrë dhe vëmendjen e përgjithshme të opinionit publik dhe duke i mobilizuar për të votuar për njërin apo tjetrën palë apo thjesht për të marrë në protestat apo manifestimet reciproke.

Stili *non infinito* (i papërfunduar) është bërë tipar evident, i të folurit të politikanëve shqiptarë, të cilët e kanë kthyer në qëllim të folurin evaziv, të papërfunduar. Por profesionistët e komunikimit politik e dinë se “abc” e komunikimit politik është: politikani duhet t’i peshojë mirë fjalëve që thotë pasi fjala mund të marrë jo vetëm atë kuptim që folësi jep por edhe kuptimin e atyre që e dëgjojnë. (Fuga, 2005)

Gjuha merr kuptim e vendosur në kontekste të caktuara sociale. Kështu, gjuhë jo-politike mund të jetë çdo komunikim ku palët mirëkuptohen mbi çështjet që janë në diskutim dhe në momentin që ka paqartësi mbi domethënien e kësaj gjuhe, apo kur njëra palë përpiqet të bindë palën tjetër nëpërmjet argumentave, thuhet se kjo gjuhë është politike.

Gjuha politike ashtu si dhe konfliktet, janë të dyja pjesë e politikë-bërjes, pa të cilat nuk mund të ekzistojë një shtet demokratik. Niveli i konfliktit dhe ashpërsisë së kësaj gjuhe reflekton nivelin e demokratizimit të vendit dhe shoqërisë, nivelin e tolerancës për pranimin e mendimit ndryshe. Megjithatë, është e pamundur të synojmë drejt një komunikimi politik të qartë dhe të drejtpërdrejtë, pasi siç thotë Orwell, çdo përpjekje kundër abuzimit me gjuhën është thjesht sentimentalizëm i vjetëruar, njëlloj si të preferosh qirinjtë ndaj dritës elektrike. (Orwel, 1946) Gjuha politike përdoret në varësi të interesave të caktuara politike dhe mund të jetë e qartë ose e paqartë sipas vërtetësisë së këtyre politikave. Shkrimtari Xhorxh Orwell thotë: “*Armiku më i madh i qartësisë së gjuhës është mungesa e sinqeritetit*”. Sipas tij, gjuha politike është ndërtuar e tillë që të bëjë gënjeshttrat të tingëllojnë të vërteta dhe vdekjen të respektueshme”. Megjithëse referimi ishte i lidhur me problematikën e Anglisë së fillimit të shek. XX-të, kjo deklaratë është mëse e vërtetë edhe për realitetin në të cilin ne jemi duke jetuar këtu në Shqipëri.

Edhe nëse gjuha politike është e sinqertë, ajo është e lidhur ngushtë me ideologjinë përkatëse. Liderët politikë në Shqipëri, pavarësisht gjinisë femër apo mashkull përdorin mekanizma gjuhësorë të veçanta duke i shtuar elementë patriarkalistë dhe agresivë debateve dhe diskutimeve të tyre. Kështu ata i përshkruajnë kundërshtarët politikë me ndihmën e mbiemrave në shkallën krahasore dhe me anë të figurës letrare të hiperbolës. Në

gjuhën shqipe mbiemri ka tre shkallë: e barazisë, e sipërisë dhe e ultësisë. Në shumicën e rasteve anëtarët e intervistuar të PD-së dhe PS-së përdorin mbiemrin në shkallën sipërore, e cila gjithashtu ka dy shkallë: relative, e cila vë në dukje se cilësia e një sendi qëndron në një shkallë më të lartë se ajo e gjithë grupit ku ai bën pjesë; ndërsa mbiemri në shkallën sipërore absolute mbiemri shpreh cilësinë në një shkallë shumë të lartë dhe jashtë çdo krahasimi. Kjo shkallë ndërtohet duke vendosur përpara mbiemrit një ndajfolje sasive të tillë si: shumë, tepër, fort, mjaft, jashtëzakonisht etj. Mbiemri në shkallën sipërore absolute është shkalla që përdoret gjerësisht nga anëtarët e intervistuar të PD-së dhe PS-së, duke bërë që përshkrimet me mbiemra që ata japin për liderin e tyre të jenë jashtë çdo krahasimi brenda grupit apo partisë së tij dhe të dalin jashtë çdo kornize reale, duke i dhënë partive politike shqiptare tipare populiste. (Budini, 2008)

4.1.1. Ku qëndron rëndësia e teorisë së Vitgenstajnit për gjuhën dhe krijimin e realitetit politik?

Brenda veprës së tij, gjuha shihet në mënyra të ndryshme, në sensin e një evolucioni. Në tekstet e para, Wittgenstein-i e konsideron gjuhën si një mjet pasqyruar të realitetit. Pra gjuha na shërben për të përfaqësuar dhe pasqyruar realitetin, konceptim të cilin më pas, Wittgenstein-i e braktis. Fjalët mund të marrin kuptime të ndryshme dhe kuptimet e tyre varen nga konteksti ose nga ajo që Wittgenstein-i quan “forma jete” në të cilat angazhohen njerëzit që komunikojnë. Gjuha është akt publik dhe politik për nga vetë natyra. Një pasojë e rëndësishme e një konceptimi të tillë të gjuhës lidhet me debatet politike. Kushti themelor i zhvillimit të një debati është të folurit e një gjuhe të përbashkët, në kuptimin e një “marrëveshjeje” paraprake mbi përkufizimin e disa koncepteve bazë. Por kjo nuk ndodh gjithmonë. Në pamje të parë debati është plotësisht i mundur. Mirëpo nëse zhvendosemi

nga pikëpamja e Wittgenstein-in do të kuptojmë se që debati të ketë kuptim, duhet që pjesëmarrësit të merren vesh me njëri-tjetrin se për cilat konceptime do të flasin. Nëse nuk bien paraprakisht dakort për kuptimin e “fjalëve” pjesëmarrësit rrezikojnë të gjenden në një situatë të ngjashme me “Kullën e Babelit”. Praktikisht do flasin gjuhë të ndryshme, sepse fjalët kanë kuptime të ndryshme për secilin. (Edelman, 1985) Debatet dhe ndeshjet politike nisur nga kjo pikëpamje tashmë na bëjnë të humbasim shpresën për të gjetur “të vërtetën”.

Nga pikëpamja praktike, teoria e Wittgenstein-it na shtyn ta shikojmë politikën si një “lojë fjalësh” në të cilën aktorët e ndryshëm përpiqen të imponojnë kontekstin e tyre. Përmes manipulimit³ të gjuhës, politika mund të arrijë të kontrollojë apo orientojë kuptimin e konteksteve apo edhe mënyrën sesi ne i shikojmë gjërat.

Nëse do të niseshim nga hipoteza e *Sapir-Whorf* e relativizmit gjuhësor do të pretendonim se struktura e gjuhës i jep formë asaj që mendojnë dhe bëjnë njerëzit, mbi të cilën bëhet ndërtimi shoqëror i realitetit. (Griffin, 2008)

Teoricienët shoqërorë kulturorë pohojnë se pikërisht përmes procesit të komunikimit, “realiteti prodhohet, ruhet, riparohet dhe transformohet”.

Teoria e “krijimit” të realitetit politik përmes gjuhës mbështetet edhe në teza të tjera të dala kryesisht nga socio-linguistika ose psikologjia. E tillë është hipoteza e Eduard Sapirit dhe Benxhamin Uorfit. Duke analizuar dallimet në aftësitë e kapjes së koncepteve të ndryshme abstrakte nga popuj me gjuhë të ndryshme, Whorf-i (1956) arriti në përfundimin se gjuha ndikon mendimin fuqishëm. Sipas tij, gjuha na shërben si një lloj përkthyesi i realitetit të

³ Këtu po përdoret termi “manipulim” në kuptimin e tij origjinal etimologjik: punimi i diçkaje, përdorimi, dhënia e një forme të caktuar.

cilin ne mund ta kuptojmë vetëm përmes koncepteve të shprehura gjuhësisht. Këta koncepte nuk janë as universale e as neutrale, por janë prodhim i kulturës në të cilën bëjmë pjesë. Rrjedhimisht, duke përdorur një gjuhë të caktuar, ne e shikojmë realitetin përmes prizmit të asaj kulture dhe jo në mënyrë universale. Metaforat politike përdoren sot gjerësisht në politikë. Përdorimi i tyre ndihmon në mobilizimin e përkrahësve të një partie si dhe në ndikimin e votuesve të pavendosur. (Edelman, 1985)

Në Shqipëri si të tilla mund të përmendim: “duart e pastra”, “Shqipëria 1 euro”, “padrinot qeveritarë”, “spastrimi i administratës”, “çlirimi i tregut”, etj.

4.2. Ligjërimi publik

Arti më i vjetër i komunikimit me një masë të gjerë njerëzish është ligjërimi publik. “*Në Lashtësi ka qenë gojëtaria ose oratoria lëmi i zanafillës e i përpunimit të këtij stili dhe për shumë kohë e përfaqësonte atë*” (Lloshi, 2012: 217-218). Zanafillën e saj si art i lëvruar, gojëtaria e ka në Greqinë e lashtë, ishin shkrimtarët klasikë grekë dhe më pas ata romakë të parët që e studiuuan gjerësisht artin e të folurit në publik. Këto shkrimtarë u përpoqën që ta kodifikonin retorikën për të identifikuar pjesët dhe funksionet e saj si edhe për të përshkruar veçoritë e një fjalimi të efektshëm. Në shkollat e tyre nxënësit aftësoheshin për të folur në publik, për të argumentuar një çështje dhe, mbi të gjitha, për të qenë bindës që mendimet e tyre të gjenin përkrahje e miratim. Këto shërbenin veçanërisht për ata persona që aspironin të ishin pjesë e politikës, ligjit dhe qeverisë, që të përcjellin mesazhin e fjalës së tyre sa më rrjedhshëm e fuqishëm me qëllim bindjen e publikut.

Sipas dy autorëve të tjerë (Cockcroft & Cockcroft, 1992), *retorika* përkufizohet si “arti i ligjërimit bindës”, duke e përdorur fjalën *ligjërim* në kuptim të komunikimit të folur dhe

atij të shkruar, ndërsa, *bindjen* – “artin më të vjetër demokratik” (Partington, 2010: 9)– si procesi i krijimit, i përforcimit apo i të ndryshuarit të besimeve apo veprimeve të njerëzimit (Miller, 2002: 3-16). Edhe pse sipas këtij përkufizimi *retorika* lidhet me të gjitha format e komunikimit njerëzor, përdorimin më të shpeshtë ajo e gjen veçanërisht te ligjërimi publik. Gjuha është ai mjet i cili mund të përdoret si mjet për bindjen me anë të forcës dhe për manipulimin e informacionit (në regjimet totalitare) apo dhe për të arritur bindjen gjatë debateve duke përdorur aftësitë bindëse (në sistemet demokratike). (Partington, 2010: 13)

Thelbi i retorikës përbëhet nga: të bindësh njerëzimit që të pranojnë versionin tënd të ngjarjeve, të ‘së vërtetës’ – në krahasim me versionet e tjera. (Partington, po aty: 6)

Arti i bindjes politike lindi me demokracinë e parë në Greqinë e lashtë. Ishin filozofët grekë ato që zhvilluan atë që e ata e quajtën *retorikë*, që nuk është gjë tjetër veçse aftësi bindëse. Aristoteli e trajtonte retorikën si një pjesë të rëndësishme të aktivitetit njerëzor, si “*aftësinë për të zbuluar të gjitha mjetet e disponueshme të bindjes për një temë,*” (Partington, po aty) dhe i klasifikoi mjetet e bindjes në tri kategori, si më poshtë (Cockcroft & Cockcroft, 1992):

1. *bindja përmes personalitetit dhe qëndrimit; (ethos)*
2. *bindja përmes zgjimit të emocioneve; (pathos)*
3. *bindja përmes mendimit dhe arsyesimit. (logos)*

Publiku arrin të bindet, sepse ai beson se folësi po i ofron një pikëpamje që është etike duke u bazuar në sinqeritetin dhe ndershmërinë e folësit. Edhe sot, shtyllat aristoteliane të bindjes: *ethos*, *pathos*, *logos* ende vazhdojnë të përfaqësojnë retorikën e suksesshme për të arritur bindjen e publikut. Sipas Cupmenit, (Coopman, 2012: 8), ka edhe një mënyrë të

katërt për bindjen e publikut, të quajtur *mythos*, me anë të cilës synohen vlerat dhe besimet e ngulitura në rrëfimet dhe tregimet kulturore. Studiuesit bashkëkohorë e shtuan edhe këtë koncept sepse tregimet, sipas tyre, përfaqësojnë vlera të rëndësishme kulturore që mund të ndikojnë tek publiku.

Ligjërimet, sipas Aristotelit, ndahen në tre lloje: ligjërimi ligjor; ligjërimi ceremonial dhe ligjërimi ndikues. Secili prej tyre shoqërohet me një fushë të caktuar zbatimi, me një aspekt kohor të caktuar dhe me një qëllim të caktuar.

Tipik për ligjërimin politik është ligjërimi ndikues, synimi parësor i të cilit është argumentimi bindës pro ose kundër ligjeve, politikave, vendimeve për të ardhmen.

Retorika që me krijimin e saj i ka pasur të dyja anët e monedhës, pozitiven dhe negativen. Për vetë Platonin, gojëtarit është një “manipulues i fjalës” (Partington, 2010: 13-14). Ai ishte skeptik ndaj *retorikës* dhe besonte se ajo mund të shërbente si një mjet i fuqishëm në duart e njerëzve të paskrupullt për të manipuluar publikun, (Beard, 2000) përderisa ka një hendek mes argumentimit retorik të shëndoshë dhe ‘së vërtetës’. (Partington, 2010:14-15) *Retorika* është vlerësuar në mënyrë negative veçanërisht kur lidhet me politikën, duke u nisur nga mospërputhjet që ekzistojnë midis argumentimit retorik dhe së vërtetës. Në këtë logjikë është etiketuar si lojë fjalësh, hollësira pa rëndësi, ‘*fjalë boshe*’, (Herrick, 2005: 1) dëshirë për të arritur qëllimet personale me çdo kusht apo si ‘*mbrojtje e së pambrojtshmes*’. (Orwell, 1962: 152) Një tjetër kuptim i *retorikës* është edhe ai i ‘*grandiloquence*’, e cila është: përdorimi i gjuhës ‘*pompoze*’ por ‘*boshe*’. (Partington, 2010;14)

Në tre shekujt e fundit, komunikimi me një masë të gjerë njerëzish për të arritur qëllime shoqërore e politike ka ardhur duke u zgjeruar gjithnjë e më shumë. Ndaj aftësia për të komunikuar po bëhet gjithnjë e më e domosdoshme për suksesin profesional.

Shumë profesione (ndër to politikanët) e kanë suksesin e tyre në raport të drejtpërdrejtë me aftësinë e tyre për të folur para publikut. Politikanët iu drejtohen masave të njerëzve për të shprehur programet politike partiake e për t'i bindur se ata vetë dhe platformat e tyre politike janë zgjedhjet më të mira.

4.3. Ligjërimi politik

Karakteristikat e ligjërimin politik vazhdimisht formojnë kulturën politike të një populli.

Termi *ligjërim* përcaktohet në disa mënyra të ndryshme. (Chilton & Schäffner, 2002: 18)

Është e njohur vështirësia për ta përcaktuar termin *ligjërim politik* me saktësi për vetë faktin se të dyja pjesët e frazës, *ligjërim* dhe *politikë* në vetvete lënë shteg për një mori përkufizimesh pak a shumë të gjera. Gjuha dhe politika janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën. Gjuha është mjete shprehës i politikës. Është mjete me anë të cilit idetë politike përcillen në një bashkësi shoqërore.

“Në fakt, çdo veprim politik përgatitet, shoqërohet, kontrollohet dhe ndikohet me anë të gjuhës.” (Chilton & Schäffner, 1997) – në një farë mënyre pra gjuha është thelbësore në procesin e shndërrimit të vullnetit politik në veprim shoqëror. Ndërkoha ka të tjerë studiues të cilët shprehen se politika jo vetëm që zhvillohet *përmes* gjuhës por pjesa më e madhe e politikës në vetvete *është* gjuhë. (Fairclough, 1989: 23)

Madje arrihet deri në përkufizimin se: “*Politika është ligjërimit dhe ligjërimit është politikë.*”, (Shapiro, 1981: 1-2) pra, fjala ka një fuqi të madhe në politikë, ajo “*e bën gënjeshtër të duket e vërtetë dhe vrasjen të respektueshme.*” (Orwell, 1969: 217-219)

Një interes gjithnjë e në rritje në fushën e ligjërimit politik, me studime nga e gjithë bota ka pasur që në fillim të viteve '80 të shekullit të kaluar. (Chilton & Schäffner, 1997) Kjo është një fushë (ligjërimit politik) e cila ka tërhequr studiues të shumtë jo vetëm nga fushat e gjuhësisë por dhe të shkencave politike.

Çiltoni dhe Shefneri (Chilton and Schäffner, po aty) identifikojnë për analizën e ligjërimit politik tri qasje të gjera:

- *qasjen angleze* e cila bazohet në pikëpamjen funksionale të gjuhës në ligjërimit politik,
- *qasjen franceze* e cila mbështetet kryesisht në përdorimin e metodave statistikore kompjuterike për të analizuar çështje rreth leksikut politik, duke krijuar korpusë për të bërë krahasime të bazuara në dendurinë e fjalëve.
- *Dhe qasjen gjermane* e cila fokusohet në analizën e bazuar në tekst dhe në veprim të shtetit gjerman brenda traditave të pragmatikës, sociolinguistikës dhe gjuhësisë njohëse

Kjo analizë e ligjërimit politik i prek pothuajse të gjitha nivelet e gjuhësisë. Ajo mund të studiohet nga këndvështrime të ndryshme të tilla si: sintaksore, gramatikore (ka studime rreth sistemeve funksionale dhe organizimit të tyre në kuadër të sistemeve të ndryshme ideologjike) (Fowler & Marshall, 1985) semantike, leksikore (ka studime të shumta rreth fjalëve me implikime të forta emocionale, rreth zhargonit teknik dhe eufemizmave)

(Graber, 1981: 196) pragmatike (janë trajtuar metafora, aktet e të folurit dhe nënkuptimet) (Van Dijk, 1989: 163-183) apo sociolinguistike (rreth ndikimit të identitetit gjinor në ligjërimin politik). (Gastil, 1992) Shumë studime kanë përdorur perspektivën kritike, por ka pasur edhe një larmi metodash të tjera, që variojnë nga përshkruese e deri në psikologjike (Van Dijk, 1989) ashtu sikurse ka edhe studime rreth përemrave dhe shpërndarjes së tyre në forma politike e forma të tjera të përgjegjësive. (Maitland, 1987)

Përgjithësisht ligjërimi politik mund të përkufizohet si gjuhë e shkruar apo e folur e përdorur në politikë për të drejtuar emocionet e publikut, për të ndikuar mendimet dhe qëndrimet e tyre. Ky lloj ligjërimi dallon nga llojet e tjera sepse është i qëllimshëm, funksional, udhëheqës ndaj një grupi të caktuar njerëzish, i mirë-organizuar dhe i pasur me figura letrare.

Nëse do i referohemi autorëve të sipër përmendur Chilton dhe Schäffner-it, ligjërimi politik është “*një formë komplekse e aktivitetit shoqëror*” (Chilton, 1997: 207). Ato e identifikojnë ligjërimin politik si një lloj të caktuar ligjërimi, veprimet gjuhësore të të cilit përfshijnë *pushtetin* apo krahun e tij të kundërt – *rezistencën* ndaj tij.

Van Dajku, (Van Dijk, 2001), një tjetër autor, shprehet se karakteristika bazë e ligjërimin politik është fakti se ai prodhohet nga politikanë. Ndaj duke u nisur nga ky fakt (se ligjërimi politik prodhohet nga një politikan), atëherë ligjërimi duhet të prodhohet detyrimisht në një institucion. Me pak fjalë, ligjërimi politik është një ligjërim institucional. Pra, që një ligjërim të jetë politik, duhet të shprehet apo të shkruhet nga një politikan në një mjedis institucional si edhe të arrijë një akt politik në një institucion, siç është qeverisja. Pra, që një ligjërim të cilësohet politik, duhet të plotësojë të paktën kriteret e mëposhtme:

- Ligjëruesi të jetë me profesion politikan.
- Ligjërata të komunikohet në një institucion.
- Ligjërimi të arrijë një qëllim politik.

Pra në mënyrë të përmbledhur përmendim përshtkrimin e Uillsonit (Wilson, 2001), sipas të cilit: ligjërimi politik është gjuha e përdorur në situata politike formale dhe joformale me aktorët politikë, si: politikanët, institucionet politike, qeveria, mediat politike dhe përkrahësit politik që operojnë në mjedise politike për të arritur qëllime politike.

Në bazë të veçorive të komunikimit, *stili* i veprimtarisë shoqërore e politike ka *nënstilet*: (Lloshi, 2012: 217)

- Publicistika
- Format gojore publike
- Shtypi
- Radioja
- Televizioni
- Agjitacioni e propaganda

Ne do të përqendrohemi vetëm tek nënstili i formave gojore publike (të cilat përfshijnë tre lloje themelore: fjalimin, diskutimin dhe bisedën politike), si edhe publicistika, meqenëse fjalimet politike, për nga përmbajtja me temë shoqërore-politike nga aktualiteti, nga funksioni dhe nga toni i përngjajnë publicistikës, e cila “përfshin një pjesë të madhe të fjalës publike e të shkrimeve në shtyp”. (Lloshi, 2012: 217)

Ligjërimi publik modern po bëhet gjithnjë e më shumë pjesë e demokratizimit të jetës publike. Klasat shoqërore të cilat nuk merrnin pjesë më parë në jetën publike, tani e kanë

këtë mundësi e cila më parë nuk ishin të disponueshme për ta (Giddens, 1991). Prandaj ligjërimi publik tanimë është më përfshirës edhe për klasat e ulëta.

Në aspektin leksikor, ligjërimi politik, ka një prirje për t'iu afruar ligjërimin të shkujdesur ose ligjërimin të thjeshtë. Ky lloj ligjërimi del jashtë normës letrare sepse e shkel dhe e shtrembëron atë. Në këtë ligjërim gjejmë ofendime nga më të ulëtat, epitete e nofka. Këtu hyjnë fjalë e shprehje “të rënda” dhe me ngjyrimë emocionuese shumë të forta. (Thomai, 2006: 295)

Proceset gjuhësore të dhjetëvjeçarit të fundit të shek. XX-të kanë bërë që të shtohet “manipulimi me anë të fjalës ... e sidomos u është hapur rruga të gjitha mjeteve gjuhësore, duke e ulur kulturën e përgjithshme deri në fjalët më të ndyra në sfondin e gabimeve të papërfytyrueshme të shtypit. ... Shkalla e agresivitetit të gjuhës shoqërore e politike në Shqipëri në këto vite është e pakrahasueshme edhe me vendet e tjera, që kaluan nëpër të njëjtin tranzicion.” (Lloshi, *vep. cit.*: 139)

Në funksion të kredos politike përdoret shpesh gjuha e debatit jo etik e cila tërheq vëmendjen e elektoratit me anë të sulmeve personale, agresive, me batuta dhe nofka banale e vulgare, që kanë ndikim të menjëhershëm në median elektronike e të shkruar, të cilat përdoren si rubrika sensacionale të modelit të skandaleve të figurave të njohura televizive (Hima, 2015: 420).

Në shumicën e rasteve, retorika politike për çështje të caktuara degjeneron në debate banale, duke treguar një mungesë të theksuar etike, profesionalizmi dhe për përgjegjësinë e përfaqësimit të qytetarëve. (Musta, 2011: 147)

4.3.1 Veçori të ligjërimit politik (rasti i Znj. Topalli)

Të gjithëve na bën shumë përshtypje gjuha dhe komunikimi jo vetëm në Parlament, por edhe jashtë tij, një gjuhë e cila është jo vetëm shumë agresive por dhe diskriminuese në raport me kundërshtarin. Kjo gjuhë në fakt nuk është se fyen më shumë kundërshtarin se sa indirekt fyen publikun, qytetarin shqiptar. Situata duke “e rëndë” sepse ky veprim po përsëritet gjithnjë e më shumë në mënyrë të vazhdueshme duke mos sjellë për pasojë më një incident por duke krijuar në një farë mënyre tashmë me këtë sjellje një “standard” komunikimi. Dhe një standard i tillë komunikimi është i papranueshëm për shoqërinë shqiptare por dhe për vende normale e demokratike, sepse në brendësi të këtij lloj komunikimi ka disa lloj racizmash (gjinor, moshor, lokal, etj) të përdorur që janë të patolerueshëm për shoqëritë demokratike.

Ndryshe shfaqet diskursi i tyre politik dhe publik nga çfarë natyra femërore e ligjërimit duhet të përfaqësohej. Presim tone femërore, shprehi “të buta” pa kritika të ashpra, një komunikim diplomatik pa dëmtuar imazhin e tjetrit pra një mirësjellje gjuhësore. Por jo, nuk ndodh kështu në realitetin shqiptar. Nuk ndodh kështu sepse ndryshe nga çfarë ne presim nga natyra femërore, tipare ndryshe gjejmë të paraqitura në tonet e ligjërimit të tyre publik. Të gjithë e dimë që meshkujt dallojnë për stilin e tyre ligjërues: të prerë, bindës e të vendosur, të ashpër e herë herë kërcënues, por në realitetin tonë ky element mashkullor është adaptuar më së miri nga ligjërueset femra, të cilat këtë mënyrë komunikimi e kanë bërë “model sjellje” politike të tyre.

Për sa i përket ligjërimit femëror në politikë vëmë re se dallohet për nivelin e lartë shprehës emocional gjë e cila arrihet me anë të mjeteve të larmishme retorike, përdorimit të fjalëve

dhe shprehjeve emocionale. Që ky ligjërim të jetë bindës, duhet që të jetë përfshirës dhe bashkëveprues. (Atkinson, 1984)

Në një situatë opozite dhe pushteti, ligjërimi politik karakterizohet nga një larmi mjeteshteorike: metafora, përsëritje, antiteza, përdorim i gjerë i shkallës krahasore të sipërisë relative dhe absolute, një denduri të lartë shprehjesh dhe fjalësh ekspresive emocionale, mjete të cilat së bashku ndikojnë për të bindur dhe manipuluar publikun në kuptimin e përgjithshëm të fjalës.

Ligjërimi femëror në situata opozite në më të shumtën e rasteve është i ashpër, polemik dhe kontestues. Ky ligjërim në përmbajtje të tij ka akuza, qortime, kërkesë llogarie, vënie në dyshim vërtetësinë e fakteve të kundërshtarëve, tone të ashpra dhe akuzuese. Shprehja ndodh me nota kritike të larta, me nota qortuese e kritikuese, urdhëra të prerë dhe kategorik, nota sfiduese madje dhe paralajmëruese.

Akuzimi dhe kërkesa e llogarisë së palës tjetër politike (kundërshtarë) në një farë mënyre shpreh dhe tregon edhe distancimin e ligjërueses nga kjo palë kundërshtarë si edhe nga përgjegjësitë e veprimeve të tyre politike.

Për të minuar pushtetin e kundërshtarëve dhe shmangur qëllimisht formalitetin e tyre, shpesh herë vërejmë tone kritikuese dhe përçmuese, në të cilat shprehet nevojë dhe urgjencë madje dhe domosdoshmëri për veprime politike. Por gjithsesi përpos këtij këndvështrimi, them se nuk mungojnë rastet kur tonet e komunikimit janë të shprehura butësisht dhe në mënyrë “diplomatike” edhe pse mund të ketë në të tone ndërgjegjësu

dhe kritike ku kërkohet të synohet protagonizmi ligjërimor dhe nxitja e barazisë ligjërues – publik.

Nëse i referohemi figurës së Znj. Topalli, bazuar në analizën mbi shprehësinë emocionale të ligjërimit politik, mund të them se ligjërimi i saj si politikane ka ngarkesë të lartë ekspresiviteti. Dhe, duke qenë një mjet i shprehjes së qëndrimit personal të ligjërueses, në këtë rast të Znj. Topallit, ky ekspresivitet shërben si strategji për të ftuar që të përfshihen emocionalisht në çështjet e diskutuara gjatë fjalimeve, dëgjuesit.

Në ligjërimit politik të Znj. Topalli na ka ndodhur shpesh të kemi parë një ndërthurje të ligjërimit bisedor më atë libror madje shpesh herë edhe me ligjërimit e shkujdesur, ku nuk ka munguar spikatja e një qëndrimi polemik, akuzues dhe madje goditës. Sa i takon ligjërimit të saj, ai përbëhet nga fjalime të parapërgatitura të cilat në foltoren e Kuvendit të Shqipërisë lexohen me zë të lartë.

Në fjalimet e saj vëmë re fjali të thjeshta e të shkurtra e përgjithësisht edhe fjali të përbëra me lidhje bashkërenditjeje ku mbizotërues është përdorimi i veprores kundrejt pësores. Madje dallojmë edhe ndërtime të paplotë ndonjëherë si pasojë e një ligjërimit spontan të papërgatitur të çastit p.sh.: me mungesa të lidhëzave apo të kryefjalëve. Nëse do të ndaleshim pak dhe në aspektin leksikor them se aty gjejmë shprehje dhe fjalë të ligjërimeve të folura popullore p.sh: *për bukën e gojës; taksirat; pa hesap; gënjeshtër me bisht...etj.*

Fjalimet në cilësinë e deputetes Znj. Topalli i afrohen **ligjërimit të shkujdesur**, sepse karakterizohen nga një gjuhë e ngarkuar politike: e ngarkuar me tone të ashpra, me akuza personale, me qëndrime kundërshtuese, me një nivel të lartë të retorikës dhe me një

shpalosje të një fjalori të rëndë si shkelje e normës letrare. Shpesh gjuha është e ngarkuar me akuza personale.

Faktor jashtëgjuhësor është dhe shoqëria në të cilën ne jetojmë, një shoqëri akoma në mendësi patriarkale, ku politika dhe jo vetëm por dhe postet drejtuese në përgjithësi janë domen i meshkujve, edhe pse në mënyrë të konsiderueshme ka dhe pjesëmarrje të femrave në to. Në këtë shoqëri dhe mentalitet, femrat për të fituar politikisht epërsi dhe që të jenë të suksesshme në diskursin e tyre politik dhe publik, duhet të tregojnë e dëshmojnë agresivitet, karakter të fortë e burrëror. *“Partitë politike ende nuk e kanë shndërruar në kulturë sjelljeje barazinë dhe përfaqësimin gjinor; ende gratë shihen kandidatë jo të sigurt në një mjedis politik agresiv, ku fatkeqësisht, jo gjithnjë votohet për programet dhe vlerat e kandidatëve.* (Topi, 2011: <http://agjencia.info/2011/04/08>)

Mendoj se ja vlen gjithashtu të përmendim dhe faktin që kemi të trashëguar nga periudha e diktaturës *“mbijetesat simbolike të dhunës totalitare në gjuhë”* të cilat *“me anë të pyetje-përgjigjeve, kërkesave për “dhënie llogarie” dhe ftesave “për t’u rrëfyer” reanimojnë pareshtur modelin POLICOR⁴ të komunikimit.* (Vehbiu, 2007: 67)

Në këtë rrjedhë faktor tjetër, me ndikim në këtë agresivitet të stilit të komunikimit politik, është edhe tranzicioni që duhet të kalonte Shqipëria nga ndryshimi i regjimit. Kjo periudhë pati goxha ndikim dhe sipas profesor Lloshit *“shkalla e agresivitetit të gjuhës shoqërore e politike në Shqipëri në këto vite është e pakrahasueshme edhe me vendet e tjera, që kaluan nëpër të njëjtin tranzicion.”* (Lloshi, 2012: 239)

⁴ Janë ruajtur gërmat kapitale të autorit.

Përmbledhje kapitulli

Në këtë kapitull jam përpjekur të jap një shpjegim dhe një interpretim të ligjërimit, duke qenë se ky ligjërim prodhon realitet, realiteti politik i krijuar nga ligjërimi. Jam përpjekur gjithashtu të paraqes mendim mbi gjuhën dhe krijimin e realitetit politik duke u përqendruar tek teoria e Wittgenstein-it, duke parë rëndësinë që ai i jep gjuhës në krijimin e këtij realiteti. Kam shqyrtuar veçori të ligjërimit publik dhe politik, karakteristika të secilit prej tyre dhe tipare të këtyre dy ligjërimeve tek aktorët politikë të shoqërisë shqiptare, dhe veçanërisht jam përqendruar tek veçoritë e ligjërimit politik dhe publik të Znj. Jozefina Topalli.

Në teorinë e komunikimit njihet që diskursi prodhon realitet. Shpesh herë është realiteti ai që prodhon ligjërime të caktuara por ndërkohë edhe një ligjërim i caktuar mund të prodhojë një realitet. Komunikimi politik është një ligjërim me natyrë, objektiva dhe parametra formalë politike dhe së dyti, ai është televiziv. Në një demokraci, komunikimi politik është parë si vendimtar për ndërtimin e një shoqërie ku shteti dhe njerëzit e saj të ndjehen të lidhur. Në kuadrin e një komunikimi politik me publikun, kur flasim për ligjërim nënkuptohet që forma e këtij ligjërimit, lloji apo dhe përmbajtja janë specifike. Komunikimi politik duhet, pra, për të kryer rolin e një aktivizuesi; të mos jetë thjesht një seri “dekretesh” të shoqërisë të bëra nga një elitë në pushtet por të lejojë reagime nga shoqëria për të inkurajuar pjesëmarrjen. Gjithashtu duhet të themi se nga ky lloj komunikimi politik nuk mund të presim që njerëzve t’u komunikohen gjëra të cilat ato i dinë mbase dhe më mirë se ai që i shpreh në televizion, por duhet që ky komunikim publik të ketë një qëllim të qartë ndaj vetes, të zbulojë çështjen në një këndvështrim të ri që të mund ta bëjë interesante

përqasjen përpara publikut. Debatet e sotme politike dhe ato të filozofisë politike ndërlidhen ngushtë jo vetëm me komunikimin, por edhe me gjuhën dhe ligjërimin. Analiza e ligjërimin është një fushë e re studimi që i përket gjysmës së dytë të shekullit XX-të. Ajo përbëhet nga qasje që studiojnë mënyrat se si gjuha përdoret në tekste dhe në kontekste konkrete. Materiali gjuhësor që përdoret në ligjërim është tregues i rëndësishëm i identitetit të folësit. Gjuha politike është mjete kryesor i politikëbërjes. Ajo përdoret në varësi të interesave të caktuara politike dhe mund të jetë e qartë ose e paqartë sipas vërtetësisë së këtyre politikave. Liderët politikë në Shqipëri, pavarësisht gjinisë femër apo mashkull përdorin mekanizma gjuhësorë të veçanta duke i shtuar elementë patriarkalistë dhe agresivë debateve dhe diskutimeve të tyre. Nga pikëpamja praktike, teoria e Wittgenstein-it na shtyn t'a shikojmë politikën si një "lojë fjalësh" në të cilën aktorët e ndryshëm përpiqen të imponojnë kontekstin e tyre. Përmes manipulimit⁵ të gjuhës, politika mund të arrijë të kontrollojë apo orientojë kuptimin e konteksteve apo edhe mënyrën sesi ne i shikojmë gjërat. Në shekujt e fundit, komunikimi me një masë të gjerë njerëzish për të arritur qëllime shoqërore e politike ka ardhur duke u zgjeruar gjithnjë e më shumë. Ndaj aftësia për të komunikuar po bëhet gjithnjë e më e domosdoshme për suksesin profesional.

Shumë profesione (ndër to politikanët) e kanë suksesin e tyre në raport të drejtpërdrejtë me aftësinë e tyre për të folur para publikut. Politikanët iu drejtohen masave të njerëzve për të shprehur programet politike partiake e për t'i bindur se ata vetë dhe platformat e tyre politike janë zgjedhjet më të mira. Në shumicën e rasteve, retorika politike për çështje të

⁵ Këtu po përdoret termi "manipulim" në kuptimin e tij origjinal etimologjik: punimi i diçkaje, përdorimi, dhënia e një forme të caktuar.

caktuara degjeron në debate banale, duke treguar një mungesë të theksuar etike, profesionalizmi dhe për përgjegjësinë e përfaqësimit të qytetarëve. (Musta, 2011: 147)

Të gjithëve na bën shumë përshtypje gjuha dhe komunikimi jo vetëm në Parlament, por edhe jashtë tij, një gjuhë e cila është jo vetëm shumë agresive por dhe diskriminuese në raport me kundërshtarin. Kjo gjuhë në fakt nuk është se fyen më shumë kundërshtarin se sa indirekt fyen publikun, qytetarin shqiptar.

KAPITULLI V: ANALIZA E DUKURISË SË MASKILIZIMIT

5.1. Ligjërimi femëror në politikë

Një ndryshim i rëndësishëm shoqëror dhe më specifikisht integrimi i suksesshëm i grave në tregun e punës ndodhi në fund shek. XX-të duke sjellë kështu në mënyrë të pashmangshme rritjen e pjesëmarrjes së tyre në poste drejtuese duke ngushtuar dhe zbehur disi ndarjen patriarkale të sferave shoqërore me bazë gjinore. Por përpos kësaj arritje femrave iu desh të ndeshen me sfidën e të folurit në publik, për të cilat ky veprim ishte si një thikë me dy presa. Të folurit e tyre i natyrshëm konsiderohej i dobët, i nënshtuar dhe i pafuqishëm dhe për këtë arsye, i paaftë për të marrë pjesë në politikë, për të diskutuar tema kundërshtuese, për t'u shprehur dhe për ta bindur publikun. Prandaj, për t'u bërë më të sigurt dhe aventuriere, femrat përshtatën retorikën mashkullore. (Jamieson, 1988: 137) Kjo solli sfidën e dytë: kur femrat flisnin në mënyrë të hijshme 'zonjërishte' ato nuk merreshin seriozisht dhe u mohojë e drejta për të hyrë në pushtet me arsyen se nuk ishin të afta t'u bënin ballë presioneve politike për shkak të sjelljes së tyre gjuhësore. Nga ana tjetër, kur shfaqnin tipare tipike të stilit gjuhësor mashkullor të tilla si: ekspertizë, autoritet dhe racionalitet ato akuzoheshin si jofemërore, agresive apo të pandjeshme. (Lakoff, 1975) Kjo gjendje e ndërmjetme mes dy 'zjarresh' u etiketua si 'dilema gjuhësore'⁶, e cila është interpretuar si një manifestim i luftës mes politikanes dhe zonjës së shtëpisë, që nënkupton se femrat nuk mund të kenë karrierë të suksesshme dhe njëkohësisht të ruajnë rolin e tyre si nëna. (Jamieson, 1995: 10-11) 'Dilema gjuhësore' është një temë që mbetet e vërtetë edhe

⁶ Ang. < *double bind*.

sot për femrat të cilat ende duhet të luftojnë për t'u përballuar me këto pritshmëri kundërshtuese. (Campbell, 1989: 11)

Barbara Boxer, ish-Senatore e Shteteve të Bashkuara është shprehur se: *“Po të shprehësh fuqishëm për problemet isha e ashpër ... [dhe] rrezikoja të më vlerësonin si burrë; po të shprehja ndonjë emocion ... isha e butë.”* (Boxer, 1994: 73-74) Për të shpëtuar nga këto pritshmëri kontradiktore, sipas Campbell-it, grave u duhej që në ligjërimin e tyre të përshtasin tipare mashkullore dhe të shfaqnin identitetin femëror. (Campbell, 1989: 10)

Studimi i Daut dhe Tonit (Dow & Tonn, 1993: 79), si studimi i parë që e njohu *retorikën femërore* si të aftë për situatën politike, deklaroi se femrat ende e përdorin retorikën femërore në ligjërimin bashkëkohor, ndërkohë që strategjitë mashkullore të komunikimit janë ende më të vlerësuarat në sferën publike dhe femrat ende përballen me ‘dilemën gjuhësore’.

🚩 **“Jozefina Topalli:** Ndërpritet seanca, ai zotëria del jashtë.

(Të gjitha mediave vizive u ndërpritet sinjali. Vetëm televizioni publik TVSH vazhdon transmetimin)

Jozefina Topalli (çohet në këmbë dhe i afrohet podiumit ku ulet qeveria dhe urdhëron oficerët e Gardës ta nxjerrin Ballën me dhunë jashtë).

Nxirreni jashtë atë vagabond, urgjent tani. Mos më shikoni ashtu se do ju shkarkoj.

(Garda nuk ndërhyr)”. 23 Korrik 2008

✚ A e meriton Majlinda Bregu politikën?

A është Majlinda Bregu një politikane apo ajo është vetëm një "llafazane"? A duhet ajo të vazhdoj karrierën politike apo më mirë t'i ri-kthehet gazetarisë? A është ajo personifikim i thënies "flokët e gjata mend e shkurtra", apo e kundërta, ajo është (siç flitet) gruaja më zgjuar tek të djathtët? A është ajo më aftë se Jozefina Topalli apo vetëm më e sjellshme se ajo?

Marrë nga www.gazetakritika.net

20 dhjetor 2008

“Kjo lidhet pak a shumë me mungesën e modelit referues, në rast se modeli është ai i burrave të cilët i flasin njëri tjetrit vetëm në bazë të batutave për të gjetur se cila është shprehja që e lëndon tjetrin më fort, në rast se modeli do të vazhdojë të jetë gjuha dhe diskursi politik maskilist, ku edhe thënia e fjalës së fundit nuk është se i prek shumë, ku dhe fjalori mes burrave në politikë bëhet si i shtëpisë, gratë u duhet të përshtaten, për të krijuar jetëgjatësinë e tyre në politikë, të ndjekin këtë lloj modeli. Se sa je i aftë për t’u shkëputur dhe për të ndërtuar veten tënde, kjo pastaj është betejë më vete. Nga njëra anë të pranohesh në grupin politik ku bën pjesë, beteja tjetër është të kesh kriteret matëse politike serioze p.sh: inteligjenca, besnikëria ndaj grupit dhe partisë, është të mbyllësh gojën kur flasin të tjerët dhe të mos kundërshtosh, të gjitha këto e bëjnë më të vështirë. Gjuha politike sot nuk është e rëndomtë por është kthyer në vandalizëm, në vandalizëm politik. Gratë e kanë më të vështirë sepse po të shohim çfarë ndodh me parlamentin, me lajmet: askush nuk bën lajm për çështje dhe diskutime, lajmet bëhen vetëm për replikat, lajmet bëhen vetëm

për batutat, dhe për më tepër lajmet për gratë janë lajme kryesisht që shmangin vëmendjen ndaj thelbit dhe e përqendrojnë vëmendjen aty ku ka më shumë luftë, e shmangin aty ku nuk ka përmbajtje, dhe kjo është shmangie e qëllimshme. Dhe nuk di por besoj se ndikuesi më i madh në këtë stereotip është sërish media, sepse ato bëjnë klasifikimin se cilit mesazh do duhet ti bëjnë lajm” (Bregu, 2017)

Jo vetëm realiteti politik shqiptar, por dhe ambienti politik në përgjithësi është i përcaktuar nga një prezencë e fortë mashkullore, duke e konsideruar kështu në një farë mënyre si një profesion i burrave. Mendoj se i jemi kthyer sërish stereotipit të viteve ‘50- ‘60 kur kishte pak gra në politikë dhe ato duke qenë në një ambient tepër mashkullor dhe të egër detyroheshin të ngurtësoheshin që të mund të përballeshin me burrat. Shohim se edhe pse politika shqiptare është e “dhunshme” në të vazhdojnë të afrohen gra, të cilat aty nuk mund të jenë kurrsesi për gjëra të bukura e të buta, sepse tashmë ato kanë të bëjnë me ligje dhe vendime, sepse në duart e kësaj politike ndodhet jeta e shtetit. Të gjithë jemi të vetëdijshëm për një ambient (Parlamenti) i cili vetëm për gjëra të bukura nuk mund të jetë, sidomos kur ai tensionohet dhe kalon në fyerje siç ndodh shpesh në ambientin politik shqiptar dhe jo vetëm.

“Duhet të ketë një ekuilibër dhe kjo është etikë për çdo njeri, por politika e do forcën e debatit dhe këtë e dimë shumë mire”. (Popoci, 2010)

Të jesh grua, burrat nuk e kuptojnë dot kurrë, ndërkohë që gratë shqiptare kanë provuar të jenë meshkuj, të punojnë si mashkull, por në figurën më të keqe që mund të përfaqësojë gjininë femërore: në fabrika, si traktoriste, me parmendë në arë, ku duhej forca e krahut por jo zëri i saj. Në inkubatorët partiakë, aty ku rriten e marrin formë karrierat politike, metoda

kryesore për të kapur me dorë suksesin është “sulmo fort dhe mos i lërë kundërshtarit asnjë hapësirë”. *Skifterë në vend të pëllumbave. Ja çfarë duhet të dalin nga vezët e paçelura. Përkundër shprehjes së njohur britanike “lëri gjithmonë një shteg armikut tënd për të shpëtuar faqen”, në jetën politike që zuri fill pas vitit 1990 në Shqipëri, kultura e dhunës verbale dhe e denigrimit me çdo kusht e mjet të kundërshtarit, ka zënë rrënjë të thella që duket se nuk do të zhduken edhe për shumë kohë. (Minxhozi, 2010)*

Herë pas herë shohim pjesë të komunikimit të dhunshëm edhe nga gratë, edhe pse nuk duhet fajësuar askush që përdor një komunikim të dhunshëm qoftë grua apo burrë. Pasi kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen në një sallë parlamenti apo në një arenë nuk ka shumë dallim mes burrit dhe gruas. Jo për gjininë se sa për atë që duan të paraqesin. Prandaj duhet theksuar se nuk është një fenomen që ndodh vetëm tek meshkujt. Mungesa e etikës nuk është një fenomen që ndodh vetëm nga meshkujt dhe nuk është një fenomen që ndodh vetëm tek shqiptarët. (Popoci, 2010)

Nga sa u përmend më lart, jo vetëm unë besoj por në përgjithësi të gjithë, nuk do të pranojnë kurrë një femër që sillet dhe vepron tërësisht si një mashkull, si një politikan burrëror por mendoj se do të ndiheshim më rehat kur të shihnim se si gruaja politikane dhe jo gruaja maskiliste zbuste tensionet partiake apo situatat konfuze të politikës.

Sipas këtij parimi, do të ishte më e pranueshme një grua që shërben si rregullator i qëndrueshëm i politikës dhe jo vetëm aq, por që menaxhon maskilizmin ekstrem të meshkujve (më tepër për ta balancuar atë), sesa një grua që kërkon të ekzistojë ndjenjat burrërore te vetvetja. (Konomi, 2010)

Kur pavarësisht zërit të butë që shqiptojnë, fjalët kanë qenë të rënda. Ky është një realitet që i bën ato aksionere në faj, por pa qenë pronare të fajit. Në vend që të “zbusnin” politikën, ato u detyruan të egërsohen. Për shkak të një klime politike e cila nuk ka qenë kurrë e qetë, të një kulture politike tradicionale dhe qëndrime tradicionaliste maskiliste që vjen që nga e shkuara. (Vangjeli, 2010)

Njerëzit janë të përfshirë në procesin e komunikimit në dy role: si burim dhe si marrës i mesazhit, por këto individë nuk mund t'i kryejnë këto dy rolet në mënyrë të pavarur. Gjithashtu theksojmë se njerëzit nuk i përgjigjen në formë unike të gjithë mesazheve pasi jo gjithmonë e marrin të njëjtin mesazh në rrugë të njëjta. (Pearson; Nelson; Titsworth, 2008: 12)

Kultura politike është një nga temat më kontradiktore në teorinë e shkencave politike. Me gjithë teorinë, analizat dhe diskutimet, prapë kultura politike mbeti një fushë e minuar për çdo studiues të shkencave politike e sociale në përgjithësi. Çdo pyetje teorike merr përgjigje më mirë kur testohet në terren. Zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit na ofrojnë material shumë të pasur, ku mund të lëvrohet kultura politike. Në të njëjtën kohë, ky rast na jep mundësinë të përdorim mjetet që na jep shkenca për të kuptuar më mirë vetveten. Pyetja se, a duhet të ndahet kultura në politike dhe jo politike, në kontekstin shqiptar të 28 qershorit, merr përgjigjen "jo". (Shqip, 2009)

Nuk mund ta ndash kulturën në politike ose jo, sepse në këtë vend çdo gjë është politike. Njerëzit dëgjojnë me orë të tëra programe politike, por kjo është vetëm maja e ajsbergut dhe pjesa më e mirë e gjithë kësaj.

“Ka një term, një term i cili është përdorur në fakt në ushtri në Angli, ka qenë përdorur për ushtrinë amerikane i cili quhet MAD [Mutual assured destruction], që do të thotë që është një shkatërrim, pra gjuha politike nuk shkatërron vetëm atë ndaj të cilit drejtohet, por shkatërron sigurisht dhe atë që e përdor. Pra të dyja palët, nuk di se cili prej tyre nëse do t’i vinim në një peshore do ta vuante më shumë, por te dyja palët dëmtohen. Zakonisht kjo është gjuha dhe modeli ynë politik i cili mund të ketë elementë shqiptarë dhe ballkanas por zakonisht kombinohet me hipokrizinë e një pjese të figurave politike, të cilët qëndrimin e tyre politik e ushqejnë me motive të dyshimta dhe kjo e largon ndjeshmërinë dhe bën të ndjehet e mangët ndjeshmëria për pozicionin e politikës. Kështu që unë besoj që nëse ka një mënyrë të sigurtë për të shkarë në këtë fazë që ne jemi sot ose që ka ndihmuar për të shkarë në fazën e mosbesimit dhe të apatisë ku jemi sot, në këtë fazë ku nuk ka përplasje të vërteta idesh politike, ku ka një indiferencë dhe mosbesim tek politika për frymën që i kanë kursyer gjithë shoqërisë, besoj që rolin kryesor e ka polarizimi politik dhe akuzat e shqiptarëve që kanë mbyllur institucionet dhe individët në një konfuzion të madh. Ndaj nëse ka një element i cili të bën të shkasësh në një mënyrë më të shpejtë drejt fundit dhe mosbesimit total te politika, është pikërisht ky vandalizëm dhe ky polarizim i politikës, është e vetmja mënyrë e sigurtë për të rrënuar besimin tek njëri tjetri, dhe duke rrënuar besimin tek njëri tjetri, rrënojmë dhe besimin tek institucionet”. (Bregu, 2017)

Kur llogarisim përqindjet e pjesëmarrjes së femrës në politikë, a duhet marrë parasysh edhe përqindjen e maskilizimit të saj? Sepse profili mbizotërues i politikanës shqiptare nuk po mundet dot të mposhtë tiparet burrërore: sjellje dhe komunikim i ashpër profil ky i parë dhe në debate të ndryshme mediatike të të dy seksëve (për të mos folur për sjelljet e tyre në

sallën e Parlamentit), në shumicën e rasteve edhe pamje të pakujdesura që të largojnë idealin femëror.

Politika, gjuha dhe mendimi shpesh kanë qenë tema kryesore të veprave të Orwellit. T'i rrih politikës larg nuk është e mundur. Të gjitha çështjet janë të lidhura me politikën e politika vetë është një dredhi, një mal me gënjeshtër, marrëzi, urrejtje. Kur atmosfera e përgjithshme gjeneron, gjuha vuan. Korrupsioni i një gjuhe sipas Orwellit lind nga shkaqe politike e ekonomike.

Situata politike, përse i përket komunikimit, në vend është pothuajse në një lloj tensioni, gjatë gjithë kohës dhe për më tepër në kohë zgjedhjesh qofshin këto parlamentare apo lokale. Terma shumë të fortë e fjalë të ashpra. Nuk është se humbet vetëm politika, se kjo nuk do të ishte ndonjë problem i madh, puna është serioze, sepse rrezikojmë të humbasim ne si qytetarë.

Ky është një konkluzion i bazuar në bindje të forta nëse do t'i referohemi komunikimit të grave në politikë. Të detyruara që t'i binden urdhrave të shefave (kryetarëve të partive), dhe gratë politikane kanë ndryshuar mënyrën e komunikimit në publik. Ato nuk i karakterizon më brishtësia, apo përdorimi i tonalitetit të butë, për të amortizuar sado pak konfliktualitetin, por ato janë shndërruar në "kamikaze" politike.

Tani, në Kuvendin e Shqipërisë apo në sallat e konferencave të shtypit, frazat e forta, akuzat më të rënda dhe fjalorin më të ashpër, zakonisht e përdorin gratë e politikës. Sidomos kur flasin kundër njëra-tjetrës. Gratë nuk mundën të realizojnë "zbutjen" e

politikës. Gratë vihen përballë njëra-tjetrës dhe akuzat apo kundërshtitë ndaj një gruaje të njërit kamp politik, zakonisht artikulojnë nga gratë e kampit tjetër politik.

Çiftet ndërmjet përfaqësueseve të PD-PS të tilla si Topalli-Ligori, Përnaska-Felaj, Doda-Shkreli, Vokshi-Xhaçka, Bregu-Kodheli, e të tjerë, janë shndërruar shpesh në skaje të një debati të fortë dhe të ashpër. Debate në të cilat nuk kanë munguar as fyerjet dhe as fyerjet e nisura mbi përkatësinë gjinore, qoftë dhe atëherë kur fjalitë e tyre ndaj kundërshtareve nisnin me fjalët: "...si grua dhe si nënë...". (*Vangjeli, 2010*)

Të gjithë kemi parë zonja të nderuara të flasin me tone aspak të përshtatshme dhe të akuzojnë rivalët politikë edhe për jetën private. Të gjithë jemi të bindur se ato që artikulojnë publikisht nuk janë mendimi apo qëndrimi i tyre i vërtetë, por një detyrë që u jepet nga kryetarët përkatës, që të hedhin baltë mbi kundërshtarin. E pse jo, për të fituar kohën televizive dhe faqet e gazetave.

Në këtë aspekt dhe media ka luajtur një rol në ndryshimin e komunikimit, pasi partitë politike kanë prioritet përballjen e problematikave dhe konfliktit në media.

Ajo çka dhemb (edhe pse prej kohësh duket kaq e zakonshme, sa që e kundërta do të na habiste), është që elitat femërore në vendin tonë nuk arrijnë të bëjnë diferencën. Kështu, jo vetëm për çështje politike, por as për një "luftë" personale parimore, një herë të vetme nuk u dëgjua një deputete të kundërshtojë liderin e partisë së saj. As kur përdor fjalor fyes, as në emër të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve (check and balance) dhe as në emër të etikës (ajo femër ka një familje sikur ju); përkundrazi, i sulen me të njëjtën urrejtje, madje me të njëjtin fjalor (për t`i përkëdhelur sa më shumë sedrën "shefit").

Është zgjedhja jonë dhe ne nuk duhet të justifikojmë vetëm në atë që ne kështu jemi, sepse sjellja e urrejtjes për njëri tjetrin e ka dhënë tashmë rezultatin. Nuk justifikohemi dot me faktin që ne jemi prezantuar vonë me sistemin demokratik edhe na duhet kohë për të kuptuar se si funksionojnë garancitë, na duhet kohë për të kuptuar se sa vlerë ka kompromisi e të tjera me radhë. Pra është një zgjedhje të cilën e kemi bërë vetë, dhe që i ka sjellë dhe i ka siguruar politikës atë dëm i cili prej shumë vitesh mund të mos ishte kaq i garantuar.

5.1.1. Fjalimet e gatshme

Shumëkujt Kuvendi i sotëm i ngjan vulgar, fjalëndyrë, sherrxhi, pa ide, pa debat, pa demokraci, një gjenerator i pashtershëm shpif-shpifjesh të ndërsjella, një vend që ata e trajtojnë si një sallë ku nuk mbahet asnjë përgjegjësi para publikut. (Blushi, 2011) Sipas Aristotelit, një fjalim s'mjafton të përmbajë argumente bindës. Edhe folësi duhet të duket i besueshëm. Shumë mbresa të audiencës krijohen para se të fillojë të flasë folësi. Siç këshillonte para më shumë se një shekulli poeti Ralph Waldo Emerson: “*Përdor ç’ gjuhë të duash*, s’mund të thuash kurrë më tepër përveç asaj që je.” (Dhima, 2013)

Me sa duket sot, *politikë* do të mund të quhet sherri dhe sulmi sipas parimit stalinist: “sulmi është arma më e mirë dhe më e sigurt për fitoren”. Fjalimet e porositura janë një tjetër “njollë e zezë” e komunikimit të ashpër të grave në politikë. Shpesh herë kemi parë deputete gra, të cilat lexojnë fjalime që as vetë nuk i kuptojnë, e jo më publiku. Foltorja e Kuvendit është shndërruar si foltore e partive politike. Ashtu si meshkujt dhe deputetet gra vetëm “nxjerrin vrer” në fjalimet e tyre.

Kjo për faktin se ato (fjalimet) janë të porositura dhe të shkruara nga konsulentë mediatik. Rast konkret mund të merren akuzat e deputeteve të Partisë Socialiste, të cilët gjatë vitit të shkuar kanë zhvilluar një fushatë “anti-korrupsion”, të cilën e bazuan vetëm në akuza mediatike.

Denoncim pa kufij, por vetëm në media dhe me gjuhë akuzuese. Pala tjetër, Partia Demokratike, i është përgjigjur me të njëjtën taktikë, duke përballur akuzat me kundërakuza, po me zërin e gruas. Përfundimi: “dhimbje koke” për të gjithë.

5.2. Jozefina Topalli, gruaja politike dhe mënyra e saj e komunikimit

Prania e Znj. Jozefina Topalli, në një arenë politike ku dominonte gjinia mashkullore, i dha një dimension tjetër politikës shqiptare. Znj. Topalli përfaqëson gruan e cila ka arritur një shkallë të lartë të karrierës politike në vend, me dy mandate në Kreun e Kuvendit, duke mbartur një tërësi tiparesh, ideologjish dhe një model të caktuar komunikimi, të pahasur më parë. *“Ditët e zeza që kaluan demokratët pas vitit 1997 sollën me shpejtësi nevojën për një profil pikërisht si ajo: seksi-femër, qyteti-Shkodër, përkatësia fetare-katolike, origjina familjare-e persekutuar politike dhe derë e madhe. Sekush nga përbindëshat e komunikimit politik një personazh me profil të tillë, edhe sikur mos të ekzistonte, do ta kishte shpikur”* (Çili, Panorama 2007). Si jo pak të tjerë, edhe unë e kam pasur gabim kur kam gjykuar dhe dyshuar se zonja Topalli shpesh, në mënyrë të pavetëdijshme, të pakuptueshme dhe të panevojshme, madje edhe të pamençur, kalëron e keqëron në politikë, teksa si femër nuk transmeton rolin e një gruaje të butë, të një politikaneje të urtë, të “oponentes së opozitës”, siç pat premtuar, të një Kryetareje Kuvendi që me urtësi e mirësi arrin të ngjizë në

Kuvendin mashkullëronjës mirëkuptim, paqe e mirëbesim, të zbutë pra gjakrat, si një “nënë Terezë” e rezil-politikës. (Blushi, Gazeta Shqiptare, 2008)

Znj. Topalli, kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë në media shpesh është cilësuar me emërtime nga më të ndryshmet, mbiemra e krahasime të cuditshme të tipit si: *amazona e politikës shqiptare* (Londo, “Shekulli”, 2005) *agresivja Topalli* (Martini, “Zëri Popullit”, 2003), *31 vjeçarja e heshtur dhe imcake* (Hasani, “Klan”, 2005) [referuar kohës kur hyri në politikë], *politikania e bukur* (Basha, “Koha Jonë”, 1998), *“Lady P”* (Hasani, “Klan”, 2005), *e gjithëpranishmja* (Çili, “Panorama”, 2007), *deputetja e re shkodrane, simpatike dhe energjike, Djalli që vesh Prada* (Harasani, “Panorama”, 2008), *vanitozja* (Myftaraj, “Sot”, 2006), *risia e politikës shqiptare* (Blushi, “Gazeta Shqiptare”, 2008), *Locja e politikës* (Shella, “Shqiptare”, 2008), *ikona e PD-së dhe pëllumbesha që u kthye në skiftore* (Myftaraj, “Sot”, 2006), *emri më i rëndësishëm femëror i politikës, idhnakja dhe mendjemadhja, e pushtetshmja, e hijshmja dhe bindësja* (Baçe, “Panorama”, 2008), *Lady J, “Nexhmija” e qytetit më të madh verior* (Bakalli, “Shekulli”, 2009), *“zonja e hekurt”* (Blushi, “Gaz. Shqiptare”, 2008) apo *zboristja e bindur* (Martini, “Zëri Popullit”, 2003), *ikona e PD-së dhe pëllumbesha që u kthye në skiftore* (Myftaraj, “Sot”, 2006)

Duket qartë se puna dhe lufta e ashpër në krye të Kuvendit burrëror të Shqipërisë e ka bërë “më të vendosur kundër vandalizmit, banalitetit, fjalëve e gjesteve të urrejtjes. Jo se jam “e hekurt”, jo” (nga fjala e Kryetares Topalli në seancën e votimit të kërkesës për shkarkim të Kryetares së Kuvendit, 13 nëntor 2006). “Informacioni që më ka dhënë karrigia që kam, më thotë se rruga që kemi marrë, është e vështirë, por e vetmja e mundshme”. Nga vëzhgimi dhe komentet, duket se në institucionin e ligjeve, shpesh kryetarja “bën ligjin”. E përfolur

për gjuhën e përdorur në Parlamentin e Shqipërisë, një dialekt i theksuar verior dhe shpesh e egër dhe me nota nervoziteti, mbahet mend ky reagim i saj në sallën e Kuvendit, në datë 22 korrik 2008:

Në të kundërt kemi parë më se njëherë që ajo luan rolin e një femre - burrë, shpesh të egër, kokëfortë, intolerante. Si është e mundur, pyesin edhe burrat e Kuvendit, të cilët ajo i merr “për zhelesh”, sa herë i jepet mundësia!

Topalli: *Ulu z.Balla, ulu! Në fakt, ky e meriton me e kap për zhelesh e jashtë! Nxirreni jashtë atë zotërinë, nxirreni jashtë! Zotëri, kape jashtë e nxirre. Vagabond! Ik andej! Ik! Del jashtë! Edhe nuk hyn ma”* (arkiv “Top Channel”).

Znj. Topalli u diskutua gjatë nga opinioni publik për humbjen e kontrollit në këtë rast. Mbahet mend edhe për shpërthimin e befasishëm në 2005, disa ditë para zgjedhjeve, në një deklaratë që ajo bëri në TV Klan, tri ditë para zgjedhjeve parlamentare të 3 korrikut 2005, kur ndërsa po debatonte për ngjarjet e 1997 me një ton të egër, i tha përfaqësuesit të PS:

“Berisha duhet t’u kishte dhënë ju plumbin ballit në 1997-n”. (Myftaraj, 2006: 16-17)

Vitet e fundit është vënë re një egërsim i pajustificuar i zonjës Topalli, egërsi që nuk shkon paralel me qënien femërore dhe aq më pak me origjinën e saj qytetare dhe katolike. Tashmë është e qartë se Topalli ka meritën që kuvendi të jetë transformuar, sidomos vitet e fundit, në një shesh vulgar sharjesh e sherresh, dhune e intolerance, shpërfilljesh e poshtërimesh arrogante ndaj pakicës. (Blushi, 2008)

Zonja Topalli politikisht ka ditur të imponohet më mirë nga të gjithë, duke kundërvepruar përherë fort dhe ashpër, natyrisht jo rastësisht, por qëllimisht, gjë që duke përjashtuar anën

e jashtme të saj, madje edhe fjalorin e saj flakëdhës, vulgar e nëndialektor (me sa duket, në politikën mashkullore dhe militare shqiptare kjo paska rëndësi parësore!), ajo ka mundur, me një këmbëngulje të admirueshme e me synime të qarta t'i japë vetes që tani një perspektivë të sigurt e të padiskutueshme për nesër. (Blushi, "Gazeta Shqiptare" 2008)

Në lidhje me deklaratat e ngjarjet e mësipërme, por edhe fakte të tjera, na lind një diskutim. Përsa i përket çështjeve të barazisë gjinore, sipas Najsbet (Nisbet, 2002: 88-89) në librin e tij "*Konservatorizmi, ëndrra dhe realiteti*", të nderosh dhe të respektosh gruan dhe rolin e saj si nënë, bashkëshorte, bijë është një gjë, por është diçka papranueshmërisht e ndryshme të shohësh një grua që liberalizmi bashkëkohor t'a ketë ndarë nga rolet e veta historike. Një pozicion shumë i ngjashëm u mbajt përgjithësisht në fe, arsim, pa harruar vetë qytetarinë politike, ku konservatorët iu kundërvunë për një kohë të gjatë të drejtave të votimit (por dhe ato ekonomike) për gratë, me motivimin se prania e tyre në veprimtaritë elektorale menjëherë do t'i ç'feminizonte ato dhe do të feminizonte rolet dhe problemet e politikës. Nëse do të marrim parasysh "egërsimin" dhe shndërrimin e reflektuar në shembujt e mësipërm në lidhje me zonjën Topalli, mund të argumentojmë se vërtet prania e saj në veprimtarinë politike duke mos mundur të feminizojë rolin e saj në një politikë tejet maskiliste si ajo shqiptare, në luftën për mbijetesë politike, mund të ketë "ç'feminizuar" vetë atë. Gazetari Sokol Balla e përshkruan profilin e saj, si të së vetmes zonjë në krye të një pushteti në Shqipëri, por misioni i saj për *gender equality* (barazinë gjinore) është realizuar pjesërisht. "*Sot zonja Topalli është e barazvlefshme me një burrë në krye të Kuvendit, por për të arritur aty, i është dashur të heqë dorë nga gjinia e saj*".

Topalli, ashtu sikurse edhe gratë e tjera të politikës, e di se vështirë të kesh të ardhme nëse do të sillesh në politikë ndryshe: si një “shtëpiake” kokëulur, si një grua e mirë, e urtë e zemërbutë, por ato duhet të krijojnë një shëmbëlltysë të meshkujve femër në parti / politikë. Pasi vetëm një shëmbëlltysë e tillë mund të japë garanci vazhdimësie dhe sigurie për militantët apo dhe këdo tjetër që nesër do të duhet të pranohet si një trashëgimtare e denjë.

Një tjetër opinion, kësaj radhe femëror, në një shkrim të vitit 2006, e ka justifikuar ndryshimin e saj për shkak të sfidës tejte të vështirë që duhet të përballojë: *“Kompleksimi për të qenë vigjilente dhe në gjumë, të shndërron në mbrojtëse që bën gol në portën tënde. Turpi dhe inati që zgjojnë te një grua fyerjet e burrave, e vrasin të bukurën dhe zgjojnë bishën. Një grua e lënduar, është një grua më pak, një shtrigë më shumë”*, thotë Rudina Xhunga në një shkrim të saj për Jozefina Topallin në kohën e mocionit të dytë të mosbesimit për Kryetaren e Kuvendit. (Xhunga, 2006)

Përsa i përket vrazhdësisë dhe ashpërsisë së fjalorit të saj ka mendime justifikuese se vrazhdësia është absolutisht një sjellje e pashmangshme në sallën e Kuvendit të Shqipërisë, ku rregullat, shpesh nuk respektohen nga disa deputete, që kanë shndërruar fyerjet dhe sharjet në stil pune. E megjithatë, kjo nuk justifikon gjestet apo fjalët e vrazhda të përdorura nga e vetmja femër me profil të lartë dhe të vertetë në skenën politike. Nuk është vlerë për të kjo sjellje që ajo e bën shumë herë, madje dhe pa arsye. Ngjante në nisje një grua e prekur nga fjalori i ashpër i burrave të politikës shqiptare. Tani duket se është një zë i ngjashëm mes tyre, madje provokon që zërat e tyre të jenë më të ashpër. Në këtë pikë është tërhequr edhe vëmendja e Brukselit për zonjën Topalli, si spikere e Kuvendit. Vrazhdësia dhe mungesa e saj e etikës në seanca pranohet nga vetë drejtuesit e PD si anë

negative. Përveç përmbajtjes së vrazhdë, është dhe dialekti i theksuar, që ia vështirëson shumë komunikimin. Mendoj se deri diku përdor një fjalor të ashpër pasi është forma e duhur për të vendosur autoritetin në rrethin me të cilin punon dhe ndërvepron çdo ditë.

Por për të vënë pak pudër në portretin e saj femëroro-mashkullor, pra në shëmbëlltyrën e saj të një burri-femër, theksojmë se zonjën Topalli e shikon anekënd vendit dhe botës, si politikane të klasit ndërkombëtar, si femër me sqimë, të përkushtuar, dinjitoze, të vendosur, përherë elegante, me një fjalë modeli më i përsosur i suksesit dhe i politikës së sotme! Krejt tjetër nga ç'e shohim në seancat e Kuvendit!

Kjo është kultura jonë politike, kemi një kulturë politike shumë të kufizuar dhe kemi pak vite në të cilët ne jemi duke bërë një ecje në tranzicionin apo në arritjen e gjërave tona në politikë. Kështu që është normale.

5.3 Media dhe roli i saj në fuqizimin politik të gruas

Marrëdhëniet publike përbëjnë aktualisht një aspekt shumë të rëndësishëm të punës së përditshme të qeverisë, partive politike dhe organizatave të ndryshme në vend. Por, në fushata zgjedhore marrëdhëniet publike përbëjnë motorin lëvizës dhe strukturimin e strategjive të komunikimit të cilat janë më primare për një politikan në fushatë elektorale. Dhe ajo çfarë ndodh është që në gjithë këtë “luftë” transmetimi për të dalë sa më mirë, media luan një rol kryesor në krijimin e një politikani që shpesh është ndryshe nga ai i vërteti, pra është ai që vetë politikani do të jetë dhe ajo figurë që votuesit duan të kenë, ndonjëherë një imazh gënjeshtar dhe zhgënjes. Puna e një media është vërtetë e një rëndësie të vecantë kur kemi të bëjmë me një fushatë elektorale

5.3.1. Media, gjatë një fushate elektorale

Gjatë fushatave zgjedhore, në fjalimet e mbajtura politike, idetë dhe ideologjitë në mënyrë që të kenë përkrahjen dhe miratimin e dëgjuesve të pranishmë gjatë fjalimeve apo dhe nga të tjerë që mund ta dëgjojnë apo lexojnë këtë fjalim në media televizive apo dhe print, kanë nevojë që të përcillen tek publiku përmes gjuhës.

Pasi është gjuha e përdorur e këtyre fjalimeve ajo e cila ndikon në mënyra të ndryshme mbi kuptimin, ajo përveçse përcjell të dhëna objektive luan dhe shume funksione. Nëse i referohemi Birdit: *“Një fjalim politik nuk është patjetër i suksesshëm për shkak të saktësisë apo së vërtetës, por më tepër mund të jetë një çështje e paraqitjes së argumenteve si të vlefshme”* (Beard, 2000: 18), shohim se një fjalim politik, duke i shtuar mjete retorike, mund të ketë rëndësi për rezultatin e zgjedhjeve. Një komunikim i efektshëm i mesazhit

politik ka sukses nëse ajo jo vetëm që kuptohet por edhe interpretohet në mënyrë pozitive nga dëgjuesit.

Sepse është gjuha ajo e cila mbart potencialin për të ndikuar në opinionin publik si edhe për ta angazhuar atë në bashkëveprim me një person tjetër (Schiffrin, 1994: 415), duke ndërtuar një raport dhe angazhim ndërpersonal dhe duke krijuar një imazh të besueshëm të bazuar në kompetencë dhe besueshmëri. (Tannen, 1989)

Dinamika mbi barazinë gjinore në debatet e ndryshme e të shumta televizive ka qënë e pamundur të injorohet. Kjo sepse këto debate politike kanë ndikuar në “zmadhimin” e probleme gjinore. Në pjesën më të madhe të botës gratë ndërpriten dhe vlerësohen cilësitë “mashkullore” të forcës dhe agresionit. Programet politike të mediave gjithkund shfaqin burra që flasin me burrat për burrat.

Sipas projektit *Global Monitoring Media 2015* (<http://cdn.agilitycms.com>), gratë janë në qendër të vetëm 10 për qind të lajmeve, përbëjnë vetëm 20 për qind të ekspertëve apo zëdhënësve të intervistuar, dhe vetëm 4 për qind e lajmeve konsiderohen se sfidojnë stereotipet gjinore.

Për atë që ndodh jashtë “ekranit” ka rëndësi ajo që ne shohim në ekranet televizive. Kur politika nga mediat portretizohet si lojë e njeriut, nuk bën habi fakti që progresi drejt pjesëmarrjes së barabartë të grave në politikë është i ngadalshëm.

Praktika e debateve, dhe e tregimit të tregimeve dhe që pasqyrojnë një sferë politike të mbizotëruar nga meshkujt, është thellësisht e rrënjosur dhe jashtëzakonisht delikate. Marrja dhe vënia e grave para kamerës është vetëm gjysma e betejës. Ajo që ne kemi nevojë është ndryshimi thelbësor i mënyrës së ndërveprimit dhe gjuhës që përdorim.

Sipas një raporti të ri për BBC *Media Action* (<http://downloads.bbc.co.uk>), i cili hulumton se si mediat mund të ndihmojnë, në vend që të përkeqësojnë, pabarazitë gjinore në politikë. Gjërat kryesore, sipas këtij *Raporti*, që mund të bëjë media është:

- Të japë role model
- Vendosja e gjinisë në axhendën e secilit
- Nxitja e përfshirjes duke i prishur normat.

Mediat duhet të trajtojnë çështjet gjinore jashtë sferës private dhe të mundohen t'i vënë ato në axhendën politike. Media është ajo që duhet të mbulojë të gjitha temat në një mënyrë që të kemi një përfaqësim të barabartë, pra të përfaqësojë si burrat ashtu edhe jetën dhe përvojat e grave. Pra duhet të krijojnë një hapësirë të re më gjithëpërfshirëse, sesa të krijojnë një politikë elitare.

Debati politik në media shpesh dërgon apo nënkupton një mesazh të fortë për gratë: “*kjo nuk është për ju*”. Mediat janë të fuqishme dhe ato mund të arrijnë miliona njerëz, mund të sfidojnë rolet e ngushta gjinore dhe të fuqizojnë burrat dhe gratë. Por megjithatë, bërja e programeve që transformojnë mënyrën se si duhet të shikohen si burrat dhe gratë është komplekse. Prania e një gruaje në garë, prania e saj në një debat politik qoftë dhe publik nuk e transformon debatin por mund të tregojnë një përparim të madh. Psh: debatet presidenciale në SHBA e pasqyrojnë më së mirë këtë tregues. Politika gjithnjë e më shumë po vjen duke u mediatizuar.

Roli politik i mediave moderne dhe ndikimi që ato kanë në opinionin publik është bërë një temë së cilës i janë dhënë ngjyra të ndryshme. Për disa arsye të dukshme, roli i televizionit ka qenë edhe ai i cili ka krijuar debatet më të shumta. TV ka shtrirjen më të gjerë dhe

besohet se për këtë ka edhe ndikimin më të gjerë. Massmedia, pra në vecanti televizioni, ka luajtur një rol kyç në theksimin që iu ka bërë lidhsipit dhe karakteristikave personale. Nuk ka asnjë dyshim se në fakt televizioni inkurajon personalizimin e politikës duke i sjellë zërin dhe fytyrat e kandidatëve në shtëpinë e qytetarëve në mënyrë të rregullt. Duke iu referuar librit të Altheide dhe Snow (Altheide & Snow, 1979: 106) ndërmjet skemave dominuese me të cilat massmedia profilizon realitetin politik ai i personalizimit është edhe më i shfaquri. Shpjegimi më i lehtë për këtë është fakti se media ka një mundësi të kufizuar të transmetimit të një pamjeje të plotë dhe të kompletuar të botës së politikës kështu që ato iu japin përparësi atyre aspekteve të politikës që mund të transformohen lehtësisht në materiale të mirë mediatic: që do të thotë, ato produkte që janë mjaftueshëm spektakolare për të tërhequr një numër të madh audience (Butler & Ranney, 1992: 42). Kjo lloj sjelljeje e ka bërë massmedian që ta raportojë politikën si një lojë apo sic paraqitet shpesh si një garë kuajsh. “Në lojën gazetareske fokusi në fakt përqëndrohet vetëm tek disa individë; politikanët, më tepër sesa tek interesi më i gjerë që ata përfaqësojnë dhe sesa forcat e gjera politike që i japin formë edhe veprimeve të tyre politike”. (Patterson, 2000: 106)

Partitë apo kandidatët që marrin pjesë në garë elektorale, e konsiderojnë televizionin si mjetin e tyre më të preferuar për të bërë fushatë. Ato e organizojnë fushatën e tyre në mënyrë të atillë që të mund të dalin sa më shumë në televizion. Kështu ato shfrytëzojnë rastet për t’u fotografuar, për të shëtitur, për të dhënë konferenca shtypi, për të organizuar mitingje elektorale.

Politikanët përdorin gjithnjë e më shumë tinguj zanorë që janë të përshtatshëm për edicionet e lajmeve të mbrëmjes dhe i kushtojnë gjithnjë e më shumë kohë dhe burime

financiare analizave për audiencat, teknikave të marketingut, paraqitjes dhe trainimit televiziv. Këto dy zhvillime – rritja e numrit të kanaleve dhe rritja e profesionalizmit me të cilën partitë dhe kandidatët organizojnë dhe kontrollojnë fushatat e tyre – po ndryshojnë sot mënyrën e mbulimit të fushatave në televizion.

5.3.2. Media dhe politikanët

Në demokracitë bashkëkohore pozicioni i drejtuesve të politikës nuk mund të shpjegohet pa iu referuar stilit të tyre të komunikimit dhe strategjive të tyre mediatike. Në artikullin e tyre, Macoleni dhe Shulci tregonin se një nga aspektet kyce të mediatizimit të politikës është që aktorët politikë janë treguar të aftë *“të përshtrasin sjelljen e tyre sipas kërkesave të medias”*, çka do të thotë se *“ata performojnë një ngjarje në mënyrë që të fitojnë vëmendjen e medias, ose nëse ata vendosin të bëjnë një ngjarje e bëjnë në mënyrë të tillë që të përmbushë kërkesat mediatike për sa i përket kohës, vendit, mënyrës se si e japin mesazhin dhe performancën”* (Mazzoleni & Schulz, 1999: 247–61). Duket se politikanët kanë gjetur një vegël të mirë për figurën e tyre politike dhe duket se media, në kohë fushatash nuk bën asgjë tjetër përveçse përsos figurën e tyre. Krijimi i mediave solli edhe krijimin e mundësive që politikanët në rastin konkret të gjejnë një hapësirë të mirë për të “marketuar” veten e tyre. Në kohë fushatash kjo kthehet pothuajse në një domosdoshmëri. Media ka gjithcka që atyre iu duhet, ka mjetet për t’i bërë ata të pëlqyer nga publiku dhe për të transmetuar idetë që ata duan të japin (McLuhan, 2004: 184).

Në mes të instrumenteve që mund të favorizojnë dhe mund të bëjnë të suksesshëm një lider politik patjetër që massmedia do të dalë si një faktor kryesor dhe si një faktor i cili për nga rëndësia mund të krahasohet me partinë apo lëvizjet politike. Në të vërtetë ekziston një

opinion i përbashkët se ndërkohë që partitë mund të humbin fuqinë e tyre për të mbledhur dhe mbajtur mbështetjen e publikut, televizioni ka bërë që të dominohet procesi i mobilizimit të votuesve duke iu dhënë liderave politikë mundësinë për të vendosur një lidhje të drejtpërdrejtë me votuesit apo ndjekësit e tyre. Në këtë mënyrë liderat bashkëkohore iu janë përshtatur ndryshimeve në mjedisin politik dhe kanë filluar që ta drejtojnë mesazhin e tyre dhe stilin e këtij mesazhi që të jetë i përshtatshëm me formatin televiziv. Me televizionin ka filluar koha për një lloj *leadershipi*, i cili me fjalë të tjera mund të quhet “i mediatizuar” (Fuga, 2004: 141).

Qëllimi i parë i një lideri politik që aspiron është që ta formojë dhe ta shesë imazhin e tij nëpërmjet televizionit. Në mënyrë të veçantë televizioni është aleati më i mirë i një lideri potencial përderisa ai e lejon një aktor të politikës të shikohet dhe të dëgjohet nga një numër qytetarësh edhe pse ata nuk janë fizikisht prezent. Këto imazhe të kuruara nga media dhe që iu shfaqen votuesve, bëhen në fakt simbole të fuqishme që “identifikojnë apo përcaktojnë një kandidat”.

5.3.3 Efekti media

Edhe në Shqipëri, përkundër përmirësimit ndër vite, ende ka shqetësime përse i përket prezantimit të grave dhe rolit të tyre në media, por sidomos dhe hapësirës që atyre ju kushtohet.

Media luan një rol të rëndësishëm në çdo shoqëri dhe në këtë kuadër, Shqipëria nuk mund të bëjë përjashtim. Pas viti 1990, media (e shkruar apo televizive) fitoi lirinë e për pasojë pavarësinë e saj. Tashmë ajo kishte mundësinë të ushtronte funksionin e saj kryesor: atë të informimit të publikut. Por pas kaq vitesh (25 vite) shtyp të lirë lind pyetja: A e luan media

rolin e saj si një hapësirë ku shoqëria shkëmben mendimet apo qëndrimet e saj në lidhje me problemet që e shqetësojnë?

Media dhe shtypi i shkruar në demokraci luajnë një rol të rëndësishëm pasi ajo ka një impakt të madh tek opinioni publik pasi është pasqyra e problemeve të qeverisë dhe sistemit politik.

Gjinia duhet të trajtohet si një efekt i komunikimit dhe jo si shkak i tij pasi komunikimi krijon gjininë dhe më pas kjo krijon komunikimin, dhe pse media njihet dhe është e vetëdijshme për paragjykimet në portretizimin e gruas.

Ashtu sikurse e dimë të gjitha gazetat e përditshme kanë të njëjtin format. Kanë të përcaktuara kategoritë e tyre me shpresën se kështu do të japin sa më gjerësisht realitetin. Por zor se e arrijnë këtë. Politikja padyshim mbizotëron dhe madje është prezente edhe kur supozohet se tema ka të bëjë me socialen apo kulturën. Fatkeqësisht, ndonëse nuk thuhet, gjithsesi lë të kuptohet se fakti nëse je prezent në media apo jo, tregon në një farë mënyre nëse je i rëndësishëm apo jo. Dhe ajo që është më e keqja, mund të arrish të bindësh audiencën se pikërisht ato që dëgjojnë janë gjërat për të cilat ja vlen të diskutohet.

Media është e lirë t'i japë nuancat që dëshiron mesazheve të ndryshme të politikanëve apo institucioneve politike. Duke qenë se mesazhi përcillet nëpërmjet medias, ajo e përdor këtë pushtet sipas interesave të saj. Si pasojë politikani duhet të mësojë lojën e saj dhe t'i përshtatet.

“Si triumf i politikës së mediatizuar, personalizimit të politikës, politikës pa zgjedhje dhe dallesë reale mes aktorëve, politikë që përpiqet të diferencohet në persona dhe imazh, pa mundur të dallojë më në përmbajtje, programe dhe përfaqësim. (Kajsiu, 2009)

Fuqia që ka media në shndërrimin e një lajmi politik apo edhe të vet një politikani krijon një iluzion për audiencën, popullit mbi politikën. Shpesh politikanët nëpërmjet televizorit duken si të paprekshëm apo të plotfuqishëm, ndërkohë që kjo dukuri është disi larg realitetit. Gjuha si elementi kryesor i komunikimit dhe ligjërit është mjeti kryesor i propagandës dhe manipulimit të popullit. Duke ndryshuar mënyrën e të folurit, fillon të flasë shpejt dhe me terma të shkurtuara në mënyrë që të përfshijë çdo çështje të axhendës së tij, dhe duke u përqendruar tek look-u⁷ ai humbet kuptueshmërinë e audiencës.

Në biseda të zakonshme vihet re një habi e njerëzve se ç’ lidhje kanë mediat, sidomos ato televizive, me politikanët apo politikën. Shpesh njerëzit arrijnë të vënë re politizimin e mediave televizive dhe duke qenë se kjo dukuri ka filluar të duket si mëse normale, ato pak televizione që prezantohen si të pavarura shikohen me dyshim si të tilla. Pra, ka filluar të vihet re një marrëdhënie dhe ndikim midis medias dhe politikës. Ashtu siç ndikohet media nga politika ashtu ndikohet edhe politika nga media. Një analizë e tillë ka filluar të bëhet nga analistë të ndryshëm, por që prap nuk janë shumë të qartë mbi këtë dukuri.

Aq shumë lihet mënjanë ky aspekt sa që do të dukej disi çudi po të thuhej sikurse kanë thënë specialistët më të mirë të komunikimit se është media dhe në radhë të parë televizioni ato që e prodhojnë politikën në formën dhe në përmbajtjen e saj më të thellë. Me një fjalë ka shumë rëndësi për telespektatorët, publikun dhe elektoratin, për studiuesit dhe analistët

⁷ Look - paraqitja e jashtme, duke përfshirë që në modelin e flokëve deri tek shkëlqimi i këpucëve.

po se po, që të jenë të qartë jo vetëm për ndikimin e politikës mbi informacionin që transmetojnë mediat dhe në radhë të parë mediat televizive, por edhe në veprimin e anasjelltë, domethënë për shkallën e ndikimit të kamerave televizive mbi përmbajtjen e mesazhit televiziv dhe formën që ai merr. (Fuga, 2007)

Pra, duket qartë se media ka një ndikim të madh në përcjelljen e mesazheve politike.

Sot, media elektronike ka një funksion masiv, dhe duke qenë se i ka ikur koha mitingjeve masive dhe takimeve fizike të politikanëve me popullin, mund të themi shumë mirë se politikani është mëse i varur nga ekrani. Si pasojë, ai duhet të përmirësojë aftësinë e të folurit dhe të të sjellurit në televizion gjatë deklaratave apo bisedave të ndryshme që zhvillon. Shkurt mund të themi se ai duhet të mësojë të bëhet një aktor sa më i mirë në mënyrë që të jetë sa më i pëlqyer dhe i besuar nga publiku, që në këtë rast është telespektator.

“Zhak Burdië, ka mbërritur në një përfundim tepër interesant kur është shprehur se televizioni nuk e pasqyron një ngjarje politike, por e prodhon atë. Kjo është një risi e jetës demokratike në kushtet e shoqërive të komunikimit.”⁸

Duket se është një përfundim mëse i qartë dhe mund të thuhet se vërteton realitetin e sotëm politik.

Kontributi që media luan në nxitjen e ndërgjegjësimit ndaj problemeve të gruas është padyshim i rëndësishëm. Nëpërmjet medias mund të përcillet në publik mesazhi se pjesëmarrja e gruas në jetën politike është pjesë esenciale e demokracisë. Por media paraqet

⁸ Ibid

një imazh sipërfaqësor të gruas. Ajo i pikturon ato si të paineresuara në çështjet politike dhe rrjedhimisht do konsiderohen jo të afta për t'u marrë me proceset drejtuese si burrat.

Ajo shpeshherë propagandon stereotipe gjinore që pasqyrojnë gratë në rolet tradicionale dhe më pak të dukshme se burrat veçanërisht në pozicionet e pushtetit. Në këtë mënyrë burrat janë të prezantuar mirë si një stereotip tipik gjinor në postet publike por rrallë si prindër ose në çështjet e tjera familjare.

Media medoemos duhet të shmangë prezantimin e imazheve negative të gruas duke prezantuar gjithnjë e më tepër vendosmërinë dhe kapacitetin e saj për të qenë aktive në jetën politike. Ajo, gjithashtu mund dhe duhet të theksojë rëndësinë e rolit të gruas në jetën social-ekonomike gjatë proceseve të zhvillimit në vend. Vëmendja e medias ndaj çështjeve gjinore aktualisht mbetet akoma e dobët. Mendojmë se kjo vjen si rezultat i mungesës së integritit të çështjeve gjinore në politikat e medias, mungesës së trajnimit të punonjësve të medias mbi çështjet gjinore, si dhe të mungesës së ekspertëve të çështjeve gjinore në institucionin mediatik. Media shqiptare vazhdon të jetë e politizuar dhe komerciale. Duke qenë nën influencën e politikës, ajo fokusohet në një masë të gjerë programesh që përfshijnë debate të ashpra politike, ku burrat janë edhe aktorët dominues. Rrallë herë të zë syri ndonjë grua në emisionet televizive, ku prezantohen opinione mbi politikën, ekonominë apo ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare. Gjithashtu, gjatë fushatës elektorale, gratë politike gjejnë me vështirësi hapësirë të nevojshme në media për të transmetuar programin dhe objektivat e tyre tek publiku dhe elektorati.

5.3.4. Portretizime të medias për gratë në politikë

Njohja, promovimi dhe zbatimi i barazisë gjinore në media, është domosdoshmëri për çdo shoqëri demokratike, pasi ndikon në rritjen e pjesëmarrjes së grave në të gjitha fushat e jetës, veçanërisht në institucionet vendim-marrëse. Media duhet të shkëputet nga gjuha seksiste, pasqyrimi i rremë dhe stereotipet e krijuara mbi rolin e individit në përgjithësi dhe të femrës në veçanti, si në familje edhe në shoqëri. Mediat nuk janë të imunizuara nga paragjykimet e shoqërisë në përgjithësi, duke përfshirë edhe paragjykimet gjinore. Ajo sot vuan ende nga një kulturë e cinguar përsa i përket *barazisë gjinore*. Mediat e shkruara, ato vizive dhe së fundmi mediat sociale si *twitter*, *facebook* etj, përforcojnë kuptimet tradicionale të maskilitetit, feminilitetit dhe roleve gjinore. Media është pushtet, pushtet de facto përmes forcës që mbart, misionit që ka. Misioni i saj nuk është thjesht pasqyrimi mekanik i ngjarjeve apo dukurive që shoqërojnë zhvillimin e shoqërisë, por edhe sjellja e ndryshimit, promovimi i vlerave dhe koncepteve për barazi gjinore, në të kundërt përballemi me gra politike që e kanë pushtetin apo e synojnë atë dhe mashkullorizohen, përtej natyrës që kanë shfaqur para përfshirjes në politikë. Në disa debate publike të shfaqura në media vihet re dhe një pjesëmarrje e kandidateve femra, të cilat morën pjesë së bashku me kandidatët meshkuj, dhe mediat i paraqitën debatet pa bërë dallime gjinore. Megjithatë, ka ende një përjasje që demonstroi se mediat sigurojnë mbulim mediatik më pak të kandidateve femra se sa kandidatëve meshkuj dhe se në përgjithësi media mbart ende stereotipe gjinore. Kështu, atëherë kur gratë kandidate janë të profilizuara, mediat - sidomos mediat lokale - shpesh fokusohen në çështje private, ose në vetitë fizike të gruas (nëse ato janë tërheqëse), dhe jo në çështje që janë të rëndësishme për fushatën. Ka njëfarë

shpërfillje të medias kur vjen puna tek të drejtat e grave dhe rëndësia e pjesëmarrjes së tyre në politikë. Kjo pasi shumë kryeredaktorë janë meshkuj dhe i injorojnë përgjithësisht trajtime të tilla, duke “harruar” që gratë përbëjnë 50 për qind të popullsisë, shumica e gazetareve janë femra dhe të drejtat e grave janë të drejtat e njeriut. Fjalori i gazetarëve kur flasin për gratë shpesh është i shëmtuar dhe gruaja në media kryesisht përbën interes kur është viktimë. Shumë pak vend i jepet realisht problemit të pjesëmarrjes së gruas në politikë dhe nxitjes për rritjen e numrit të vajzave dhe grave të përfshira në mënyrë aktive në të. Hapësirat e lëna në media për gratë politike janë të pakta. Më së shumti sheh të njëjtat që shfaqen në ekrane dhe që kanë marrë më parë mbështetjen e fortë nga forca e tyre politike për daljet apo deklaratimet mediatike. Të tjerat qëndrojnë në hije, në pritje të radhës për t’u evidentuar nga krerët e partive dhe më pas për të pasur dhe më shumë akses në media, pasi vetë media nuk është e prirur t’ua ofrojë hapësirat, t’i kërkojë dhe t’i promovojë për vlerat që kanë dhe kontributin që sjellin realisht në politikë. Gjuha bëhet një mjet që shërben njëkohësisht për të komunikuar me tjetrin dhe për t’u dalluar nga tjetri. Ligjërimit mediatik është i rëndësishëm për atë që tregon në lidhje me një shoqëri dhe për atë që ajo kontribuon në karakterin e shoqërisë.

Në demokracitë bashkëkohore, ndërtimi i lidershit politik udhëhiqet nga strategjitë e komunikimit duke e vënë theksin kryesisht tek imazhi. Prandaj në këtë demokraci pozicioni i drejtuesve të politikës nuk mund të shpjegohet pa pasur si referim stilin e tyre të komunikimit dhe strategjitë e tyre mediatike. Media, veçanërisht televizioni, është bërë një qendër debatesh përsa i përket atyre politike. Ndaj dhe roli politik i mediave dhe kryesisht atyre moderne dhe ndikimi që ato kanë në opinionin publik është i një rëndësie të veçantë.

Duke qenë se televizioni ka shtrirjen më të gjerë rrjedhimisht besohet se për këtë ka edhe ndikimin më të gjerë, ndërkohë që burimet e tjera të informacionit ngelen më pas krahasuar me televizionin për nga rëndësia e tyre e informimit në kohë fushatash. Massmedia, e vecanërisht televizioni, është ai që ka luajtur një rol kyç në theksimin e karakteristikave personale të një *leadershipi*. TV-ni në përgjithësi ka sjellë strategji të një “fushate negative”, ku partitë politike e gjejnë dhe shohin si më të nevojshme që të sulmojnë oponentin sesa të prezantojnë politikën e tyre. Gjatë fushatave elektorale në Shqipëri si në atë të vitit 2005, në zgjedhjet e vitit 2009 por dhe në zgjedhjet e 2013 kemi dëgjuar të flitet shpesh me vendosmëri dhe në mënyre të përsëritur çdo ditë për një lumë akuzash për rivalët politikë. Mund të thuhet se më tepër kohë është shpenzuar për të akuzuar dhe inkriminuar politikanët e krahut të kundërt, sesa është shpenzuar për të shpjeguar platformat elektorale dhe premtimet e bëra. Por cila është hapësira që mediat japin për femrat dhe për meshkujt? Kush është gjinia e cila paraqitet më shpesh dhe zë hapësirën më të madhe televizive dhe në këtë raport sa diskriminues është media kundrejt figurës femërore.

Media është një pasqyrë e shoqërisë, dhe si e tillë dhe si një pjesë e rëndësishme e komunikimit të shoqërisë informon publikun dhe reflekton pjesë të opinionit publik. Por gjithsesi media është ende larg arritjes së barazisë gjinore në prezantimin e femrave në raport me burrat. Prezantimi si dhe hapësira që u është dhënë burrave në fushën e politikës krahasuar me prezantimin dhe hapësirën e dhënë për femrat e të njëjtës fushë dukshëm janë të pabarabarta. Sa më shumë dëgjohet dhe prezantohet në media “zëri i burrave” aq më shumë të krijohet përshtypja se në një farë mënyre kjo gjini ka përparësi, është një tregues

se kush është më kompetent për t'u deklaruar për një çështje të caktuar, më specifikuisht në fushën e politikës.

Ajo që na bie në sy është mënyra se si femra dhe mashkulli zënë vend në ekran dhe cili është roli i tyre, apo ndikimi i tyre tek audience. Masedia shquhet për krijimin e stereotipeve gjinore ndaj përparësia që ka gruaja në ekran në raport me burrin duket se ka c'rregulluar ekuilibrat mes tyre. Zhvillimi që ka pësuar media dhe teknologjia e komunikimit në vendin tonë e ka parë si domosdoshmëri mundësinë e krijimit të hapësirave të nevojshme për praninë e vazhdueshme të gruas në ekran. Roli i imazhit dhe portretizimit të saj në media vjen si një zë i fuqishëm i grave dhe i nevojës së tyre për të promovuar edhe më tej rolin e femrës në aspektin e progresit shoqëror të vendit. Shpesh herë marrëdhënia mes femrave dhe medias është parë dhe gjykuar negativisht për efektet që sjell tek publiku larmia e portretizimit të femrës. Kjo shpjegohet me faktin se media duke qënë një "institucion" me karakter ndërgjegjësues aq sa dhe promovues të vlerave tenton të përcojë mesazhe të ndryshme tek publiku. Por në të njëjtën kohë është po media e cila "guxon" ta përdor imazhin e femrësë jo pozitivisht. Janë gratë ato të cilat janë më pak të dukshme në ekran dhe se atë hapësirë kohore televizive e "rrëmbejnë" më shumë meshkujt dhe politika. Gratë dhe prania e tyre në ekran shihen si më pak të rëndësishme, ndaj dhe hapësira mediatike e tyre është e kufizuar. Ndaj nga mediat kërkohet që jo të sjellin diskriminim gjinor në ekranet e tyre por të mund të promovojnë vlerat e vërteta që një femër di t'i jap shoqërisë.

"Vështirësitë kryesore janë sulmet e medias ndaj grave, të cilat i shohin si subjekte më të brishta për të sulmuar partinë politike ku ato bëjnë pjesë, numri më i vogël i grave në këto

parti ose në parlament nga ai i burrave, dhe ato e kanë më të pamundur krijimin e lobeve dhe të grupeve, që të jenë të bashkuara në kërkesat apo qëndrimet e tyre". (Çuli, 2017)

Përmbledhje kapitulli

Kapitulli i pestë përfshin analizën që i kam bërë dukurisë së *maskilizimit*. Dhe për të bërë këtë analizë së pari kam bërë një pasqyrim të situatës së ligjërimit të gruas në politikë, duke dhënë në këtë mënyrë të gjitha tiparet dhe karakteristikat që ligjërimi femëror ka dhe njëkohësisht përdor për diskursin publik. Për ta bërë sa më të prekshëm dhe më të qartë këtë analizë, kam bërë një studim të figurës së znj. Topalli, duke e parë dhe e trajtuar atë dhe si grua politikane me vecoritë e sjelljes së saj por dhe duke analizuar dhe mënyrën e saj të komunikimit politik dhe në publik. Kjo figurë politike ka shumë për të treguar dhe për t'u marrë si rast analitik për tezën që unë kam marrë në studim.

Ndryshimi shoqëror i cili ndodhi në fund të shek..XX-të, integrimi i grave në tregun e punës, solli një rritje të pjesëmarrjes së grave në poste drejtuese dhe në një farë mënyre ndikoi në zbehjen e ndarjes patriarkale me bazë gjininë. Por ky integrim bëri që këto gra të kishin sfidë të folur in publik. Të folurit e tyre i natyrshëm konsiderohej i dobët, i nënshtruar dhe i pafuqishëm dhe, për këtë arsye, i paaftë për të marrë pjesë në politikë, për të diskutuar tema kundërshtuese, për t'u shprehur dhe për ta bindur publikun, prandaj, për t'u bërë më të sigurta dhe aventuriere, femrat përshtatën retorikën mashkullore. (Jamieson, 1988: 173)

Edhe pse për përdorimin e gjuhës jo të përshtatshme parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë, del se protagonistë më kryesor janë deputetët meshkuj se sa femrat, të cilët përmes përdorimit të kësaj gjuhe fitojnë epërsi.

Por ne herë pas herë shohim pjesë të komunikimit të dhunshëm edhe nga gratë. Pasi kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen në një sallë parlamenti apo në një arenë nuk ka shumë dallim mes burrit dhe gruas, jo për gjininë se sa për atë që duan të paraqesin. Kur femrat flasin butësisht, në mënyrë të hijshme, ndodh të mos merren seriozisht dhe për pasojë të mos kenë të drejtë hyjnë në pushtet kjo për arsyen se më këtë sjellje gjuhësore nuk janë të afta t'i bëjnë ballë presioneve politike. Por nga ana tjetër, kur ato flasin ashpër, me një stil gjuhësor mashkullor, akuzohen si të pandjeshme dhe jo femërore. Kjo gjendje e ndërmjetme bëri të etiketohet si 'dilema gjuhësore' e cila është interpretuar si një manifestim i luftës mes politikanës dhe zonjës së shtëpisë, që nënkupton se femrat nuk mund të kenë karrierë të suksesshme dhe njëkohësisht të ruajnë rolin e tyre si nëna. (Jamieson, 1995: 10-11)

Situata politike, përsa i përket komunikimit, në vend është pothuajse në një lloj tensioni, gjatë gjithë kohës dhe për më tepër në kohë zgjedhjesh qofshin këto parlamentare apo lokale

Të gjithë ne kemi parë dhe vazhdojmë e shohim zonja të nderuara, politikane të cilat flasin me tone të papërshtatshme dhe të akuzojnë rivalët politikë edhe për jetën private përmes dhe batutave vulgare. Por nga ana tjetër njëkohësisht që të gjithë jemi të bindur se ato që artikulojnë publikisht nuk është se janë mendimi apo qëndrimi i tyre i vërtetë, por është një detyrë të cilën ato e marrin nga kryetarët përkatës, që të hedhin baltë mbi kundërshtarin. Ato përdoren si manekinë të lidervë të tyre, të cilët përmes këtij përfaqësimi pohojnë shprehjen se "hedhin gurin dhe fshehin dorën". Dhe pse jo, këtë ato e bëjnë dhe për të fituar kohën televizive dhe faqet e gazetave.

Nëse ne do ti referohemi të vetmes femër e cila arriti një shkallë të lartë të karrierës politike në vend, kemi shumë për të thënë për të dhe për mënyrën e saj të diskursit publik. Zonja Topalli politikisht ka ditur të imponohet më mirë nga të gjithë, duke kundërvepruar përherë fort dhe ashpër, natyrisht jo rastësisht, por qëllimisht. Topalli, ashtu sikurse edhe gratë e tjera të politikës, e di se vështirë të kesh të ardhme nëse do të sillesh në politikë ndryshe: si një “shtëpiake” kokëulur, si një grua e mirë, e urtë e zemërbutë, por ato duhet të krijojnë një shëmbëlltyrë të meshkujve femër në parti / politikë. Pasi vetëm një shëmbëlltyrë e tillë mund të japë garanci vazhdimësie dhe sigurie për militantët apo dhe këdo tjetër që nesër do të duhet të pranohet si një trashëgimtare e denjë.

Në përgjithësi të gjithë, nuk do të pranojnë që një femër të sillet dhe të veprojë tërësisht si një mashkull, si një politikan burror por do të ishte më mirë dhe do të ndiheshim më rehat kur të shihnim se si gruaja politikane dhe jo gruaja maskiliste zbuste tensionet partiake apo situatat konfuze të politikës.

Në këtë kapitull e kam përqëndruar vëmendjen e studimit mbi median dhe rolin që ato kanë jo vetëm në shoqëri por dhe në fuqizimin politik të gruas. Televizionet sot por jo vetëm ato, edhe shtypi shkruar, rrjetet sociale me pak fjale teknologjia e informacionit ka një shtrirje të gjerë dhe në këtë kuptim dhe ndikimi që kjo media ka tek njerëzit dhe shoqëria është i madh dhe i gjerë. Fokusin e kam të përqëndruar tek roli që ajo ka gjatë një fushate elektorale, raporti që kjo media ka me politikanët, efekti që ka tek këto politikanë dhe tek shoqëria njerëzore, dhe cilat janë portretizimet që mediat i bëjnë sot grave në politikë.

Në demokracitë bashkëkohore pozicioni i drejtuesve të politikës nuk mund të shpjegohet pa iu referuar stilit të tyre të komunikimit dhe strategjive të tyre mediatike. Roli politik i

mediave moderne dhe ndikimi që ato kanë në opinionin publik është bërë një temë së cilës i janë dhënë ngjyra të ndryshme. Për disa arsye të dukshme, roli i televizionit ka qenë edhe ai i cili ka krijuar debatet më të shumta. TV ka shtrirjen më të gjerë dhe besohet se për këtë ka edhe ndikimin më të gjerë. Massmedia, pra në veçanti televizioni, ka luajtur një rol kyç në theksimin që iu ka bërë lidershit dhe karakteristikave personale. Nuk ka asnjë dyshim se në fakt televizioni inkurajon personalizimin e politikës duke i sjellë zërin dhe fytyrat e kandidatëve në shtëpinë e qytetarëve në mënyrë të rregullt. Politika gjithnjë e më shumë po vjen duke u mediatizuar. Partitë apo kandidatët që marrin pjesë në garë elektorale, e konsiderojnë televizionin si mjetin e tyre më të preferuar për të bërë fushatë. Ato e organizojnë fushatën e tyre në mënyrë të atillë që të mund të dalin sa më shumë në televizion. Kështu ato shfrytëzojnë rastet për t'u fotografuar, për të shëtitur, për të dhënë konferenca shtypi, për të organizuar mitingje elektorale. Duket se politikanët kanë gjetur një vegël të mirë për figurën e tyre politike dhe duket se media, në kohë fushatash nuk bën asgjë tjetër përveçse përsos figurën e tyre. Ashtu sikurse dhe Artan Fuga shprehet: me televizionin ka filluar koha për një lloj liderशिpi i cili me fjalë të tjera mund të quhet “i mediatizuar” (Fuga, 2004: 141).

Media luan një rol të rëndësishëm në çdo shoqëri dhe në këtë kuadër, Shqipëria nuk mund të bëjë përjashtim. Pas viti 1990, media (e shkruar apo televizive) fitoi lirinë e për pasojë pavarësinë e saj.

Përsa i përket çështjeve të barazisë, gjinia duhet të trajtohet si një efekt i komunikimit dhe jo si shkak i tij pasi komunikimi krijon gjininë dhe më pas kjo krijon komunikimin, dhe pse media njeh dhe është e vetëdijshme për paragjykimet në portretizimin e gruas. Kontributi

që media luan në nxitjen e ndërgjegjësimit ndaj problemeve të gruas është padyshim i rëndësishëm. Nëpërmjet medias mund të përcillet në publik mesazhi se pjesëmarrja e gruas në jetën politike është pjesë esenciale e demokracisë. Por media paraqet një imazh sipërfaqësor të gruas.

Ajo shpeshherë propagandon stereotipe gjinore që pasqyrojnë gratë në rolet tradicionale dhe më pak të dukshme se burrat vecanërisht në pozicionet e pushtetit. Në këtë mënyrë burrat janë të prezantuar mirë si një stereotip tipik gjinor në postet publike por rrallë si prindër ose në çështjet e tjera familjare. Media medoemos duhet të shmangë prezantimin e imazheve negative të gruas duke prezantuar gjithnjë e më tepër vendosmërinë dhe kapacitetin e saj për të qenë aktive në jetën politike. Por vëmendja e medias ndaj çështjeve gjinore aktualisht mbetet akoma e dobët. Gratë dhe prania e tyre në ekran shihen si më pak të rëndësishme, ndaj dhe hapësira mediatike e tyre është e kufizuar. Ndaj nga mediat kërkohet që jo të sjellin diskriminim gjinor në ekranet e tyre por të mund të promovojnë vlerat e vërteta që një femër di t'i jap shoqërisë.

KAPITULLI VI: ANALIZË E THELLUAR E INTERVISTAVE

Intervistat e përdorura janë intervista gjysmë të strukturuar, i janë drejtuar një grupi – numri të vogël të intervistuarish, por përtej kësaj personat pjesë të kësaj interviste nuk kanë qenë të përzgjedhur rastësisht por të përzgjedhur me kujdes ndaj dhe numri i tyre është i përcaktuar si i vogël është 10, duke konsideruar dhe personat e intervistuar të cilët kërkuan të mbeten anonimë të kësaj teze studimi. Kampionimi është i qëllimshëm, çfarë do të thotë se zgjedhja e personave është e qëllimshme në atë mënyrë që mua të më ndihmojë të zbuloj më shumë mbi tezën apo fushën e studimit. Dhe si kampion janë përdorur figura të rëndësishme përfaqësimi politik dhe publik të tillë si: deputete dhe ministre gjithashtu, të njohura publikisht jo vetëm por dhe të njohura për diskursin e tyre politik gjatë seancave plenare kryesisht, duke qenë se Kuvendi është më i përfoluri për një komunikim jo shumë të denjë dhe të hijshëm publik, por edhe gjatë komunikatave për shtyp, emisioneve televizive etj. Këto intervista janë zhvilluar brenda një periudhe 3- 4 mujore, kohë jo e përcaktuar që në fillim kaq e gjatë por e shtyrë për shkak të vështirësive gjatë mundësit të takimeve apo dhe dëshirës për t’u intervistuar. Intervistat janë zhvilluar të gjitha më dëshirën e plotë për të dhënë ndihmesë në këtë tezë studimore dhe mënyrat e zhvillimit janë kryesisht të regjistruara por dhe përmes e-mail. Analiza e 10 intervistave është si më poshtë:

Edhe pse situata ka filluar të ndryshojë, në fakt ndodh që për të përmirësuar përfaqësimin e femrës në politikë, edhe pse “hiqen” pengesat ligjore (vendosja e kuotave gjinore) ndodh që

ato përballen edhe me një sërë pengesash të tjera jo vetëm sociale, por dhe kulturore e ekonomike për të hyrë në politikë.

Përsa i përket **përfaqësimit politik të një gruaje sot**, duhet të saktësoj se kur flas për këtë përfaqësim e kam fjalën dhe kur një grua përfaqësohet politikisht nga një burrë dhe jo domosdoshmërisht vetëm nga një grua. Dhe nuk e mendoj dot që një grua të konsiderohet e përfaqësuar politikisht duhet të përfaqësohet nga një grua tjetër në politikë, kjo sepse idetë nuk kanë një ngjyrim besoj, nuk është çështje seksizmi por është çështje idesh. Të intervistuarit shprehen unanimisht se përfaqësimi i gruas në politikë ka qenë një proces gradual dhe ka synuar përfaqësimin e barabartë gjinor. Por edhe pse objektivi ende nuk është arritur, progresi është i shënueshëm.

Znj. Mimi Kodheli, Ministre e Mbrojtjes, shprehet: *“Unë besoj për shkak të ligjit elektoral dhe formulës që përdoret ne kemi të dhëna statistikore të mira, madje shumë të mira përsa i përket përfaqësimit të grave në struktura të zgjedhura qoftë ky parlamenti apo këshilla bashkiakë. Në këshillat bashkiakë Partia Socialiste ka 50 me 50 proporcionin e grave, ndërsa në parlament gratë përfaqësohen sot me 27-30 për qind të karrigeve në total”.* (Kodheli, 2017)

Kjo është një shifër e cila flet shumë, por se sa të përfaqësuara janë realisht për shkak të intesitetit apo aktivitetit politik në të cilin gratë që e përfaqësojnë mbrojnë interesta e tyre, lë për të diskutuar.

“Si pasojë e përpjekjeve shumë të mëdha mbi 20 vjeçare të lëvizjes së gruas shqiptare, e cila bashkëpunoi edhe me faktorë ndërkombëtare, sot prania gruas në politikë është mbi 17%, në krahasim me 5 apo 10 për qind që ishte rreth 18 vjet, pas ndryshimeve social politike në vend.” (Çuli, 2017)

Ndërsa për Znj. Klajda Gjasha, Ministre e Integritimit European, përfaqësimi i gruas në çdo instancë në institucionet në vend apo në politikë është tejet i rëndësishëm, ku edhe plotësimi i kuotave në masën 30 për qind të grave në partitë politike është një hap drejt avancimit të përfaqësimit të gruas. *“Kjo edhe për faktin se Shqipëria sot është anëtare e NATO-s dhe ndodhet në procesin e integritimit të saj në familjen europiane, ku demokracia është funksionale dhe ku pjesëmarrja e gruas në politikë është në standarde të tjera.”* (Gjasha, 2017)

Sipas Kodit Zgjedhor, në nenin 174 të tij, parashikohet që në qarqet ku partitë nuk kanë respektuar ligjin për 30 për qind gra në lista, edhe nëse ikën një burrë nga Parlamenti, ai duhet zëvendësuar nga një grua që mund të jetë edhe e fundit në listë.

Këto të gjitha vërtetë janë sanksionuar me ligj, por gjithsesi në praktikë disa herë janë problematike sepse jo rrallë partitë politike i barazojnë gratë me një gjobë që ata paguajnë, siç e parashikon ligji në rast thyerje të kuotës së caktuar. Dhe shumë herë e kanë më të thjeshtë të paguajnë gjobën sa të vendosin gra në lisat e tyre për të qene pjesë e vendimmarrjes dhe pjesë e Parlamentit shqiptar.

Në të vërtetë, sot prania e gruas në politikë nuk pengohet dot më nga patriarkalizmi: nëse një grua apo vajzë e re dëshiron të hyjë në politikë, mund ta bëjë këtë fare lehtë. Nëse ajo do të bëhet drejtuese, e pret një rrugë e gjatë dhe e ndërlikuar, por kjo gjë vlen pak a shumë dhe për djemtë.

Për sa më sipër, një përfaqësim sa më i madh i grave dhe vajzave në Kuvend por jo vetëm, dhe në politikë realisht do të ndryshojë fytyrën e politikës shqiptare, do të vendosë një standard tjetër në politikën shqiptare, një standard tjetër në parlamentin shqiptar, një zë dhe një etikë tjetër, të cilën ne e vuajmë sot. Por edhe pse shifrat shprehin në një farë mënyre

një përmirësim, gruaja është e përfaqësuar shumë më pak se meritat e saj në shoqërinë shqiptare. Gjithsesi mbetet shumë për të bërë në këtë drejtim për një përfshirje edhe më të madhe edhe më aktive të grave në politikë dhe vendimmarrje.

A ka një model gruaja shqiptare në politikë, të cilit mendohet dhe mundohet ta ndjekë dhe t'i afrohet?

Modele në vetvete në përgjithësi nuk ka dhe nuk mund të ketë. Ndaj nuk besoj se ka një model në politikë dhe përgjithësisht gratë nuk është se kanë model një grua tjetër sepse janë shumë egoiste që të pranojnë një model tjetër sidomos në Shqipëri. Por nga ana tjetër gratë nuk janë qenie të paditura që të mos e kuptojnë se modeli më i mirë është ai që përçon urtësi dhe zgjidhje të qëndrueshme të problemeve të shoqërisë shqiptare. Por, vetë politika në tërësi dhe atmosfera e saj është tejet konfliktuale, që ndikon në qëndrimet dhe të burrave dhe të grave.

Ka disa modele grash politikane që janë aktive dhe të suksesshme, që kanë pranuar madje të konkurrojnë edhe me meshkujt. Por këto gra politikane janë të pakta dhe modeli i tyre është jo i lehtë për t'u ndjekur masivisht. Çdo individ apo politikan e bën politikën sipas personalitetit të tij, qoftë grua apo jo. E rëndësishme është që nuk duhet harruar asnjëherë që cilido prej tyre është zgjedhur nga qytetarët e këtij vendi dhe duhet t'i shërbejë atyre me të gjitha mundësitë që ka. Çdo grua brenda dhe jashtë politikës duhet të luftojë për të drejtat e saj dhe duhet të realizojë një përfaqësim sa më dinjitoz të vetin në të gjitha sferat e veprimtarisë së saj.

Grida Duma shprehet se *“ka një stereotip jo një model, stereotipi është ai që e përbashkëson fizionominë e gruas me të burrit por duke ruajtur kufijtë e “lejuar”*

kulturalisht sa i përket komunikimit dhe kundër reagimeve të nevojshme në momentet kritike të karrierës politike”. (Duma, 2017)

Ndërsa për znj. Mesila Dode, Deputetja e Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet, secili ndërton modelin e vet. *“Mund të më thoni që një grua e suksesshme ka qenë Hilary Clinton për kohët tona, nuk flas për periudhën për personazhë si Eleonor Ruzvelt, etj të cilët i kanë dhënë jetë insitucioneve siç mund të jetë OKB etj, por diku diku Hilary dhe ajo pati një fund jo rezultativ kështu që nuk besoj se është çështje modeli.”* (Dode, 2017)

Madje të njëjtin mendim ndan dhe Znj. Eglantina Gjermani, Ministria e Zhvillimit Urban e cila thotë se *“nga gjithë këto vite, që gratë janë të angazhuara në politikë, secila është munduar fort të lerë gjurmë dhe të krijojë një model të sajën ose të ketë një profil të sajën dhe them që, secila nga ne, kur angazhohet në politikë, mundohet që, e para të jetë vetvetja dhe e dyta, të marrë nga modele qofshin botëror, qofshin në Shqipëri, tiparet apo gjithçka të mirë që secila nga përfaqëson. Them që, duke ruajtur identitetin e secilës dhe duke marrë më të mirat e politikaneve apo e grave në politikë, them që, ravizon një profil të mirë, të respektuar dhe të besuar nga qytetarët”*(Gjermani, 2017).

Unë besoj që gratë në përgjithësi tentojnë të imitojnë meshkujt sepse bota është e ashpër, kërkon rezistencë, kërkon fuqi në dukje dhe kjo e bën gruan të tentojë ose vetë të shfaqë anë maskiliste ose të mbështesë një shëmbëlltyrë maskiliste jo vetëm kur bën politikë por dhe kur mbështet një grua tjetër në politikë. Pra e thënë me fjalë të tjera, ti nuk mund të tregosh anën tënde feminine apo fragile kur kërkon të bëhesh përfaqësues i një shtrese të caktuar të popullsisë, sepse në shumicën e rasteve gratë votojnë më shumë burrat se sa gratë, është e vërtetuar lehtësisht që kur gratë zgjidhen janë të votuara më shumë nga burrat

se sa nga vetë gratë dhe anasjelltas. Kjo është një gjë që duhet të luftohet, sigurisht vjen me emancipimin e shoqërisë, shoqëria sa më e egër të jetë aq më shumë dihet tendenca, apo nevoja maskiliste për t'u përfaqësuar. Por gjithsesi prezenca e grave zbut, sepse sado të kërkosh të tregosh anën tënde të fortë, anën tënde burrërore, në fund të ditës mbetesh prap në kornizën e të qenit grua.

Cilat janë vështirësitë më të shumta, me të cilat përballet gruaja shqiptare sot si pjesë apo pretendente për t'u bërë pjesë e politikës shqiptare, sipas të intervistuarave.

Grida Duma më së miri e përcakton këtë pyetje me atë që deklaron se: *“Çdo vështirësi që ka natyrë kulturele apo të paragjyqimit në gjykimin tim duhet konsideruar një pjesë e parakushteve që çdo grua duhet t'i marrë të mirëqena në karrierën e vet politike”*. (Duma, 2017)

Klima e ashpër politike dhe tensionet politike nuk janë të favorshme, madje janë të disfavorshme për suksesin e një politikaneje grua. Po ashtu autoritarizmi i leadershipit të partive politike pengon aktivitetin normal politik të grave po ashtu si edhe të meshkujve.

Në përgjithësi, për njerëzit që përfshihen në politikë, vështirësit janë të shumta, (qofshin gra apo burra). Sigurisht në shoqërinë shqiptare, por jo vetëm, edhe në shoqëri të tjera të zhvilluara, angazhimi i grave në politikë përballet me vështirësi të ndryshme. Ka sfida të cilat duhet t'i përballin, apo duhet të mundoheni t'i kapërcejnë. Ajo çka do të rendisja në fillim është fakt se politika deri dje, në Shqipëri, është konsideruar si domen i burrave dhe përfshirja e gruas në politikë është vështirësia e parë sepse modelet që kanë ekzistuar kanë qenë modele mashkullore dhe duhet që, me profilin e grave të mund të krijojmë një model

tjetër leadership-i apo vendimmarrje në mënyrë që të fillojë të marrë më shumë tiparet e grave që janë përfshirë në politikë.

Së dyti politika sot garon jo me ide por garon me marrjen me gjëra personale, në qoftë se dikush do të të vërë poshtë apo të konkurrojë apo përballet me ty, këtë nuk e bën duke vënë përballë idenë, politikën apo projekte por mundohet ta bëjë duke të ulur poshtë, duke të ofenduar, duke përdorur fjalë të rënda. Dhe kjo është sigurisht më e dukshme kur flitet për një burrë që ka përballë një grua. Dhe gratë janë lehtësisht të atakueshme në qoftë se flitet për këtë mënyrë, për këtë mënyrë të qasjes së politikës. Ndërsa nga ana tjetër duhet që vetë gratë me forcën e mendimit dhe jo me forcën e harbutërisë apo të rrugaçërisë, apo të të fortit duhet që të përballen në këtë realitet dhe të dalin fituese. Nuk është e thjeshtë por nuk është e pamundur. *“Shpesh herë forca jonë qëndron pikërisht, por burrat këtë e mësojnë vonë, në të qenit delikate dhe e kujdesshme sa herë që përballemi politikisht me votuesit, votën e politikës apo me vetë politikanët”* – shprehet znj. Mimi Kodheli e cila drejton një ministri të ideuar për burrat dhe kush më shumë se ajo është dashur të prekë nga afër këto vështirësi dhe të vlerësojë më së miri pozicionin e femrës në politikën e ashpër dhe domen të burrave. (Kodheli, 2017)

Ndërsa për Ministren Gjermani, e cila e pranon që secila prej femrave në politikë përballet me vështirësi, vështirësi të cilat ndodhur kur ato bëhen pjesë e politikës, kryesoret janë: *“një vështirësi do të ishte edhe pjesa e balancës, familje- pjesa profesionale-politika, e cila është jo vetëm për gratë por edhe për burrat, por do ta veçoja më të vështirë për gratë, për faktin që pritshmëritë në familjet shqiptare janë që gratë duhet të jenë përgjegjëset kryesore për menaxhimin e familjes”, “pjesa tjetër është mentaliteti apo stereotipi që nuk*

mund të mos ketë ndikim edhe në shoqërinë shqiptare, edhe në media, lidhur me gratë në politikë, perceptime të cilat, sado që të mundohemi që t'i kalojmë, janë pjesë e natyrës njerëzore, e kontekstin në të cilën jetojmë, e shoqërisë shqiptare, në tërësi, duke përforcuar, dashur pa dashur këto stereotipa, që gratë nuk janë për politikë. Me pak fjalë i gjithë ky mentalitet duhet të kapërcehet, tashmë”. (Gjermani, 2017)

Do të shtoja këtu që ndodh që edhe gratë vetë, për shkak të mënyrës sesi janë socializuar apo edhe nga pritshmëritë që ka shoqëria për to, kanë një vetëvlerësim të ulët, nuk mendojnë se mund të angazhohen në politikë.

Kur bëhesh pjesë e kësaj politike, këto vështirësi nuk është se zbehen, madje përkundrazi theksohen apo shtohen edhe më shumë siç p.sh. mund të jetë konkurrenca apo edhe mbështetja që kolegët burra i bëjnë njëri-tjetrit e cila është më e fortë apo më e konsoliduar, ndërsa gratë duhet të ngrenë, të përforcojnë me njëra-tjetrën apo edhe të mbështesin secilëndo nga prej tyre, për të dhënë një model ndryshe të të bërit politikë edhe për të siguruar më shumë mbështetje nga të gjithë qytetarët, por në radhë të parë nga njëra-tjetra. Politika është një domein ku veç aftësisë duhet përkrahja e grupit dhe rrjeteve të brendshme sa të organizatës politike po aq edhe të rrjeteve të informacionit. Lobimi për një grua edhe nga vetë të ngjashmet e saj është shumë herë më i vogël krahasuar me kohezionin e lobimeve për burrat. Pra ajo që mbetet kritike dhe një hallkë e dobët e zinxhirit është mungesa e lobimit për gruan.

Pra siç e shohim vështirësitë janë të shumta, duke nisur që nga vështirësitë në punën e përditshme rreth aktiviteteve apo programit të përditshëm në punën që ka, e duke vijuar më tej edhe tek gjuha e vështirë që haset në parlament. Ky ka qenë një model i cili ka vijuar

prej vitesh në Shqipëri dhe ende disa politikanë vazhdojnë ta ndjekin, por kjo gjë duhet të ndryshojë dhe politika duhet të jetë dialoguese, të ofrojë stabilitet në vend dhe qetësi për çdo qytetar të saj.

Ato që duhet të bëhen pjesë e politikës janë duke i parë peripecitë apo problemet që ka një grua që është në politikë. Një grua që është në politikë është e dënuar nga paragjykimi, mungesa e kohës dhe nga seksizmi politik. Dhe nëse e keni vënë re të gjitha batutat e liderve të ndryshëm janë shumë më të kollajshme nëse i drejtohen një gruajë sepse të gjitha kanë nuanca seksizmi të forta dhe fyerje të forta ndaj grave.

“Sfida jonë më e madhe është të sillemi si europian dhe ky është një mesazh që duhet ti shkojë gjithë politikës shqiptare. Të sillesh si europian do të thotë të jesh tolerant, të dish të dialogosh, të dish të vendosësh interesat e vendit mbi atë partiak apo personal” (Gjosa, 2017).

Lidhur me **mbështetjen e grave gjatë zgjedhjeve, kryesisht të fundit, nga liderët e partive apo nga kandidatët e tjerë meshkuj**, të intervistuarit ndajnë përgjithësisht mendim pozitiv.

Në periudha zgjedhjesh gratë hasin vështirësi edhe në besueshmërinë nga ana e zgjedhësve, të cilët kanë më shumë besim tek burrat, sepse ju duken “më të fortë”. Kjo ndodh edhe tek vetë gratë-zgjedhëse. Pra, është një çështje e ndërgjegjësimit shoqëror. Përsa i përket drejtuesve të partive ata nuk janë kundër grave që i kanë vendosur vetë në lista. Shpesh, drejtuesit, duke e ditur mirë se gratë janë më të përkushtuara ndaj detyrës që marrin, e mbështesin kandidaten e tyre. Pra nuk është se kanë pasur ndonjë mbështetje më të veçantë për faktin që janë gra. Përkundrazi është dashur që vetë gratë të lënë mënjanë veçansitë e

natyrës së tyre dhe të homogjenizohen më natyrën e burrave duke mos lënë asnjë gjurmë të etiketimit për shkak të qenurit grua.

Ka një vetëdije që duhet të rritet numri i grave në politikë sepse është normale se është shoqëria njerëzore që është e tillë. *“Liderët nuk kanë qenë negative ndaj kësaj hipoteze ndërsa kolegët shumë herë nuk kanë qenë mbështetës me idenë që marrin numra nga ato që duhet të jenë burrat në politikë. Kështu që kjo është arsyeja”*- shprehet Mesila Dode. (Dode, 2017)

Gratë e “forta” dhe me eksperiencë kanë njohuritë e mjaftueshme dhe aftësitë për të vepruar njëloj si edhe meshkujt. Kurse gratë e reja të sapo futura në politikë kanë pasur mbështetjen e nevojshme, për më tepër që fitorja e tyre është fitore edhe e liderit të partisë edhe e ekipit politik të përbërë nga meshkuj e gra. E thënë më thjesht, të rinjtë apo të rejtat, e vendosur në listën e partisë, kanë të gjithë mbështetjen si nga lideri, nga drejtuesit vendorë të partisë dhe strukturat partiake. *“Më e fuqishme është kjo mbështetje kur bëhet fjalë për candidate gra për zgjedhjet vendore, në kuptimin që lideri dhe të gjithë deputetët, apo anëtarët e forumeve partiake, vihen në dispozicion të kandidatës grua”*.- shprehet z. Kastriot Islami. (Islami, 2017)

Por problemi për Znj. Çuli nuk qëndron tek lideri apo kolegët lidhur me mbështetjen por: *“problemi qëndron kryesisht tek zgjedhësit dhe tek kundërshtarët politikë, të cilët përdorin edhe mënyra shumë të ulëta kundër grave rivale – shpifje për probleme familjare, akuza të padrejta, etj. dhe kjo e rëndon atmosferën e zgjedhjeve.”* (Çuli, 2017)

Ndalemi tek gjuha politike, gjuhë e cila po degradon dita ditës në fyerje, tension, agresivitet.

Pothuajse të gjithë të intervistuarit e pranojnë që gjuha politike po shkon drejt një degradimi. Politika në Shqipëri është vërtetë shumë agresive, madje hera-herës degradon apo është e ashpër, fyese, e tensionuar, shumë e personalizuar, madje shpeshherë edhe pa asnjë argument, por kjo është e përgjithshme për të gjithë pjesëmarrësit në politikë, ndërkohë që për gratë mendoj se merr disa ngjyime më fyese apo lënduese, duke qenë se edhe perceptimi, edhe stereotipi i shoqërisë shqiptare është i tillë.

Kjo sepse nuk ka ide dhe mungesa e mendimit, mungesa e idesë sjell pikërisht këtë gjë. Pastaj një pjesë e madhe e politikanëve besojnë akoma që do ta kenë mbështetjen sepse pikërisht tregojnë këtë anë të ashpër të tyre, dalin dhe nga natyra e tyre dhe nga edukata për t'u bërë sa më interesant tek të ashtuquajturit burra të fortë të Shqipërisë. Në fakt nuk është kështu. Shumëkush tashmë, ka neveri ndaj kësaj qasje politike dhe preferon, absolutisht njerëz të cilët ruajnë edukatën, pavarësisht se shpesh herë edukata të merret për dobësi, ruajnë etikën pavarësisht se shumë herë kjo merret për dobësi, dhe vlerësojnë mendimin qoftë edhe kur nuk janë dakord me atë mendim që t'i shfaq por të respektojnë për shkak të mendimit që ti ke. Politika po afrohet për çdo ditë e më tepër tek batutat vulgare, ofendimi, dhe gjithçka tjetër që në politikë shikohet. Ndërsa njerëzit mendoj se po dhe duhet të afrohen gjithnjë e më tepër tek të dëgjuarit me vëmendje të atij që di të bëjë politikë, që ka mendim, që ka dëshirë, që ka projekt, ka iniciativë dhe vullnet për të bërë gjëra dhe të përfaqësohet denjësisht.

Gjuha politike që përdoret përkundrajt grave ka jo vetëm ofendime, por sulmohet edhe ajo pjesë që është shumë e ndjeshme për shoqërinë shqiptare, siç është morali, por preket edhe

veshja, prezenca e tjera me radhë shpeshherë duke i kaluar edhe kufijtë etikë të të bërit politikë.

Znj. Duma shprehet për këtë degradim të gjuhës politike se: *“tashmë e ka tejkaluar kufirin në agresivitet dhe fyerje. Përkeqësimi i gjuhës nga goditjet me një gjuhë banale deri tek krijimi i fabulave plotësisht të pavërteta, kryhen me strategji. Nëse je grua në politikë, për vite me radhë rezulton të përdoren vetëm goditje të ofendimit në nivel personal dhe duhen vite që madje edhe goditjet të zhvillohen në rrafshin e politikës jo individuale”*. (Duma, 2017)

Në këtë pikë mendoj se politika e një vendi shpreh nivelin e shoqërisë që përfaqëson. Ne nuk kemi ndonjë fjalor më të mirë në mediat televizive ku “analistët” flasin me fjalë fyese kundër njeri tjetrit, në emisione të ndjekura nga publiku si shoë të ndryshme, ku ka shprehje vulgare si nga moderuesit, si nga pjesëmarrësit. Pra, politika sillet njësoj si shoqëria jonë.

Por a është ky lloj komunikimi politik i denjë për një grua apo për një përfaqësim të denjë publik nga ana saj?

Që një grua të eci në karrierë duhet të rri pa orare, duhet të jetë e fortë, nuk duhet të marrë vendime të cilat shumë herë janë jo të drejta por janë frytdhënëse, duhet të ketë një gjuhë të ashpër dhe nuk duhet të ketë shumë sentimente në të. Dhe kjo po ndodh shumë shpesh dhe në politikë, megjithatë unë them se prap se prapë gratë kanë një sjellje tjetër, një pjesë e madhe e tyre. Ka pastaj dhe nga ato gra që e kanë zgjedhur ndryshe modelin.

Komunikimi publik i çdo politikani qoftë grua apo jo duhet bërë me përgjegjësi të plotë dhe duhet pa dyshim të jetë i denjë pasi përfaqëson jo vetëm veten por edhe atë pjesë të elektoratit që e ka mbështetur për të qenë në këto pozicione. Ka gra edhe meshkuj në

politikë që kanë një komunikim politik e mediatik adekuat, siç ka edhe që nuk janë dinjitoze për të dy palët, por mendoj se gra ka më pak. Dhe pothuajse të gjithë bien dakord që ky komunikim politik i femrave u është dukur një përfaqësim shumë i denjë publik.

Znj. Diana Çuli pranon se *“shumë prej ministreve tona apo deputeteve të të gjitha krahëve kanë sjellje të denja publike dhe politike, kanë kryer detyrën me devotshmëri dhe janë pak ose aspak objekt i abuzimeve, në të cilat burrat politikanë janë shumë të përfshirë e të akuzuar”* (Çuli, 2017).

Por nuk mungojnë nga disa të intervistuarit dhe rezervat apo kritikrat lidhur më këtë komunikim dhe se sa i denjë është ai për t’u përfaqësuar publikisht. Znj. Kodheli thotë për komunikimin politik të femrave se: *“më së pari mundohen të imitojnë shefat e tyre në politikë që tregojnë arrogancë dhe mendojnë që ky është shembulli më i mirë dhe mendojnë që në këtë mënyrë mund t’ju pëlqejnë shefave, pa menduar në fakt që atje janë për të përfaqësuar popullin, për të përfaqësuar një shtresë të caktuar të cilën ato pretendojnë se e përfaqësojnë”*. (Kodheli, 2017)

Ndërsa Znj. Grida Duma mendon që nuk kemi asnjë luks të gjykojmë sa i duhur është komunikimi i grave sa kohe ekzistenca e tyre në politikë është ende për t’u lavdëruar që mbijetojnë. *“Në gjykimin tim një pjesë e madhe e gjuhës së grave në politikë është e kushtëzuar nga reagimi shoqëror në tërësi, nga njëra anë shoqëria kërkon gruan e profilit epik, heroik, të sakrifkuar, ndërsa nga ana tjetër për të mbijetuar në organizatat e tyre gratë shfaqin një sjellje shumë luajale dhe me integritet madje duke zbutur tonet e egra të politikës.”* (Duma, 2017)

Bota shqiptare, por jo vetëm bota shqiptare, është akoma e ashpër, diku mendje hapur por diku e prapambetur, rudimentale, patriarkale dhe kjo në fakt bën që ekuilibri që femrat në

politikë duhet të kenë në vetvete, brenda vetes, midis njërës shfaqje të shoqërisë shqiptare dhe shfaqjes tjetër, nuk është i pamundur por shpesh herë është shumë i vështirë. Kështu që megjithatë besoj që gratë që kanë kohë që merren me politikë e kanë kaluar këtë të mbijetuarin në politikën maskiliste duke treguar anën e ashpër të tyre apo të fortë, sepse eksperiencia vetë të bën që të mund ta menaxhosh kundërshtarin apo mjedisin politik të ashpër duke pasur një qasje tjetër. Ndofta mësohet me kohën kjo gjë. Duke qenë dhe i ri dhe i butë je lehtësisht i manipulueshëm, i goditshëm, i sulmuar, dhe bëhesh kështu një target i lehtë për peshkaqenët e politikës. Por e përgjithshmeja është ajo që mbizotëron, që komunikimi është brenda etikës dhe i fokusuar tek çështja që diskutohet, pa kaluar në personalizime apo retorika politike.

Kush e shkakton apo stimulon këtë “maskilizim” të komunikimit politik të gruas

Nuk mund të them se ka një maskilizim, por them se ka një model botëror që gratë në karrierë duhet të ndjekin këtë model sepse ky ka qenë në fakt modeli i cili ka rritur burrat në politikë. Pra jo vetëm thjesht për politikë, po për sistemin e karrierës dhe për dy sekset e përfshira në këtë sjellje. Dhe kjo do të thotë që pak a shumë në çdo vend të botës, jo vetëm në Shqipëri, modeli i rritjes së gruas është duke u mbajtur, duke u rritur apo duke u futur brenda një modeli mashkullor i cili është rritur gjatë kohës. Por nuk ka maskilizim, ka thjesht një ndjekje të procedurës së një rruge të cilën e kanë hapur dikur disa të tjerë përpara saj. Pra kanë gjetur një model të gatshëm. *“Ky është modeli i gatshëm, modeli i karrierës është modeli i burrave në karrierë dhe ato kanë ndjekur atë lloj modeli që i është ofruar.”* (Dode, 2017)

Ndaj lidhur me këtë pyetje nuk do të arrija ta përgjithësoja përgjigjen e saj. Do të thoja që për shkak të mungesës së grave në politikë, në të gjithë botën, duke qenë se ato kanë hyrë më vonë dhe modeli mbizotërues ka qenë ai mashkullor, në disa momente grave mbase u është dashur të përdorin mekanizmin e të mbijetuarit në politikë, të marrin tipare autoritare, konkurrence, tipare të cilat konsiderohen si mashkullore. Them gjithashtu që mund të ketë ngjyrimë, në individë të caktuar, nuk dua të përgjithësoj, por them se shpesh herë për shkak edhe të agresivitetit, apo edhe faktit se janë dominuar, në nivele botërore nga burrat, ndonjëherë grave u është dashur të mbijetojnë, duke marrë ato tipare për të vazhduar gjatë kontributin dhe angazhimin e tyre në politikë. Të intervistuarit ndajnë mendimin se gratë të cilat janë të përfshira në politikë, nuk janë të maskilizuara, edhe pse në disa momente të caktuara, në disa kushte të caktuara, disave prej tyre (në nivel përgjithësues, botëror) u është dashur të marrin disa tipare që të mbijetojnë. Mendimi i përgjithshëm i tyre është se ky maskilizim është rezultat i mbijetesës në politikë. Sepse sot një grua ecën në çdo pjesë të karrierës së vet duke marrë dhe duke u rritur në modelin maskilist.

Z. Islami shprehet se *“shumica e konsiderueshme e grave nuk janë maskiliste dhe nuk janë të suksesshme për shkak të sjelljeve maskiliste; por ka edhe prej tyre, madje edhe të suksesshme. Këto të fundit janë të suksesshme si edhe disa politikanë meshkuj sepse disa segmente të shoqërisë i preferojnë edhe i mbështesin”*. (Islami, 2017)

Prandaj përgjithësisht të intervistuarit nuk mendojnë se ka maskilizim të grave shqiptare në politikë. Por ama, në një fushë të tillë, duhet ta kemi të qartë, se gratë nuk kanë pse të sillen gjoja “femërore”, kur është fjala për ligje të rëndësishme, për të luftuar krimin, abuzimet, për të qëndruar fort kundër presioneve. Madje, nëse ka një gjë që është bezdisëse dhe e

papranueshme për detyrën e deputetes apo të ministres, është veshja tepër femërore në këto detyra, teprimet në grim, në modele flokësh e rrobash, etj. Atje ato nuk shkojnë për të bërë paradë mode, as për fytyrën e bukur, por për të sjellë një mendim të vyer e me vlerë, në ndihmë të shoqërisë. Pra, detyra është me shumë përgjegjësi, nga më të rëndat e të përgjegjshmet dhe “feminiliteti” i tepruar i bën dëm çështjes për të cilën janë atje. Ato duhet të jenë serioze, pa qenë të egra.

“Nëse ndonjëra e tepron nganjëherë, kjo vjen si rezultat i frymës tepër konfliktuale në parlament, gjë që i ashpëron edhe ata burra që janë të urtë apo të matur. Kujdes me stereotipet! “Që gruaja maskilizohet”, po shndërrohet në stereotip dhe ky është po aq i rrezikshëm sa dhe vetë patriarkalizmi. Nga ana tjetër, nuk më duket “si burrë” asnjë nga gratë tona në parlament” (Çuli, 2017)

A është e mundur për femrat në Shqipëri të jenë të suksesshme në politikë dhe pa e maskilizuar diskursin e tyre publik.

Patjetër që është e mundur, patjetër që të gjitha kanë shanse, por secila duhet kujdesur në të përditshmen e saj për ta ruajtur dhe të mos ndryshuar. Ky është në përgjithësi mendimi i tyre lidhur me këtë pyetje.

Duke iu referuar grave besoj që nuk e kanë maskilizuar, përkundrazi, janë munduar të japin një kontribut të rëndësishëm në ndryshimin e politikës në Shqipëri. Sigurisht nuk mund ta transformojnë në një kohë relativisht të shkurtër, për kaq kohë sa gratë janë bërë pjesë e politikës, por pa dyshim që janë ato me kontributin e tyre i kanë dhënë ngjyrë tjetër politikës, diskursit publik dhe krijojnë identitetin e një zëri ndryshe, në politikë, jo vetëm në Shqipëri.

Znj. Mesila Dode nuk beson se gruaja e ka maskilizuar diskursin publik. Madje për të nuk ka një diskurs maskilist dhe një feminil, por ka një diskurs politik ashtu sikurse një tjetër ekonomik, një për çështjet sociale dhe varet se ku e ndjen veten më mirë, por nuk ka një diskurs meshkujsh apo një diskurs femrash. - *“Sigurisht që femra nuk shan me fjalë të pista, sigurisht që një femër nuk mund të ketë atë lloj degradimi që kanë meshkujt por ky është një degradim i përgjithshëm. Gratë ndjekin një diskurs të tyre që unë mendoj se janë shumë më të përkushtuara në politikë por diskursi nuk mund të jetë feminil apo maskil ai është thjesht politik ose jo politik”*. (Dode, 2017)

A mendojnë të intervistuarit se kjo gjuhë e përdorur nga politikanët tanë në një farë mënyre reflekton kulturën tonë politike

Demokracia është e brishtë, e pa konsoliduar në Shqipëri. Na është dashur të kalojmë nga një regjim në tjetrin. Shumë gjëra i kemi mësuar apo edhe po i mëson e gjithë klasa politike, qoftë edhe duke gabuar, qoftë edhe duke u mundur të krijojë një zë të saj, por nga ana jo vetëm reflekton në kulturën tonë publike, por ka një impakt të jashtëzakonshëm në shoqërinë shqiptare, duke qenë se ne jemi, si qytetarë, shumë të lidhur apo të angazhuar edhe me një vëmendje të veçantë për politikën, shpeshherë konfliktualiteti dhe agresiviteti në politikë mund të ndikojë edhe në nivelin e agresivitetit dhe konfliktualitetit në shoqërinë shqiptare. Të dyja janë shumë të lidhur, kështu që në momentin që politika jep modele pozitive të bashkëpunimit, të diskutimit me argumente, jo të konfliktualitetit agresiv e gjithë kjo përcillet edhe në shoqërinë shqiptare dhe kështu nxit edhe pozitivitetin duke sjellë edhe një zhvillim më human, të orientuar drejt problematikave, për t'i zgjidhur, sesa drejt ndarjes apo agresivitetit në përgjithësi. Pra retorika politike është pasojë e sjelljes në përgjithësi, e traditës demokratike të munguar për shumë kohë, e nivelit arsimor-kulturor, e

qasjes ndaj debatit, ndaj transparencës, ndaj konsensusit, ndaj marrëdhënieve njerëzore në familje, në shkollë, në komunitet.

Znj. Diana Çuli e shpreh më së miri këtë duke rënë dakord që reflektohet kultura jonë politike, dhe kjo kulturë politike reflekton kulturën tonë shoqërore. Ajo thotë se: *“Ata sillen siç sillen shumica e shqiptarëve në shtëpitë e tyre dhe në marrëdhëniet me njeri tjetrin. Mendoj se çështja nuk është e ndarë: politikanë dhe qytetarë. Ata janë qytetarë si ne, i kemi zgjedhur ne, i kemi pranuar ne. E dimë si flasim, si sillen. Përse nuk zemërohemi kaq shumë edhe kur dëgjojmë në show-t e ndryshme TV fjalë nga më të rëndat? Jemi ne që i pranojmë këto banalitete dhe vulgaritete, gjuhën e dhunës, që e pranojmë edhe në rrjetet sociale, si diçka normale. Kjo kulturë e ulët shoqërore, reflektohet edhe në politikë. Pra, e gjithë shoqëria duhet të ndryshojë përmes arsimimit, edukimit, formimit kulturor, që të prodhojë nesër përfaqësues të denjë të saj.”* (Çuli, 2017)

Pra nuk është çështje vetëm kulture politike, sepse gjuha e ashpër ndeshet jo vetëm në politikë.

Ndaj dhe mendimi i të gjithë të intervistuarve është që po, patjetër që e tregon sepse Shqipëria është një demokraci e re dhe e brishtë dhe për pasojë nuk ka mbërritur akoma në atë nivel të shfaqjes, të komunikimit si demokraci, që të mund të jetë një koncentrim, një kuintesencë e asaj çka është më inteligjente në shoqëri, e asaj çka është më e mirë në shoqëri, përkundrazi shpesh herë politikanët janë jo ata që e përfaqësojnë më mirë shoqërinë por janë ato që e përfaqësojnë më keq shoqërinë shqiptare. Shoqëria shqiptare nuk është kjo shoqëria ku gjithë kohën njerëzit pa mendim, pa bosht, pa tru në kokë zihen e shahen nga familjet me njeri tjetrin. Shoqëria shqiptare është një trupë e shëndetshme që do kohë ta mësojë deri në fund demokracinë e cila është gjithnjë një proces, dhe diku diku nuk

funksionon as në vendet ku demokracia ka 200 vjet që është themeluar, kështu që “*unë besoj se duhet akoma të rrjedhë ujë, por shpresoj që brezat e rinj të mos i ngjajnë kësaj politikës së vjetër, dhe jo domosdoshmërisht politikën e vjetër e bën një njeri me moshë të kaluar por mund të jesh politikan i vjetër dhe nëse sapo je futur në politikë sepse ke mendësi të tilla. Por të kenë si shembull më të mirën e asaj çka bota të ofron sot, dhe bota nëpërmjet komunikimit ka kaq shumë mundësi për të të ofruar një mendim ndryshe, për të qenë tolerant, për të qenë mëndje hapur sa ti lehtësisht mund të marrësh një shembull tjetër për të gjitha herët që ti nuk e gjen këtë tek vendi jot, ose tek politikanët e tu nëse ti do të marrësh këtë rrugë”* (Kodheli, 2017).

Ndërsa Znj. Duma mendon që kjo gjuhë i qaset kulturës thelbësisht ballkanase të shqiptarëve, e cila sipas saj është e orientuar nga forca si mundje e pa dinjitet e kundërshtarit. “*Ajo thekson që ende është një gjuhë që i qaset turmave jo shumatores së individëve, gjuha e fortë pa sofistikim nënkupton që paramendohet që qytetarët shqiptarë nuk janë individë historikë, por një bashkësi popullate. Mund të diskutohet edhe sociologjikisht mbi korrelacionin “të ardhura për frymë” dhe komunikim publik. Popujt që jetojnë në maxhorancë në nivelin e të ardhurave për frymë nën atë që quhet nevoja të socializimit, kanë tendenca të parapëlqejnë dhe motivojnë gjuhën e fortë politike, pasi reagojnë ndaj stimujve shumë më tepër bazike se sa të sofistikuar”* (Duma, 2017).

Kështu që ne na duhet pak kohë, vazhdimisht të gjithëve ju duhet kohë, problemi është që ne mendojmë se na duhet kohë e ndërkohë mendojmë se xhirojmë por xhirojmë në vend. Kjo nuk duhet të ndodhë sepse i bie të kemi energji të shkuara dëm. Sot është pak më ndryshe por sërish nuk është e mjaftueshme. Shqipëria ka akoma shumë gjëra për të mësuar. Kjo është kultura jonë politike, kemi një kulturë politike shumë të kufizuar dhe

kemi pak vite në të cilët ne jemi duke bërë një ecje në tranzicionin apo në arritjen e gjërave tona në politikë. Kështu që është normale.

PËRFUNDIME

Të jesh grua në Shqipëri ka edhe shumë kënaqësi, por më shumë vështirësi. Të jesh grua në Shqipëri ndodh që të kesh frikë të konkurrosh me burrat për poste, se menjëherë vjen forca e burrit që kërkon të delegjitojë statusin publik të gruas duke e sulmuar në sferën private.

Gratë sot gëzojnë të drejtën e votës, shkollimit, punësimit dhe shumë të tjera por gruaja edhe sot vazhdon të jetë e pa përfaqësuar në proceset politike. Përfaqësimi i gruas në politikë ndryshon prej vendit në vend, ka vende që kanë për qind maksimale të përfaqësimit të gruas në parlament (si Ruanda) ashtu sikurse ka dhe vende që kurrë nuk kanë pasur gra në parlament (si Arabia Saudite etj.).

Shumë mendojnë se kjo mungesë e gruas në proceset politike vjen si rezultat i disa faktorëve të tillë si: kualifikimit të ultë të gratë, mungesës së ambicieve politike apo dhe vetëbesimit për të marrë vendime politike. Po, është e vërtetë se, në shumë raste niveli i edukimit të gratë është më i ultë sesa të burrat por kjo nuk do të thotë se gratë janë më të paafta se burrat por sepse gratë kanë qenë të diskriminuara dhe vazhdojnë të diskriminohen në aspektet edukimit dhe të punësimit.

Ne mund të vazhdojmë të jemi ajo shoqëri patriarkale që tradita na kanë mësuar të jemi – një shoqëri e cila nuk e do një grua në politikë, një shoqëri e cila gruan nuk e do as si pjesëtare të fuqisë punëtore; që nuk do as që ajo të edukohet, të ketë një pronë apo të fillojë e të ketë një biznes, por barazia gjinore është një e drejtë dhe gruaja minimumi duhet respektuar si qenie njerëzore.

Politika është një investim për të gjithë individët, dhe përfaqësimi i grave në çdo instancë është një tregues i mos diskriminimit dhe përmbushja e standardeve demokratike të një vendi.

Përfaqësimi i barabartë i gruas në politikë është konsideruar të jetë shumë i rëndësishëm. Njëra ndër argumentet kryesore është se përdërisa gratë përbëjnë 51 për qind të popullsisë është e drejtë juridike elementare që gratë të përfaqësohen në institucionet politike në mënyrë të barabartë me burrat. Demokracia e kërkon një gjë të tillë sepse mos përfaqësimi i barabartë i grave në politikë bie në kundërshtim me konceptin e demokracisë. Argument tjetër është se gratë kanë interesa, nevoja dhe eksperiencat të ndryshme nga burrat dhe se këto interesa mund të përfaqësohen vetëm nga gratë e jo nga burrat dhe për këtë arsye duhet të ketë përfaqësim të barabartë të dy gjinive në parlament. Mungesa e mundësive materiale për t'u promovuar, kushtet e rënda ekonomike dhe sociale për shumë gra janë disa nga pengesat të cilat nuk i lejojnë ato të inkuadrohen në politikë. Përveç këtyre, ndër pengesat kryesore janë dhe barrierat institucionale si për shembull sistemi i rekrutimit në partitë politike. Po është e vërtetë dhe ndodh dhe në politikë ashtu sikurse ndodh në sferat e jetës së përditshme me të cilat një femër ndeshet për rritjen e saj profesionale. Sot punëdhënësi edhe shtetëror, kur përgatit kriteret e konkurrimit për një vend pune, nëse mendon se duhet të jetë grua, kërkon që: të jetë e paraqitshme, të jetë e disponueshme. Edhe kjo është një formë diskriminimi sepse një kërkesë e tillë nuk paraqitet si kërkesë për kandidatët burra

Proceset në të cilat ka lëvizur emancipimi i gruas kanë qenë kryesisht në këto 3 drejtime kryesore: arritja e barazisë për burrat dhe gratë - e drejta e votës dhe barazia politike e

gruas; rritje e numrit të pjesëmarrjes së grave në vendin e punës - krahas arritjes së barazisë politike fokusi u zhvendos tek barazia gjinore në ligj; rritje e numrit të femrave në pozita udhëheqëse dhe menaxheriale - pra jo vetëm barazi gjinore por dhe një rritje e ndikimit të grave në politikë. Këto lëvizje ishin vendimtare që femrat të fitonin pavarësinë dhe të ishin një zë unik i gjinisë së tyre, për t'u dalluar nga burrat.

Secila prej këtyre, në një farë mënyre, ka kontribuar në tejkalimin e diskriminimit gjinor në sektorë të ndryshëm të jetës së gruas, duke filluar nga barazia ligjore drejt barazisë sociale e më pas drejt barazisë në vendin e punës.

Lëvizjet feministe sollën jo vetëm lirinë e grave, por i dhanë rëndësi edhe gjinisë së tyre. Ky zë i pavarur ndikoi jo vetëm për të ndihmuar gratë të fitonin barazinë por iu dha atyre një zë unik, i ndihmoi të kenë pozita udhëheqëse dhe drejtuese, dhe i bëri të dallueshme nga meshkujt. Por nga ana tjetër këto dallime gjinore kanë ndikim në stilin e komunikimit, taktikat e ndikimit si edhe në stilin e lidershit. Dhe nisur nga këto dallime gjinore vihet re se burrat dhe gratë janë vërtetë tipe të ndryshme udhëheqësish.

Gratë dhe meshkujt kanë lindur të barabartë, pavarësisht se nuk kanë jetuar e zhvilluar statusin e tyre socio-politik si të tillë përgjatë kohës. Pozita e gruas shqiptare me gjithë evolucionin politik, social, material e kulturor vazhdon të mos jetë aty ku duhet. Koha moderne ka sjellë ndryshime të konceptit dhe nevojën e rishikimit të traditës patriarkale dhe të nevojës së rivendosjes së “kufijve të rinj” midis burrit dhe gruas. Klima e ashpër politike dhe tensionet politike nuk janë të favorshme, madje janë të disfavorshme për suksesin e një politikaneje grua. Po ashtu autoritarizmi i lidershit të partive politike pengon aktivitetin normal politik të grave por gjithashtu si edhe të meshkujve. Unë mendoj

se ka një aproch tjetër tani, ka një vetëdije që duhet të rritet numri i grave në politikë sepse është normale se është shoqëria njerëzore që është e tillë. Liderët nuk kanë qenë negative ndaj kësaj hipoteze ndërsa kolegët shumë herë nuk kanë qenë mbështetës me idenë që marrin numra nga ato që duhet të jenë burrat në politikë. Kështu që kjo është ndër arsyet. Gratë e “forta” dhe me eksperiencë kanë njohuritë e mjaftueshme dhe aftësitë për të vepruar njëloj si edhe meshkujt. Kurse gratë e reja të sapo futura në politikë kanë pasur mbështetjen e nevojshme, për më tepër që fitorja e tyre është fitore edhe e liderit të partisë edhe e ekipit politik të përbërë nga meshkuj e gra. E thënë më thjesht, të rinjtë apo të rejtat, e vendosur ne listën e partisë, kanë të gjithë mbështetjen si nga lideri, nga drejtuesit vendorë të partisë dhe strukturat partiake. Më e fuqishme është kjo mbështetje kur bëhet fjalë për kandidate gra për zgjedhjet vendore, në kuptimin që lideri dhe të gjithë deputetët, apo anëtarët e forumeve partiake, vihen në dispozicion të kandidates grua. Ato që duhen të bëhen pjesë e politikës janë duke parë peripecitë apo problemet që ka një grua që është në politikë. Një grua që është në politikë është e dënuar nga paragjykimi, mungesa e kohës dhe nga seksizmi politik. Pra nëse e keni vënë re të gjitha batutat e liderëve të ndryshëm janë shumë më të kollajshme nëse i drejtohen një grua sepse të gjitha kanë nuanca seksizmi dhe fyerje të forta ndaj grave. Fitoret e fundit legislative në Shqipëri, në veçanti përfshirja e kuotave gjinore për pozicionet e zgjedhura dhe të emëruara në Ligjin “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” (Korrik 2008) dhe rishikimi i Kodit Zgjedhor (Dhjetor 2008), kanë çuar në një rritje të pjesëmarrjes në politikë të grave shqiptare në nivel kombëtar.

Gjithsesi, politika vazhdon të konsiderohet ‘monopol’ i meshkujve, për arsye se përfshirja e grave në politikë nuk është ende në nivele përfaqësuese. Sfidat që femrat, për shkak të përkatësisë gjinore, kanë ndeshur në jetën publike e veçanërisht në sferën politike,

vazhdojnë të jenë reale madje frenuese. Ndër to përmendim vetë mjedisin e vështirë në të cilin zhvillohet politika në shoqërinë tonë, vrazhdësia, agresiviteti, ofendimet por dhe si tjetër sfidë, madje si pengesa kryesore me të cilën përballen femrat në politikë vlen të përmenden paragjykimet dhe stereotipat gjinorë. Gjithashtu me rëndësi është të përmendet dhe fakti që krahas faktorëve të sipër përmendur femrat në politikë përballen dhe me pritshmëri kontradiktore në lidhje me mënyrën e tyre të folurit, me diskursin e tyre publik. Lufta kundër mentalitetit patriarkal ende vazhdon, thonë se zakonet e vjetra “vdesin” vështirë.

Gratë politikane të gjendura në një shoqëri patriarkale apo ‘politikë të burrave’, gjenden në një pozitë të tillë, që duke qenë të pabarabarta me meshkujt janë edhe të pabarabarta në dhënien e mundësive për të treguar nëse kanë efikasitet më të lartë se to në proceset vendimmarrëse. Ndaj nëse ne do të duam që të kemi femra të pavarura që i kundërvihen këtij mentaliteti dhe jo ti nënshtrohen kësaj forme politike, nëse ne do të duam të kemi një barazi gjinore në raportin femër –mashkull duhet të kërkojmë që *gratë të mos gjykojnë vetëm nga gjatësia e fundeve të tyre*. Mendoj se politika e një vendi shpreh nivelin e shoqërisë që përfaqëson. Pra, politika sillet njësoj si shoqëria jonë.

Kuota është një ndër format më të përshtatshme për përfshirjen e femrave në vendimmarrje e sidomos në vendet në tranzicion demokratik. Megjithatë, prania e kuotës nuk nënkupton domosdoshmërisht zgjidhjen e problemeve dhe sfidave me të cilat ballafaqohen femrat. Kuotat politike dhe përparimet e individëve të caktuar mund të sjellin ndryshim statistikore, por do të duhet kohë për të përmbysur botëkuptimet tradicionale e konservatore të rajonit. Edhe me vendosjen e këtyre kuotave për herë të parë në ndryshimet e Kodit Zgjedhor të

2008, partitë politike arritën ta shmangin këtë detyrim ligjor. Pasi pavarësisht kërkesës së Kodit Zgjedhor për një kuotë 30 për qind për gratë në listat e kandidatëve, partitë politike i vendosën gratë në fund të listave duke bërë që shanset e tyre për zgjedhje të ishin minimale. Në zgjedhjet e vitit 2013 disa parti politike i shmangën hapur kuotat gjinore, të cilat tashmë ishin të imponuara nga ligji, duke marrë dënimin përkatës nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rezultati për legjislaturën 2009-2013 ishte 16 për qind e grave deputete ndërsa legjislatura 2013-2017 me ndryshimet e ndodhura (dorëheqja e një pjesë të madhe të kabinetit qeveritar nga posti i deputetit) solli një rritje të numrit të përfaqësimit të grave në 21%.

Edhe pse kemi progres përse i përket rritjes së pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrje dhe politikë, në Shqipëri, situata aktuale akoma tregon se gratë ende vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuara. Dhe ky nënpërfaqësim vjen si pasojë e disa faktorëve, ku ndër kryesorët përmendim: kultura tradicionale në përgjithësi dhe ajo politike në veçanti; paragjykimet ndaj grave; mungesa e përkrahjes nga ana e familjes, mungesa e përkrahjes nga partitë politike, konkurrenca e padrejtë, diskriminimi gjinor, stereotipet shoqërore, vështirësitë për të gjetur burime financiare, por dhe mungesa e vetëbesimit.

Sepse synimi i një karriere politike nga meshkujt është më e lehtë se sa kur fjala është për gratë, atyre ju duhet të gjejnë një ekuilibër mes familjes/jetës në shtëpi dhe karrierës profesionale.

Në përgjithësi, sot në botë në lidhje me përfaqësimin e grave në politikë ekzistojnë dy ligje gati të 'hekurta', të cilat përshkruajnë më qartë situatën e depërimit të grave në elitën politike:

Së pari, cilido qoftë posti apo privilegji politik, gjithmonë ka më shumë meshkuj se gra të cilët konkurrojnë për këtë post apo privilegj, madje edhe në rastet kur gratë konkurrojnë ato e kanë më të vështirë për t'a siguruar atë dhe **së dyti**, sa më lart që të ngjitemi në hierarkinë e posteve, aq më pak gra do të ketë në to. (Chapman, 1993)

Gruaja shqiptare në luftën për barazi gjinore, ka përballë një traditë shekullore të kultivuar, në të cilën roli i saj ka qenë shumë i reduktuar. Shoqëria shqiptare është e ndërgjegjshme dhe e pranon se ky problem është në disfavor social të gruas. Natyrisht është i njohur fakti që e kaluara historike dhe politike e shoqërisë tonë, ka qenë e tillë që në shekuj gruan e ka parë si qenie jo të denjë për ambientet publike të jetës shoqërore dhe të politikës, por të “denjë” vetëm për ambientin e shtëpisë. Politika dhe jeta sociale, sipas mentalitetit, ka qenë e huaj për gruan. Natyrisht, jetës publike në vendin tonë nuk i kanë munguar gratë, të cilat nëse i kthehemi historisë, në revolucionin e famshëm komunist të viteve '70 u quajtën forcë e madhe e jetës sociale. Raporti numerik nga viti në vit nuk ka ndryshuar shumë, por sidoqoftë prezenca e tyre ka qenë ekzistente dhe e dobishme.

Debatet e sotme politike ndërlidhen ngushtë jo vetëm me komunikimin, por edhe me gjuhën dhe ligjërimin. Materiali gjuhësor që përdoret në ligjërim është tregues i rëndësishëm i identitetit të folësit. Gjuha politike është mjete kryesor i politikë-bërjes. Por, gjuha që përdorin liderët kryesorë të partive politike është një gjuhë e ngurtësuar që lë pak shteg për dialog dhe për arritjen e një konsensi politik. Niveli i konfliktit dhe ashpërsisë së kësaj gjuhe reflekton nivelin e demokratizimit të vendit dhe shoqërisë, nivelin e tolerancës për pranimin e mendimit ndryshe.

Karakteristikat e ligjërimit politik vazhdimisht formojnë kulturën politike të një populli. Në një situatë opozite dhe pushteti, ligjërimi politik karakterizohet nga një larmi mjetesh teorike: metafora, përsëritje, antiteza, përdorim i gjerë i shkallës krahasore të sipërisë relative dhe absolute, një denduri të lartë shprehjesh dhe fjalësh ekspresive emocionale, mjete të cilat së bashku ndikojnë për të bindur dhe manipuluar publikun në kuptimin e përgjithshëm të fjalës. Të gjithë e dimë që meshkujt dallojnë për stilin e tyre ligjërues: të prerë, bindës e të vendosur, të ashpër e herë herë kërcënues, ndërsa ligjërimi femëror në politikë dallohet për nivelin e lartë shprehës emocional gjë e cila arrihet me anë të mjeteve të larmishme retorike, përdorimit të fjalëve dhe shprehjeve emocionale. Por ky ligjërimit në situata opozite në më të shumtën e rasteve është i ashpër, polemik dhe kontestues, në përmbajtje të tij ka akuza, qortime, kërkesë llogarie, vënie në dyshim vërtetësinë e fakteve të kundërshtarëve, tone të ashpra dhe akuzuese.

Por, në këtë shoqëri dhe me këtë mentalitet, femrat- për të fituar politikisht epërsi dhe që të jenë të suksesshme në diskursin e tyre politik dhe publik- duhet të tregojnë dhe dëshmojnë agresivitet, karakter të fortë e burrëror. Të gjithëve në fakt na bën shumë përshtypje gjuha dhe komunikimi jo vetëm në Parlament, por edhe jashtë tij, një gjuhë e cila është jo vetëm shumë agresive por dhe diskriminuese në raport me kundërshtarin. Kjo gjuhë në fakt nuk është se fyen më shumë kundërshtarin se sa indirekt fyen publikun, qytetarin shqiptar.

Retorika politike shpesh degjeneron në debate thuajse banale, kjo me anë të batutave vulgare, sulmeve personale herë herë agresive, gjë që pasqyron mungesë profesionalizmi, përgjegjësie dhe një mungesë të theksuar etike. Dhe nëse për të vërtetuar këtë do ti referohemi studimit të bërë mbi ligjërimit politik të figurave kryesore politike shqiptare, përfundimi është se *“45 për qind e ligjërimit të secilit prej këtyre aktorëve politikë që i*

kushtohet tjetrit “janë fyerje të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta personale karakteri, akuza pa bazë dhe krahasim apo asocim i kundërshtarit me tipare politike të së kaluarës ose figura politike botërore me imazh negativ” (Lafe, 2012: 2-3).

Gjuha e përdorur, jo vetëm në sallën e Kuvendit të Shqipërisë, është e larmishme në shprehje batutash vulgare, kërcënuese, fyese, e larmishme me një fjalor të pakulturuar e të ulët ndryshe nga çfarë ndodh në parlamentet në tërë botën ku edhe kur synim është fyerja e kundërshtarit, gjuha e përdorur për këtë qëllim nuk është e drejtëpërdrejtë por gjuha që përdoret është politikisht e tillë e cila përfshin nënkuptimin. Raste të përdorimit të kësaj gjuhe të papërshtatshme për një sallë kuvendi ka plot, mjaft të përmendim: *hajdut ordiner; simbol i hajdutit; ordiner rruge; mashtrues ordiner; ti nuk je burrë; analfabet që nuk merr vesh asgjë; para të vjedhura; fabrikë mashtrimesh; nuk ke pikën e burrnisë; i pafytyrë; skizofren etj.* (Hima & Merkaç, 2015: 422-423)

Jo vetëm realiteti politik shqiptar, por dhe ambienti politik në përgjithësi është i përcaktuar nga një prezencë e fortë mashkullore, por edhe pse politika shqiptare është e “dhunshme” në të vazhdojnë të afrohen gra, të cilat aty nuk mund të jenë kurrsesi për gjëra të bukura pasi në dorë të tyre ndodhet fati i vendit. Pasi kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen në një sallë parlamenti apo në një arenë nuk ka shumë dallim mes burrit dhe gruas. Kjo është kultura jonë politike, kemi një kulturë politike shumë të kufizuar dhe kemi pak vite në të cilët ne jemi duke bërë një ecje në tranzicionin apo në arritjen e gjërave tona në politikë.

Politika gjithnjë e më shumë po vjen duke u mediatizuar. Krijimi i mediave solli edhe krijimin e mundësive që politikanët në rastin konkret të gjejnë një hapësirë të mirë për të “marketuar” veten e tyre. Dhe, ashtu siç shprehet Mekluhani, “*mediat kanë gjithçka që iu*

duhet, kanë mjetet për t'i bërë ato të pëlqyera nga publiku dhe për të transmetuar idetë që duan të japin” (McLuhan, 2004: 184).

TV ka shtrirjen më të gjerë dhe besohet se për këtë ka edhe ndikimin më të gjerë. Massmedia, pra në veçanti televizioni, ka luajtur një rol kyç në theksimin që iu ka bërë leadershipit dhe karakteristikave personale. Media luan një rol të rëndësishëm në çdo shoqëri dhe në këtë kuadër, Shqipëria nuk mund të bëjë përjashtim. Ajo dhe shtypi i shkruar në demokraci luajnë një rol të rëndësishëm pasi ajo ka një impakt të madh tek opinioni publik pasi është pasqyra e problemeve të qeverisë dhe sistemit politik.

Në demokracitë bashkëkohore pozicioni i drejtuesve të politikës nuk mund të shpjegohet pa iu referuar stilit të tyre të komunikimit dhe strategjive të tyre mediatike. Në mes të instrumenteve që mund të favorizojnë dhe mund të bëjnë të suksesshëm një lider politik patjetër që massmedia do të dalë si një faktor kryesor dhe si një faktor i cili për nga rëndësia mund të krahasohet me partinë apo lëvizjet politike. Fatkeqësisht, ndonëse nuk thuhet, gjithsesi lë të kuptohet se fakti nëse je prezent në media apo jo, tregon në një farë mënyre nëse je i rëndësishëm apo jo.

Por nga ana tjetër ajo (media) shpeshherë propagandon stereotipe gjinore që pasqyrojnë gratë në rolet tradicionale dhe më pak të dukshme se burrat veçanërisht në pozicionet e pushtetit. Medoemos duhet që media të shmangë prezantimin e imazheve negative të gruas duke prezantuar gjithnjë e më tepër vendosmërinë dhe kapacitetin e saj për të qenë aktive në jetën politike. Gratë dhe prania e tyre në ekran shihen si më pak të rëndësishme, ndaj dhe hapësira mediatike e tyre është e kufizuar.

Lidhur me **hipotezën** e punimit shkencor “*Maskilizimi (në komunikim) është kusht i domosdoshëm për pjesëmarrjen e gruas në politikën shqiptare*”, studimi e vërteton këtë hipotezë.

Shoqëria shqiptare ende në mentalitet vazhdon të jetë patriarkale. Sado përmirësim pati kjo shoqëri me rregullimin ligjor që i bëri përfaqësimit të grave, në rritjen e për qindjes së pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje dhe politikëbërje, sërish situata nuk është pozitive në favor të tyre. Akoma aktualiteti social dhe politik është i vështirë për to, i vështirë për të vënë në dukje vlerat e gruas, i vështirë dhe për të pranuar një femër në politikë, kjo sepse politika është domen i burrave. Dhe për ta bërë sa më të lehtë rrugën drejt politikës, për të qenë e pranuar në mënyrë të barabartë ashtu sikurse burrat në politikëbërje, femra shqiptare arrin deri aty sa të sillet e të flasë stilistikisht si një mashkull, si një mashkull politikan. Pra dhe ato pak gra që janë në politikë duke qenë në një ambient tepër mashkullor dhe të egër detyrohen të ngurtësohen, e herë herë të bëhen agresive që të mund të përballen me burrat. Për këto femra kjo është parë si mënyra më efektive për t’u trajtuar dhe e pranuar si e barabartë në sferën publike. Sepse përndryshe, të folurit e tyre i natyrshëm konsiderohej si i dobët, i nënshtruar, i pafuqishëm dhe i paaftë për të marrë pjesë në politikë, për të diskutuar tema kundërshtuese, për t’u shprehur dhe për ta bindur publikun. Ndaj ky realitet politik bëri që këto femra të cilat aspironin politikën të përshtasin retorikën mashkullore për të përballuar me sukses sfidën e të folurit në publik.

Dhe në përgjigje të pyetjes kërkimore studimi nxjerr si rezultat se shembulli i dhënë nga meshkujt, nisur dhe nga vetë natyra mashkullore, është modeli disi i egër, i ashpër, pak agresiv hera herës, model të cilin vetë bota, vetë shoqëria e ka imponuar. Bota është e ashpër, dhe shoqëria sa më e egër të jetë aq më shumë dihet tendenca, apo nevoja maskiliste për t'u përfaqësuar. Kjo shoqëri kërkon rezistencë, kërkon fuqi në dukje gjë që e bën gruan të tentojë ose vetë të shfaqë anë maskiliste ose të mbështesë një shëmbëlltyrë maskiliste jo vetëm kur bën politikë por dhe kur mbështet një grua tjetër në politikë. Ndaj si burrat ashtu dhe gratë jo se kanë zgjedhur rastësisht të bëjnë politikë të dhunshme, jo se kanë zgjedhur rastësisht të vazhdojnë të jenë pjesë e saj pa sjellë ndryshim. Ato janë aty si të tillë për shkak të modelit që shoqëria shqiptare ka zgjedhur për politikëbërje, vazhdojnë të sillen dhunshëm jo se nuk duan ndryshimin por se ndryshimi ndodh avash avash dhe në këtë mënyrë kërkon kohë që ndryshimi të duket dhe në politikë të shohim vërtet njerëz të qytetëruar e të edukuar që dinë të respektojnë identitetin gjinor të tyre. Edhe pse hapat janë hedhur duhet kohë që në politikën shqiptare ti shohim femrat si femra pa i identifikuar me gjininë tjetër as në sjellje e as në komunikim.

Pra qëllimi im në studimin e kësaj hipoteze, u arrit, pasi mjedisi jonë politik shqiptar jo vetëm që e reflekton këtë dukuri por e vërteton, duke vërtetuar më së miri dhe dy implikimet kryesore të nxjerra nga kjo hipotezë. Realiteti politik i shoqërisë sonë është i tillë që maskilizimin e gruas në komunikim e shikon si rrugën më të lehtë për ta bërë pjesë të jetës politike se në të kundërt pranimi i saj si faktor i barabartë në sferën politike do të jetë më i vështirë nëse komunikimi i saj është femëror apo shumë femëror.

REKOMANDIME

Shoqëria civile

Bindja e krijuar tashmë në politikën shqiptare se politika është një fushë e cila i përket 'burrave' ndikon në dy drejtime: së pari ndikon tek vetë gratë të cilat nisur nga ky paragjykim mendojnë se ato nuk e kanë vendin në politikë, politika nuk është për to, dhe së dyti për ato të cilët nuk janë të angazhuar politikisht dhe për mjedisin në tërësi të cilët nisur nga përcaktimi i politikës si domen i burrave, nuk ofrojnë/nuk sigurojnë përkrahje dhe mbështetje për gratë nëse ato do të vendosin të merren me politikë.

Rekomandohet:

- të fuqizohen forumet ekzistuese të grave apo forume të tjera të ngjashme të cilat mund të jenë pjesë e organeve të partive,
- ripërcaktimi i saktë i qëllimit të funksionimit të tyre, – kujdesi për perspektivën gjinore të politikave propozuese, dhe i mënyrës së funksionimit, (mos kufizohen vetëm në aktivitete periodike sociale-humanitare etj.,)
- realizimi nga këto forume i trajnimeve për fuqizimin e politikanëve,
- të punojnë më shumë në promovimin e pjesëmarrjes më të lartë të grave në politikë dhe vendimmarrje,
- të tregojnë vëmendje dhe monitorojnë zbatimin e sistemit të kuotave të përcaktuara në dokumentat partiake.

Gratë

Përvoja e grave pjesëmarrëse në fushatat zgjedhore apo dhe përvoja e grave pjesëmarrëse në organet vendimmarrëse mund të jetë një shembull i mirë për t'u ndjekur nga ato gra të cilat aspirojnë dhe duan të ecin përpara në politikë.

Rekomandohet:

- të jenë një zë më i fortë në shoqërinë civile dhe në politikëbërje;
- të mund të krijojnë lidhje të forta me zgjedhësit e tyre si edhe t'i japin përparësi çështjeve të grave duke përfshirë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre;
- duhet të ndikojnë në zhvillimin e legjislacionit dhe të rishikojnë ligjet ekzistuese për të propozuar amendamente që të sigurojnë ndjeshmëri ndaj çështjeve gjinore dhe të respektojnë të drejtat e grave;
- duhet të tregohen bashkëpunuese dhe të punojnë me gratë e të gjitha partive politike për të krijuar një rrjet formal të grave për të avokuar për një axhendë të përbashkët të grave.

Media

Në demokraci, është më demokratike që mediat të jenë në dispozicion të të gjithëve dhe jo një "mall për t'u blerë" vetëm nga disa. Mbulimi mediatik i njëanshëm dhe seksist dëmton politikanët dhe kandidatët femra.

Rekomandohet:

- mediat, më së shumti gazetarët duhet që të njohin dhe parandalojnë stereotipat e dëmshëm gjinorë;
- hapësirë e njëjtë publike e dy gjinive; (gjatë debateve televizive; fushatave; etj.,)

- zbutja e hendekut midis shoqërisë (mentalitetit) dhe grave në politikë/ grave vendimmarrëse; {mediat jo vetëm duhet të luajnë rol të rëndësishëm në formësimin e vlerave të shoqërisë, por duhet gjithashtu ti pasqyrojnë ato vlera}
- të mos përqendrohen në jetën private (familjare) të grave që kërkojnë poste publike;
- jo diskriminim gjinor por promovim të vlerave të gruas në mënyrë që të krijojnë për publikun dhe shoqërinë imazhin e vërtetë të gruas;
- fokusi në pamjen fizike të grave apo përdorimi i retorikës seksiste “minojnë” aftësitë e tyre për të qeverisur:
 - nuk duhet t’i konsiderojnë shumë emocionale, duke vënë në dyshim stabilitetin e tyre politik,
 - nuk duhet të gjykojnë pamjen fizike të grave, duke u kushtuar vëmendje të tepruar veshjeve, modelit të flokëve, modës etj.
 - nuk duhet të theksojmë "lidhjet" që gratë duhet të kenë si nevojë për t'u futur në politikë. Gratë në pushtet, shpesh i portretizojnë si delegate të njerëzve me influencë.
 - nuk duhet të komentojnë mënyrën e tyre të folurit në publik, nuk duhen konsideruar si folëse jo të mira duke vënë në pah ankesa për zërin, për tonin (ulëritës), për ngjyrat (i hidhur, i zemëruar).

Partitë politike

1. Në dokumentet bazë si dhe në kuadrin ligjor të tyre të kenë ndjeshmëri gjinore

Edhe pse statutet e dy partive kryesore në vend (PS dhe PD) deklarojnë se njohin dhe promovojnë pjesëmarrjen e gjerë popullore në jetën politike me synim ndërtimin e një demokracie të drejtave njerëzore duke promovuar paritetin gjinor në jetën e partisë dhe pjesëmarrjen e barabartë të grave në organet e zgjedhura dhe ato ekzekutive (Statuti i PD,

2009), apo shanse të barabarta në përfaqësimin midis burrave dhe grave (Statuti i PS, 2015); realiteti politik tregon ndryshe. Zbatimi i këtyre parimeve në realitet ndesh në “rezistencë zbatimi” nga partia.

Perspektiva gjinore duhet të jetë pjesë (jo vetëm e shkruar por praktikisht e zbatueshme) e dokumenteve të brendshme të partive politike (statutet, rregulloret, etj.). Nëse partitë tregojnë përkushtim ndaj parimeve demokratike, indirekt nënkuptojnë se çështja e barazisë gjinore dhe roli i gruas është i një rëndësie vendimtare për to.

2. Të marrin masa për promovimin e pjesëmarrjes së grave në struktura vendimmarrëse

Mënyra e pjesëmarrjes së gruas në politikë, mënyra se si partitë politike nxisin dhe inkurajojnë përfshirjen e grave /bëjnë pjesë të programeve të tyre çështjet e barazisë gjinore, janë përcaktuesit kryesorë të fuqizimit politik të gruas.

Rekomandohet:

- krijimi i forumeve të grave brenda partive politike;
- promovimi i pjesëmarrjes zgjedhore të gruas;
- miratimi dhe zbatimi i kuotave;
- vendosja e tyre në pozicione ku mund të fitojnë (lista partiake, zona zgjedhore);
- identifikimi i faktorëve nxitës për futjen dhe tërheqjen në parti;
- mbështetje nga burrat;
- koordinimi i punëve me organizatat apo forumet që ofrojnë mbështetje për kandidatet gra;
- mbledhje fondesh/fonde publike për mbështetje financiare.

ANEKS I

Ligjërimi i Znj. Topalli

Fjalimet e mbajtura prej Znj. Topalli në cilësinë e kryetares së Kuvendit të Shqipërisë 2009-2013 janë marrë nga faqja zyrtare e Kuvendit të Shqipërisë.⁹ Fjalimet e analizuarra janë:

1. Fjala e kryetares së Kuvendit Znj. Jozefina Topalli “Dhuna në familje” [26 nëntor 2009]
2. Kryetarja e Kuvendit, Znj. Jozefina Topalli u përgjigjet pyetjeve të gazetarëve [24 dhjetor 2009]
3. Fjala e kryetares së Kuvendit Znj. Jozefina Topalli në konferencën “Gratë parlamentare si faktorë aktivë të zhvillimit [20 shkurt 2010]
4. Fjala e kryetares së Kuvendit Znj. Jozefina Topalli në Samitin botëror për të drejtat e grave [08 mars 2010]
5. Fjala e kryetares së Kuvendit në Konferencën e Kartës së Adriatikut [24 tetor 2011]
6. Fjalimi i mbajtur nga kryetarja e Kuvendit Znj. Jozefina Topalli me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë 2012
7. Fjala e kryetares së Kuvendit Znj. Jozefina Topalli takim me gratë në Drenovë [13 korrik 2012]
8. Kryetarja e Kuvendit, Znj. Jozefina Topalli apel për mbylljen e reformave të nevojshme për statusin e vendit kandidat [02 korrik 2012]
9. Deklaratë e kryetares së Kuvendit, Znj. Jozefina Topalli për mediat [06 maj 2013]

⁹ http://www.parlament.al/web/Sesioni_i_pare_15722_1.php [pare në qershor 2014].

10. Fjalimi i kryetares së Kuvendit, znj. Jozefina Topalli në parlamentin e Bullgarisë [06 shkurt 2013]

Të gjitha fjalimet e mbajtura nga znj. Topalli në cilësinë e deputetes në opozitë në periudhën tetor 2013 – prill 2014. Fjalimet janë marrë nga faqja zyrtare e Kuvendit të Shqipërisë¹⁰ dhe mbajnë datat: 24 tetor 2013, 07 nëntor 2013, 14 nëntor 2013, 15 nëntor 2013, 26 nëntor 2013, 27 nëntor 2013, 12 dhjetor 2013, 16 dhjetor 2013, 23 dhjetor 2013, 28 dhjetor 2013, 20 shkurt 2014, 27 shkurt 2014, 10 mars 2014, 20 mars 2014, 27 mars 2014, 03 prill 2014.

¹⁰ http://www.parlament.al/web/Sesioni_i_pare_15722_1.php [pare në qershor 2014].
http://www.parlament.al/web/Drejtues_te_Legjislativit_ne_Shqiperi_1146_1.php [pare në qershor 2014]

ANEKS II

INTERVISTA

1. Sa e përfaqësuar politikisht është sot një grua
2. A ka në politikë një model të cilin gruaja shqiptare përpiqet ta ndjekë dhe nëse po cili është ai
3. Cilat janë vështirësitë më të shumta me të cilat përballet sot një grua, e cila është pjesë e politikës apo kërkon të bëhet pjesë e saj
4. Gjatë zgjedhjeve, kryesisht këto të fundit, a kanë pasur mbështetje gratë qoftë nga lideri qoftë nga kandidatët e tjerë meshkuj
5. Gjuha politike: a mendoni se ajo po shkon drejt një degradimi (është fyese, e ashpër, e tensionuar në pjesën më të madhe të komunikimeve publike)
6. Nëse i referohemi komunikimit politik të grave (pjesë të politikës) si mendoni, a është ai duhuri për një përfaqësim të denjë publik
7. Rezultat i kujt mendoni se është ky “maskilizim” i gruas dhe i mënyrës së saj të komunikimit
8. A është e mundur për femrat në Shqipëri të jenë të suksesshme në politikë pa e maskilizuar diskursin e tyre publik
9. A mendoni se kjo gjuhë e përdorur nga politikanët tanë në një farë mënyre reflekton kulturën tonë politike

TË INTERVISTUARIT DHE PËRKATËSIA E TYRE POLITIKE

1. Diana Culi PSD & përfaqësuese e Shqipërisë në Asamblenë e Këshillit të Evropës dhe aktiviste e shoqërisë civile për të drejtat e grave, barazinë gjinore, dhe luftës kundër trafikimit të grave dhe vajzave
2. Eglantina Gjermeni PS
3. Grida Duma PD
4. Kastriot Islami PD
5. Klajda Gjasha PS
6. Lajla Pernaska PD
7. Majlinda Bregu PD
8. Mesila Dode PDIU
9. Mimi Kodheli PS

LISTA E SHKURTIMEVE

CEDAW	Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave
KEDNJ	Konventa Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut
KNDCP	Konventa ndërkombëtare për të drejtat civile e politike
KNDESK	Konventa ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale e kulturore
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
MPCSSHB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
NATO	North Atlantic Treaty Organization
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PD	Partia Demokratike
PDIU	Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet
PS	Partia Socialiste
SIGI	Indeksi i Institucioneve Sociale dhe Gjinore
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
TV	Televizion

MANUALI I KOMUNIKIMIT POLITIK

Është	Duhet
Nxirreni jashtë atë vagabond, urgjent tani! Mos më shikoni ashtu se do ju shkarkoj!	Ju lutem, kërkoj që seanca të ndërpritet. Zotëria në fjalë është i lutur të dalë jashtë që të mos prishë ecurinë e seancës parlamentare
Ulu z.Balla, ulu! Në fakt, ky e meriton me e kap për zhelesh e jashtë! Nxirreni jashtë atë zotërinë, nxirreni jashtë! Zotëri, kape jashtë e nxirre. Vagabond! Ik andej! Ik! Del jashtë! Edhe nuk hyn ma.	Unë jua kërkoj shumë njerëzishëm: ne mund të mos jemi dakord me njëri-tjetrin; ne mund ta kritikojmë njëri-tjetrin, por në Kuvendin e Shqipërisë, në Kuvendin e shqiptarëve nuk mund të sulmohet.
Berisha duhet t'u kishte dhënë ju plumbin ballit në 1997-n".	Ju nuk mund të prishni rregullat, nuk mund të shkelni rregulloren dhe nuk mund të na fyeni në këtë mënyrë. Nevojitet ta zgjidhim këtë problem, jo ta përkeqësojmë.
Ik ore, trafikant, se e di unë se përse llomotit kështu ti!	Zotëri, më falni ju lutem, t'ju them se nuk e keni të drejtë mendimin tuaj!"
"Trafikant", "antikombëtar", "mafioz", "hajdut", "i korruptuar", "bllokmen", "drogaxhi" etj.	Përdorimi i një fjalori të denjë etik

Fjalët që rëndom përdoren nga gruaja politike shqiptare dhe që në këtë studim janë cilësuar të një fjalori të rëndë dhe akuzues në rrafshin etik.

BIBLIOGRAFIA

I- LITERATURA

Altheide, David L. & Robert P. Snow (1979). *Media Logic*. Beverly Hills-CA: Sage.

Atkinson, J. M. (1984). *Public speaking and audience responses; some techniques for inviting applause*. In: J.Maxwell & J.Heritage (eds.) "Structures of Social Action: Studies in Conversation Analysis". Cambridge: Cambridge University Press.

Beard, A. (2000). *The Language of Politics*. London: Routledge.

Boxer, B. (1994). *Politics and the New Revolution of Women in America*. Washington-DC: National Press Books.

Budini, Belina (2008). *Edi Rama, politikani pop(ulist)-star*. Tiranë: UET Press.

Butler, J. (1990). *Gender Trouble: Feminism and the Subversion of Identity*. New York: Routledge.

Butler, David, and Austin Ranney (eds) (1992). *Electioneering: A Comparative Study of Continuity and Change*. Oxford (UK): Clarendon Press.

Campbell, K. K. (1989) "Man cannot speak for her". Vol. 1. New York: Praeger,

Chilton, P. and Ilyin, M. (1993). *Metaphor in political discourse; The case of the common European house*. "Discourse and Society" Vol. 4, No. 7.

Chilton, P. and Schäffner, Ch. (1997) "Discourse and politics". In" T. van Dijk (ed.) "Discourse as Social Interaction". Vol. 2. London: Sage.

Chliwniak, L. (1997). *Higher education leadership; Analyzing the gender gap*. ASHE ERIC Higher Education Reports, Vol. 25, No. 4

Coates, J. (1993) "Woman, Man and Language".

London, Longman. Id (2007). "Gender". In: Llamas, C., Mullany, L., and Stockwell, P. (eds) "The Routledge Companion to Sociolinguistics"

Cockcroft, R. & Cockcroft, S. (1992) "Persuading People: An Introduction to Rhetoric". London: Macmillan.

Coopman, S. J. and Lull, J. (2012) "Public Speaking: The Evolving Art. 2nd edition". Boston: Wadsworth Cengage Learning,

- Darren G.Lilleker (2006) “*Key concepts in political communication*”, Sage Publication, London, Thousand Oaks, New Delhi
- De Beauvoir, S (2002) “*Seksi i dyte vol. 1, Faktet dhe mitet*”, Tiranë, Cabej
- Dhima, Aleksandër (2013) “*Antropologjia e Komunikimit, Qasje në realitetin shqiptar*”. Tiranë: Kumi
- Dominick, Joseph (2010), “*Dinamika e komunikimit masiv, media në periudhën digjitale*”, Tiranë, UET PRESS.
- Dow, B. J. & Tonn, M. B. (1993) “‘*Feminine Style*’ and *Political Judgment in the Rhetoric of Ann Richards*,” *Quarterly Journal of Speech* 79.
- Edelman, M. (1985). “*Political Language and Political Reality*”.PS, Vol.18, No.1:10-19.
- Fairclough, N. (1989) “*Language and Power*”, London: Longman,
- Fuga, Artan (2005) “*Lexime në komunikim*”, Tiranë, Ora
- Filo, LL; Cici, A; Grillo, D, “*Hyrje në teoritë politike moderne*”, Tiranë, Botimet Ideart.
- Fowler, R. & Marshall, J. (1985) “*Power*”. In T. van Dijk (ed.) *Handbook of Discourse Analysis*. London: Academic Press
- Gastil, J. (1992) “*Undemocratic discourse: a review of theory and research on political discourse*”. In *Discourse and Society* (3) (4).
- George Orwell, (1946) "*Politics and the English Language*"
- Giddens, A. (1991) ‘*Modernity and Self Identity: Self and Society in the Late Modern Age*’. Stanford-CA: Stanford University Press.
- Graber, D. A. (1981) “*Political language*”s. In D. Nimmo and K. Sanders (eds) *Handbook of Political Communication*. Beverly Hills: Sage,
- Gray, J. (1992). *Men are from Mars, Women are from Venus: a Practical Guide for Improving Communication and Getting What You Want in a Relationship*. HarperCollins, New York
- Griffin, Emm (2008) “*A first look at communication theory*”, MacGraw-Hill
- Herrick, J, A. (2005) “*The History and Rhetoric: An Introduction*’. Boston-MA: Pearson Education.

- Jamieson, K. H. (1988) “*Eloquence in an Electronic Age: the transformation of political speechmaking*”. New York: Oxford University Press,
- Jamieson, K. H. (1995) “*Beyond the Double Bind*”. New York: Oxford University Press,
- Johnson, Allan G, (2005) “*The gender knot: Unraveling our patriarchal legacy. Revised Edition*”. Philadelphia, PA: Temple University Press
- Kevin Harrison dhe Tony Boyd, (2003).”*Understanding ideas and movements*”. Manchester University Press.
- Kullashi, M (2005), “*Mendimi politik modern*”, Prishtinë, ALFAPRINT,
- Lakoff, R. (1975) “*Language and Woman’s Place*”. New York: Harper & Row
- Lisa Young (2000). “*Feminists and Party Politics*”. UBC Press.
- Lloshi, Xh. (2012) “*Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*”. Tiranë: Albas,
- Maitland, K. & Wilson, J. (1987) “*Ideological conflict and pronominal resolution*”. Journal of Pragmatics (11);
- Wilson, J. (1990) “*Politically Speaking.*” Oxford: Blackwell.
- Mathews, B & Ross, L (2010), “*Metodat e hulumtimit, udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane*”, Botimi në shqip nga CDE, Tiranë
- McConnell-Ginet, S. (2003) ‘*What’s in a Name?*’ Social Labeling and Gender Practices. In: Holmes, J. and M. Meyerhoff (eds.) (2003) “*The Handbook of Language and Gender*”. Oxford: Blackwell.
- McNair, B (2009), “*Hyrje në komunikimin politik*’, Tiranë, UET Press
- Meunier, Jean-Pierre; Peraya, Daniel (2009), “*Hyrje në teoritë e komunikimit*”, Tiranë, QSSHE.
- Miller, G. R. (2002) “*On Being Persuaded: Some Basic Distinctions*”. In James Price Dillard and Michael Pfau (eds.),”*The Persuasion Handbook: Developments in Theory and Practice*” Thousand Oaks CA, Sage
- Nisbet Robert, (2002) “*Konservatorizmi, ëndrra dhe realiteti*”, Botimet IDK
- Orwell, G. (1962) “*Politics and the English Language*”. In: Inside the Whale and Other Essays”. Harmondsworth: Penguin. Id. (1969) “*Politics and the English language*”. In: W.

F. Bolton and D. Crystal (eds) "The English Language" Vol. 2: Essays by Linguists and Men of Letters. Cambridge: Cambridge University Press.

Patterson, Thomas. 2000. "The United States: News in a Free-Market Society." In: "Democracy and the Media" Richard Gunther and Anthony Mugham (eds). Cambridge (UK): Cambridge University Press.

Partington, A. (2010) "Persuasion in Politics: a Textbook". Lededizioni, <http://www.lededizioni.com/catalogo/partingtonpersuasioninpolitics.html>

Paul G., James, 2005, "An introduction to discourse analysis, Theory and Methods"

Pearson, Judy; Nelson Paul; Titsworth, Scott (2008), "Human Communication, third edition", New York, McGraw – Hill, Higher Education,

Pierre Meunier, Jean; Peraya, Daniel (2009), "Hyrje në teoritë e komunikimit", Tiranë, QSSHE

Politics & Gender (2006), "Critical perspectives on gender and politics", Cambridge University Press.

Phillips, Anne. (1995) "The Politics of Presence". Oxford: Clarendon Press.

Sartori, Giovanni (1998), "Edhe një herë për demokracinë". Dituria.

Shapiro, M. J. (1981) "Language and Political Understanding" New York: Yale University Press,

Chilton, P. and Schäffner, Ch. (1997) "Discourse and politics. In T. van Dijk (ed.) Discourse as Social Interaction. Vol. 2. London: Sage.

Tannen, D. (1989) "Talking Voices: Repetition, Dialogue, and Imagery in Conversation". Cambridge: Cambridge University Press

Thomai, J. (2006) "Leksikologjia e Gjuhës Shqipe". Tiranë: Toena.

Van Dijk, T. (1989) "Structures of discourse and structures of power". In J. A. Anderson (ed.) Communication Yearbook 12. Newbury Park, CA: Sage. Id. (1998) "What is Political Discourse Analysis?" In: Blommaert, J., and Bbulcaen, Ch. (eds.) "Political Linguistics". Amsterdam: Benjamins. Id. (2001) "Political Discourse and Ideology". Paper for Jornadas Del Discurso Político. Barcelona, UPF.

Vehbiu, A. (2007) "Kur i flasim publikut". Fraktalet e Shqipërisë: Rrëgjimi i Gjeometrive të Standardit. Tiranë: Çabej.

Wilson, J. (2001) "*Political Discourse*". In: D. Schiffrin, et al. (eds.) (2001) "The Handbook of Discourse Analysis". USA: Blackwell Publ.

Zekije, Demir (2006). "*Feminizmi modern dhe postmodern*", Shkup: Logos-A, f

II-ARTIKUJ

Baçe Apollon “*Plotësimi i detyrës-shkelje flagrante e detyrës*”, Panorama 12 qershor 2008,

Bakalli Gilman, “*Lady J, Pushteti që mban Topallin*”, Shekulli, 2 shkurt 2009,

Basha Anila, “*Jozefina Topalli “Dialog me Majkon por pa kushte*”, Koha Jonë, 9 tetor 1998,

Baxhaku, Fatos (2009), “*Reminishencat e liderit të tipit lindor*”, Gazeta SHQIP

Blushi Kiço, “*Dukuria “Topalli” si një risi*”, Gazeta Shqiptare, 24 korrik 2008,

Blushi, Kico “*Zonja J*”, Gazeta Shqiptare, 2008

Buzi, Dalina “*Lotët që (s) duhet të derdhen në politikë*”, Gazeta Panorama, 2009

Çili, Henri, “*Jozefina Topalli: tri qëndresa*”, Panorama, 22 tetor 2007,

Danaj, Sonila “*Qytetarët e padukshme në politikë: gratë në zonat rurale*”, Polis 5, UET, 2008

Fashion. “*A women of substance*”. Our exclusive Q&A ëith Carine Roitfeld, 2011

Fuga, Artan “*Ku po shkon gjuha politike*”, 2010

Harasani Andis, “*Djalli mund të veshë dhe Prada*”, Gazeta Panorama, 2008

Hasani Zefina, “*Lady P*”, Revista Klan, 2005

Hasani, Zefina, “*Aromë Gruaje*”, Revista Klan, 2005

Hasimja, Ermal, “*Demokracia sa për të larë gojën*” Gazeta EXPRES, 2010

Konomi, Bledar, “*Maskilizimi i grave në politikë*”, Gazeta SHQIP, 2010

Kajsiu, Blendi “*Amerikanizimi i politikës shqiptare*”, revista POLIS, UET PRESS, nr 8, 2009

Londo, Bardhyl, “*Më në fund, Jozefina*”, Gazeta Shekulli, 2005

Martini Kreshnik, “*Agresivja Topalli*”, Zëri i Popullit, 13 prill 2003,

Minxhozi, Skënder “*Pëllumba? Jo, skifterë!*” 2010

Myftaraj Kastriot, “*J.Topalli,-ikona apo Mari Antuaneta e PD-së*”, Gazeta Sot, 4 maj 2006,

Popoci, Agim; “*Gra shqiptare në politikën e dhunshme*” - Diana Çuli, 2010

Popoci, Agim; “*Gra shqiptare në politikën e dhunshme*”- Eglantina Gjermani, 2010

Popoci, Agim; “*Gra shqiptare në politikën e dhunshme*”- Rajmonda Bulku, 2010

Schiffrin, Deborah, “*Making a list. Discourse Processes*”, 1994

Shella Gert, “*Loce u kry*”, Gazeta Shqiptare, 24 korrik 2008,

Tushi, Gëzim, “*Gra, shoqëria dhe 8 Marsi*”, Gazeta SHQIP, 2008

Vangjeli, Lorenc ; “*Gratë e politikës së re - Si u bënë pëllumbat skiftere*”, Revista MAPO

Xhunga, R; “*Edi dhe Jozefina*”, Gazeta Koha Jonë, 2006

Zholi, Albert (2008) *Intervista me Elsa Ballauri*

“*Kuota gjinore dhe zgjedhjet vendore*”,Gazeta Metropol, 2010

III-INTERVISTA

Intervistë me Klajda Gjoshaj, prill 2017

Intervistë me Diana Culi, maj 2017

Intervistë me Eglantina Gjermeni, maj 2017

Intervistë me Grida Duma, qershor 2017

Intervistë me Kastriot Islami, shkurt 2017

Intervistë me Lajla Përnaska, qershor 2017

Intervistë me Majlinda Bregu, qershor 2017

Intervistë me Mesila Dode, shkurt 2017

Intervistë me Mimi Kodheli, maj 2017

IV-DOKUMENTE / STUDIME

ACER dhe ASET (2009) “Zgjedhjet Parlamentare në Shqipëri 2009: Monitorimi i Zbatimit të Kuotës Gjimore dhe i Pjesëmarrjes së Grave”

Anastas, Aurela (2010) “*Të drejtat e gruas në legjislacionin shqiptar*”, OSCE

Hima, A. & Merkaj, L. (2015) “*Gjuha joparlamentare në Kuvendin e Shqipërisë*”. Kërkime Gjuhësore III. Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. ISBN: 978-9928-14-131-6,

Lafe, E., et al. (2012) *Analiza e ligjërimit politik*. Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Tiranë, <http://soros.al/2010/article.php?id=420> [04.04.2014

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER) në bashkëpunimin e ASET, (shtator 2010), “*Studim mbi Situatën në Shqipëritë Grave Lider në Nivel Vendor*”, Shtypshkronja Gent Grafik

Rrjeti i Grave “Barazi në Vendimmarrje”; “*A e solli kuota gruan në Vendimmarrje?*” studim

Musta, S. (2011) “*Retorika në parlament. Një analizë mbi gjuhën e diskutimeve të deputetëve në seancat plenare (2005-2010)*”. Studime albanologjike. Komunikimi i integruar. Koncepte, strategji, praktika. 2011/4,

MPCSSHB (2008) “*Strategjia kombëtare për barazinë gjimore dhe kundër dhunës në familje 2007-2010*”

MPCSDHB & DPSHB “*Gruaja shqiptare dhe problem i pabarazisë*”, studim

V-LIGJE

Kushtetua e Republikës së Shqipërisë, 1998

Ligj Nr. 10 019, dt. 29.12.2008 “*Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë*”

Ligj Nr. 10221, dt. 4.2.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”

Ligj Nr. 9062, dt. 8.5.2003 “*Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë*”

Ligj Nr. 9970, dt. 24.7.2008 “*Për barazinë gjinore në shoqëri*”

Ligji Nr. 7905, dt. 21.03.1995 “*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*”

Ligji Nr. 8781, dt.03.05.2001 “*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*”

Ligji Nr. 9125, dt.29.07.2003 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”

Ligji Nr.9669, 18.12.2006 “*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”

VI-WEB SITE

Blushi, K (2011), “Shfytyrimi ose topallizimi i parlamentarizmit”, AMA – NEËS, Marrë nga: (<http://www.ama-neës.al/2011/03/shfytyrimi-ose-topallizimi-i-parlamentarizmit-nga-kico-blushi/>)

Daci, Alban (2011),” Liberalizmi dhe Shqipëria sot”
(<http://albandaci.blogspot.com/2011/02/liberalizmi-dhe-shqiperia-sot.html>)

(2009) “Kultura jonë politike” Gazeta SHQIP, (parë për herë të fundit qershor 2011)
(<http://saktivista.com/2009/04/mbi-%E2%80%9Ckuotat-e-grave%E2%80%9D-qe-menaxhohen-nga-burrat/>)

http://cdn.agilitycms.com/who-makes-the-news/Imported/reports_2015/global/gmmp_global_report_en.pdf

<http://downloads.bbc.co.uk/mediaaction/pdf/practicebriefings/empowering-women-through-media-report.pdf>

<http://isp.com.al/2017/03/23/kurba-politike-e-shqiperise-nga-vendi-i-burrave-tek-50-e-grave-ministre/>

<http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=255749>

<http://www.fashionmagazine.com/fashion/2011/09/29/a-woman-of-substanceour-exclusive-qa-with-carine-roitfeld/2/>

<http://www.infocip.org>

<http://www.zeriamerikes.com/content/a-30-2008-07-03-voa5-85704077/437035.html>

(parë për herë të fundit 17/10/2014)

Social Institutions and Gender Index (SIGI). <http://genderindex.org/country/albania> (parë për herë të fundit në datë 11.08.2009)

Zaimi, Arbër (2009), “Mbi Kuotat e Grave” që menaxhohen nga Burrat”, Marrë nga:

<http://saktivista.com/2009/04/mbi-%E2%80%9Ckuotat-e-grave%E2%80%9D-qe-menaxhohen-nga-burrat/>)

Zaimi, Arbër (2010) “ Gratë nën perspektivën e kuotave rozë”, Marrë nga:

[\(http://saktivista.com/2010/09/grate-nen-perspektiven-e-%E2%80%9Ckuotave-roze%E2%80%9D/\)](http://saktivista.com/2010/09/grate-nen-perspektiven-e-%E2%80%9Ckuotave-roze%E2%80%9D/)

Zhupa, Ina (2011) “Pak më tutje se interesi i partive”, SOT NEWS

http://www.sot.com.al/index.php?option=com_content&view=article&id=3347:pak-me-tutje-se-interesi-i-partive&catid=87:koment-a-analize&Itemid=539